KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • TETOR 2015

Liahona

Artikulli i Kopertinës: Sa Fuqizuese Është ta Dimë Planin! f. 32

Gurët e Shikuesit, Jozef Smithi dhe Libri i Mormonit, f. 10

Gëzuar Përvjetorin e 100-të: Mbrëmja Familjare Rreth e Rrotull Botës, f. 26

Ripërkufizimi i Sfidës së Pornografisë, f. 50

"Ai u tha atyre një shëmbëlltyrë tjetër: 'Mbretëria e qiejve i ngjan majasë që e merr një grua dhe zë brumë me tri masa miell deri sa brumi të mbruhet plotësisht'."

Mateu 13:33

Liahona, Tetor 2015



4

MESAZHET

4 **Mesazhi i Presidencës së Parë Përfundojeni me Pishtarin Tuaj Ende të Ndezur**
Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf

7 **Mesazhi i Vizitave Mësimore Tiparet Hyjnore të Jezu Krishtit – I Mbushur me Dashuri Hyjnore dhe Dashuri**

ARTIKUJT KRYESORË

10 **Jozef Shikuesi**
Nga Riçard E. Tërli i Riu, Robin S. Xhensen dhe Mark Ashurst-Mek-Gi
Si ishte në gjendje Profeti Jozef ta përmbushte thirrjen e tij si shikues dhe të përkthente Librin e Mormonit?

18 **Fjalë për ta Ndryshuar Botën Tonë**
Nga Norman C. Hill
Përpjekjet për shkrim e këndim të këshillit të një distrikti në Ganë çuan në një bekim përtej masës për disa shenjtorë.

22 **Duke i Mësuar Rinisë se si të Udhëheqë sipas Mënyrës së Shpëtimtarit**
Nga Karol S. Mek-Konki
Të rinjtë janë udhëheqësit e ardhshëm të Kishës, por ata mund të kenë përvoja udhëheqjeje sot.

26 **Kremtimi i Mbrëmjes Familjare**
Shikoni se si anëtarët përqark botës marrin pjesë në veprimtarinë e rëndësishme që forcon familjet.

32 **Plani i Shpëtimit: Një Thesar i Shenjtë Diturie për të na Udhërrëfyer Ne**
Nga Plaku Robert D. Hejls
Përkrahja e planit të Atit tonë ishte çelësi i suksesit tonë në jetën paratokësore dhe ende është çelësi i suksesit tonë në këtë jetë.

RUBRIKAT

8 **Shërbimi në Kishë: A po Bëja Mjaftueshëm?**
Nga Bruk Barton

9 **Reflektime: Kunguj apo Pjepra?**
Nga Rejçëll Koks

40 **Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**

80 **Kur Prapë të Takohemi: Rruga drejt Sigurisë**
Nga Presidenti Henri B. Ajring

NË KOPERTINË
Përpara: Foto Ilustrimi nga Cody Bell. Brenda kapakut të përparmë: Fotografi nga © StockFood/Talbott, Barbara. Brenda kapakut të pasëm: Fotografi nga Tiffany Myloan Tong.

TË RINJTË NË MOSHË MADHORE

44 Të Jetuarit me Qëllim të Vërtetë
Nga Rendëll L. Rid
Shqyrtimi i hollësishëm i "arsyes" së vendimeve tuaja do t'ju ndihmojë të jetoni një jetë më të qëllimtë e të përqendruar.

48 Besim, Shërbim dhe një Çyrek Bukë
Nga Nisanka (Nish) Muthi Mudalig
Dëshiroja të shkoja të jepja mësim me misionarët; thjesht nuk e dija se si mund ta përballoja ekonomikisht mbërritjen aty.

Shihni nëse mund ta gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim. E dhënë: Ku mund të gjeni ndihmë kur nuk dini ç'të bëni?

RINIA

50 Shpëtimi nga Kurthi i Pornografisë
Nga Plaku Dallin H. Ouks
Pesë parime për t'ju ndihmuar të reagoni siç duhet ndaj medias me përmbajtje seksuale.

56 Në Vendin e Duhur në Kohën e Duhur
Ndonjëherë ju thjesht e dini se Zoti ju ka vendosur ju – ose të tjerët – aty ku jeni për një arsye.

58 Afishe: Libri Juaj i Jetës

59 Rresht pas Rreshti: Zanafilla 1:26–27

60 Kërkimi Im për të Vërtetën
Nga Peng Hua
Ndërsa rritesha, më mësuan se Perëndia nuk ekzistonte, por unë kisha nevojë ta dija vetë.

62 Të Rinj Mahnitës dhe Të Reja Mahnitëse në Shkrimet e Shenjta
Nga Zhizela Gutier
Njësoj si ju, të rinjtë në shkrimet e shenjta u përballën me sfida dhe tundime. Çfarë mund të mësoni nga shembujt e tyre të besimit e guximit?

64 Pyetje e Përgjigje
Si mund të bëj paqe me faktin që mami im po vdes – edhe pasi ne agjëruam e u lutëm që ajo të jetonte?



FËMIJËT

66 Një Vendim Fitimtar
Nga Marisa Uidison
Mirandës më në fund iu dha mundësia të luante në një ekip fitues. Por, a mund të luante ajo të dielave?

68 Këndi i Pyetjes
Çfarë ju pëlqen më shumë rreth të qenit një anëtar i Kishës?

69 Faqja Jonë

70 Koha e Shkrimit të Shenjtë: Pjetri, Korneli dhe Engjëlli
Nga Erin Sanderson

72 Të Gjesh Ndihmë
Nga Kimberli Raid
Tejti pa diçka që nuk duhet ta kishte parë, por kishte frikë t'u tregonte prindërve rreth saj.

74 O, Jo! Po Tani?
Çfarë duhet të bësh kur shikon diçka që e di se është e gabuar?

75 Kungujt e Polit
Poli nuk mendonte se do të ishte ndonjëherë i madh mjaftueshëm për të shkuar në mision si vëllai i tij.

79 Muzikë: Një në një Milion
Nga Jan Pinborough dhe Michael F. Moody

TETOR 2015 VËLLIMI 17 NR. 3
LIAHONA 12570 101
Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidenca e Parë: Tomas S. Monson, Henri B. Ajring, Diter F. Uhtdorf

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: Rasël M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasël Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen

Botues: Joseph W. Sitati
Këshilltarë: Randall K. Bennett, Craig A. Cardon, Christoffel Golden, Larry R. Lawrence, James B. Martino

Drejtor Administrimi: David T. Warner
Drejtor i Mbështetjes për Familjet dhe Anëtarët: Vincent A. Vaughn
Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loyborg
Administrues i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Administrimi: R. Val Johnson
Ndihmësredaktor Administrimi: Ryan Carr
Ndihmëse e Botimit: Megan VerHoef
Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit: Brittany Beattie, David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Lori Fuller, Garrett H. Garff, LaRene Porter Gaunt, Jill Hacking, Charlotte Larcabal, Mindy Anne Leavitt, Michael R. Morris, Sally Johnson Odekirk, Joshua J. Perkey, Jan Pinborough, Richard M. Romney, Paul VanDenBerghe, Marissa Widdison

Drejtor Administrimi i Artit: J. Scott Knudsen
Drejtor Arti: Tadd R. Peterson
Grupi i Dizenjimit: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, Mandie M. Bentley, C. Kimball Bott, Thomas Child, Nate Gines, Colleen Hinckley, Eric P. Johnsen, Susan Lofgren, Scott M. Mooy, Mark W. Robison, Brad Teare, K. Nicole Walkenhorst
Bashkërenduese për Pronësinë Intelektuale: Collette Nebeker Aune
Administrimi i Prodhimit: Jane Ann Peters
Grupi i Prodhimit:, Connie Bowthorpe Bridge, Julie Burdett, Katie Duncan, Bryan W. Gygi, Denise Kirby, Ginny J. Nilson, Gayle Tate Rafferty
Përgatitja për Shtyp: Jeff L. Martin

Drejtor i Prodhimit: Craig K. Sedgwick
Drejtor i Shpërndarjes: Stephen R. Christiansen
Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Attila Böröcz

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkoni në store.lds.org ose kontaktoni me qendrën tuaj vendore të Kishës për shpërndarjen ose me udhëheqësin e lagjes apo degës

Paraqitini dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në *Liahona,* Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fixhisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kamboxhisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, sllovenisht, spanjisht, suahilisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2015 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lënda e shkruar dhe ajo figurative e *Liahonës* mund të kopjohet për ta përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti. Lënda figurative nuk mund të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime te shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të adresohen te: Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada: October 2015 Vol. 17 No. 3. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published four times a year (April, May, October and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is $3.00 per year; Canada, $3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address must be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone or at store.lds.org. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 707.4.12.5). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.

Ide për Mbrëmje Familjare

Ky numër përmban artikuj dhe veprimtari që mund të përdoren për mbrëmje familjare. Në vijim janë dy shembuj.



"Kremtimi i Mbrëmjes Familjare", faqe 26: Qoftë nëse nuk lini asnjë javë pa e mbajtur apo nëse kjo është përpjekja juaj e parë, merreni parasysh të mbani një mbrëmje të veçantë familjare *në nderim të* mbrëmjes familjare! Mund ta lexoni artikullin për të parë se si familjet rreth e qark botës i gëzohen kalimit të kohës me njëri-tjetrin ndërkohë që mësojnë ungjillin. Merrni parasysh të diskutoni se si do ta arrini synimin tuaj për mbajtjen e mbrëmjes familjare. Si mund t'ju nevojitet ta përshtatni atë për ta përputhur me nevojat e familjes? Ju mund të rizotoheni si familje për ta bërë këtë traditë 100-vjeçare një përparësi në vetë shtëpinë tuaj, pavarësisht nga situata juaj.

"Të Gjesh Ndihmë", faqe 72: Merrni parasysh ta lexoni artikullin së bashku si familje dhe më pas të diskutoni pyetjet në vijim: 1) Me çfarë lloj pamjesh apo mjetesh informimi mund të kenë kontakt fëmijët? 2) Cilat prej tyre nuk do të ishin të mira që ne t'i shihnim apo ku të përqendroheshim? 3) Çfarë do të bënte secili njeri në një situatë ku ai sheh ose dëgjon diçka që e di se nuk duhet ta shohë apo dëgjojë? Diskutoni për strategjitë nga "O, Jo! Po Tani?" në faqen 74 nëse ju nevojitet ndihmë për idetë (largimi nga situata, bisedimi me prindërit, bërja e shërbimit etj.).

NË GJUHËN TUAJ

Liahona dhe materiale të tjera të Kishës gjenden në shumë gjuhë te languages.lds.org**.** Vizitoni **Facebook.com/liahona.magazine** për të gjetur ide për mbrëmje familjare, ndihma për mësimin e së dielës dhe përmbajtje që mund t'i ndani me miqtë dhe familjen. (gjenden në anglisht, portugalisht dhe spanjisht).

TEMAT NË KËTË BOTIM

Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.

Anëtarësia e Kishës, *68*
Dashuria hyjnore, *7*
Dhembshuria, *50*
Dhiata e Re, *70*
Dhiata e Vjetër, *59*
Dita e Shabatit, *66*
Frymëzimi, *40, 41, 42, 56*
Historia e Kishës, *10*
Jezu Krishti, *7*
Jozef Smithi, *10*
Këshillat, *18*
Kthimi në besim, *60*
Libri i Mormonit, *10, 44*
Liria e zgjedhjes, *32*
Lutja, *43, 64, 72*
Martesa, *32*
Mbrëmja familjare, *26*
Mjetet e informimit, *50, 72, 74*
Përparësitë, *9*
Plani i shpëtimit, *32*
Pornografia, *50, 72*
Profetët, *10, 80*
Puna misionare, *44, 48, 60, 70*
Rinia, *22, 62*
Shërbimi, *8, 56*
Shkrimet e Shenjta, *18, 59, 62*
Shkrimi e këndimi, *18*
Tempujt, *69*
Thirrjet në Kishë, *8*
Udhëheqja, *22*
Vdekja, *64*
Vendimet, *9, 44, 58, 66*
Zbulesa, *80*
Zelli, *4*

Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Përfundojeni

ME PISHTARIN TUAJ ENDE TË NDEZUR

Në Greqinë e lashtë, vrapuesit garonin në një garë me stafetë të quajtur *lampadedromia*.[1] Në garë, vrapuesit mbanin një pishtar në dorë dhe e kalonin te vrapuesi i radhës derisa pjesëtari i fundit i skuadrës të kalonte vijën e përfundimit.

Çmimi nuk i jepej skuadrës që vraponte më shpejt, i jepej skuadrës së parë që e arrinte vijën e përfundimit me pishtarin e saj ende të ndezur.

Ka një mësim të thellë këtu, një i dhënë nga profetët e lashtë dhe bashkëkohorë: ndërkohë që është e rëndësishme ta fillojmë garën, është edhe më e rëndësishme që ta përfundojmë me pishtarin tonë ende të ndezur.

Salomoni e Filloi Fuqishëm

I madhi Mbret Salomon është një shembull i dikujt që e filloi fuqishëm. Kur ishte i ri, ai "e donte Zotin dhe respektonte statutet e Davidit, atit të tij" (1 Mbretërve 3:3). Zoti ishte i kënaqur me të dhe tha: "Kërko ç'të duash dhe unë do ta jap" (1 Mbretërve 3:5).

Në vend që të kërkonte pasuri ose një jetë të gjatë, Salomoni kërkoi "një zemër të zgjuar, në mënyrë që të administrojë drejtësinë për popullin tënd dhe të dallojë të mirën nga e keqja" (1 Mbretërve 3:9).

Kjo e kënaqi kaq shumë Zotin sa Ai e bekoi Salomonin jo vetëm me mençuri, por edhe me kamje të pamasë dhe një jetë të gjatë.

Edhe pse Salomoni ishte njëmend shumë i mençur dhe bëri shumë gjëra të mëdha, ai nuk e përfundoi fuqishëm. Për fat të keq, më vonë gjatë jetës së tij, "Salomoni bëri atë që isht[e] e keqe në sytë e Zotit dhe nuk e ndoqi tërësisht Zotin" (1 Mbretërve 11:6).

Përfundimi i Garës Sonë Vetjake

Sa herë e kemi filluar diçka dhe nuk e kemi përfunduar? Dieta? Programe ushtrimesh fizike? Zotime për t'i lexuar shkrimet e shenjta çdo ditë? Vendime për të qenë dishepuj më të mirë të Jezu Krishtit?

Sa shpesh bëjmë qëllime vjetore në janar dhe i ndjekim ato me vendosmëri të flaktë për pak ditë, pak javë ose madje pak muaj vetëm për të zbuluar që, deri në tetor, flaka e zotimit tonë është pak më shumë se hi i ftohur?

Një ditë, hasa me një fotografi gazmore të një qeni që qëndronte pranë një flete letre të cilën ai e kishte bërë copash. Aty lexohej: "Certifikatë Trajnimi për Bindjen e Qenve".

Ne jemi ashtu ndonjëherë.

Kemi synime të mira; e fillojmë fuqishëm; duam të jemi vetja jonë më e mirë. Por në fund, i lëmë qëllimet tona vjetore të bëra copash, të hedhura tutje e të harruara.

Është në natyrën njerëzore të pengohesh, të dështosh e ndonjëherë të dëshirosh të dalësh jashtë gare. Por si dishepuj të Jezu Krishtit, ne jemi zotuar jo vetëm që ta fillojmë garën, por edhe që ta përfundojmë atë dhe ta përfundojmë atë me pishtarin tonë tek flakëron ndritshëm. Shpëtimtari u premtoi dishepujve të Tij: "Ai që do të ngulmojë deri në fund do të shpëtohet" (Mateu 24:13).

Më lini ta parafrazoj atë që Shpëtimtari e ka premtuar në kohën tonë: Nëse i zbatojmë urdhërimet e Tij dhe e

Për sa kohë vazhdojmë të ngrihemi e të lëvizim drejt Shpëtimtarit tonë, ne do ta fitojmë garën me pishtarët tanë duke flakëruar ndritshëm.

Sepse pishtari nuk ka lidhje me ne apo me atë që ne bëjmë.

Ka lidhje me Shpëtimtarin e botës.

Dhe ajo është një Dritë që nuk mund të zbehet kurrë. Është një Dritë që e përpin errësirën, i shëron plagët tona dhe ndrin edhe në mes të hidhërimit më të thellë dhe errësirës më të padepërtueshme.

Ajo është një Dritë që e tejkalon të kuptuarin.

E mbaroftë secili prej nesh shtegun që ka nisur. Dhe me ndihmën e Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, Jezu Krishtit, ne do ta mbarojmë plot gëzim dhe me pishtarët tanë ende të ndezur. ■

FOTOGRAFI NGA COMSTOCK/STOCKBYTE/THINKSTOCK

përfundojmë me pishtarin tonë ende të ndezur, ne do të kemi jetë të përjetshme, e cila është më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë (shih DeB 14:7; shih edhe 2 Nefi 31:20).

Drita Që Nuk Shuhet Kurrë

Ndonjëherë pasi pengohemi, dështojmë apo madje heqim dorë, ne shkurajohemi dhe besojmë se drita jonë është fikur dhe e kemi humbur garën. Por unë dëshmoj se Drita e Krishtit nuk mund të zhduket. Ajo shkëlqen në natën më të errët dhe do t'i ndriçojë përsëri zemrat tona nëse vetëm ne i kthejmë zemrat tona nga Ai (shih 1 Mbretërve 8:58).

Pavarësisht nga fakti se sa shpesh apo sa larg rrëzohemi, Drita e Krishtit flakëron përherë ndritshëm. Dhe madje në natën më të thellë, nëse ne veçse çapitemi drejt Tij, drita e Tij do t'i gëlltitë hijet e do t'i rindezë shpirtrat tanë.

Kjo garë dishepullimi nuk është një vrapim i shpejtë; është një maratonë. Dhe nuk përbën ndonjë ndryshim të madh se sa shpejt vrapojmë. Në fakt, mënyra e vetme se si mund ta humbasim këtë garë është duke u dorëzuar apo hequr dorë përfundimisht.

SHËNIM

1. *Harpers Dictionary of Classical Antiquities* (1898), "Lampadedromia", www.perseus.tufts.edu/hopper. [Gjeografi grek] Pausanias përshkruan një garë të ndryshme me pishtarë, në të cilën mbajtësit e pishtarëve, mundësisht një nga çdo fis, nuk e kalonin dorë më dorë pishtarin e tyre. Por si te gara *lampadedromia,* fituesi ishte i pari që e arrinte fundin e garës me pishtarin e tij ende të ndezur.

MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH

Merreni parasysh t'i nxitni ata të cilëve u jepni mësim, që të reflektojnë mbi vendin ku janë në "garat e tyre" të jetës. A po flakërojnë ndritshëm pishtarët e tyre? Ju mund ta lexoni frazën që thotë se Drita e Krishtit është "një Dritë që e përpin errësirën, i shëron plagët tona dhe ndrin edhe në mes të hidhërimit më të thellë dhe errësirës më të padepërtueshme". Pastaj, merreni parasysh të diskutoni me ata të cilëve u jepni mësim, për mënyrën se si Drita e Krishtit ka ndikuar në jetën e tyre në të kaluarën dhe se si ndikon te jeta e tyre tani.

Ushqejeni Pishtarin Tuaj: Prova 30-Ditore

Për rininë e Kishës me jetë të ngarkuar, mund të jetë e lehtë të ngecet në një vazhdë rutine, veçanërisht me gjërat shpirtërore. Ne i lexojmë shkrimet tona të shenjta, lutemi dhe adhurojmë në të njëjtën mënyrë thuajse çdo ditë dhe pastaj vrasim mendjen pse na duket sikur jemi në një rënie shpirtërore.

Një nga mënyrat më të mira për ta mbajtur pishtarin tuaj shpirtëror duke flakëruar ndritshëm, është të siguroheni se po kaloni përvoja domethënëse shpirtërore. Por ajo është me e lehtë të thuhet sesa të bëhet, prandaj këtu gjendet një sugjerim për t'ju ndihmuar të vazhdoni të përparoni shpirtërisht: Mendoni për një veprimtari të lidhur me ungjillin që nuk e keni bërë kurrë (apo e bëni rrallëherë), dhe zotohuni që ta bëni atë për çdo ditë të muajit. Mund ta filloni me gjëra të vogla sepse do të zbuloni se është më e lehtë që ndryshimet e vogla

të kthehen në ndryshime të përhershme. Bërja e gjërave që na nxjerrin nga zona e rehatisë shpirtërore, mund të kërkojë më tepër besim e përpjekje nga ana jonë por, kur i bëjmë ato, ne po e ftojmë Frymën e Shenjtë të jetë me ne dhe po tregojmë besim më të madh tek Ati Qiellor dhe një dëshirë për të shkuar më pranë Tij. Këtu janë disa ide për të filluar:

- Vendosni një synim për t'i bërë lutjet tuaja në mëngjes dhe në mbrëmje. Përpiquni të luteni me zë të lartë.
- Zgjohuni 15 minuta më herët dhe lexojini shkrimet tuaja të shenjta përpara shkollës.
- Lexoni biseda të konferencave të përgjithshme të kaluara.
- Publikoni një shkrim të shenjtë nga Libri i Mormonit në mediat shoqërore.
- Dëgjoni himne ose muzikë të Kishës në vend të muzikës suaj të zakonshme.

Bëjeni Pishtarin Tuaj më të Ndritshëm

Shumë kohë më parë në Greqi, kishte një garë ku vrapuesit mbanin pishtarë të ndezur. Kushdo që vraponte në të gjithë garën me pishtar ende të ndezur, ishte fituesi. Presidenti Uhtdorf thotë se jeta është si ajo garë. Pishtari që mbajmë ne, është Drita e Krishtit. Kur përpiqemi të jemi si Jezu Krishti, ne i bëjmë pishtarët tanë të flakërojnë më ndritshëm.

Ngjyrosini rrathët e gjërave që ky djalë mund të bëjë për të qenë si Jezusi dhe për ta bërë më të ndritshëm pishtarin e tij.

ILUSTRIM NGA SIMONE SHIN

Studiojeni këtë material me lutje dhe kërkoni të dini se çfarë të tregoni. Në ç'mënyrë të kuptuarit e tipareve hyjnore të Shpëtimtarit do ta rritë besimin tuaj tek Ai dhe do t'i bekojë ato për të cilat kujdeseni nëpërmjet vizitës mësimore? Për më tepër informacion, shkoni te reliefsociety.lds.org.

Tiparet Hyjnore të Jezu Krishtit: I Mbushur me Dashuri Hyjnore dhe Dashuri

Kjo është pjesë e një serie të Mesazheve të Vizitave Mësimore që paraqesin tipare hyjnore të Shpëtimtarit.

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta e përkufizon dashurinë hyjnore si "lloji[n] më [të] lartë, më fisnik, më [të] fuqishëm [të] dashurisë" ("Dashuria Hyjnore"). Ajo është dashuria e pastër e Jezu Krishtit. Ndërsa mësojmë për Jezu Krishtin dhe orvatemi të bëhemi si Ai, ne do të fillojmë ta ndiejmë dashurinë e Tij të pastër në jetën tonë dhe të marrim shtysë për t'i dashur të tjerët e shërbyer atyre siç do të bënte ai. "Dashuria hyjnore është të kesh durim me dikë që na ka lënë në baltë", tha Presidenti Tomas S. Monson. "Është t'i rezistosh impulsit për t'u ndier lehtësisht i ofenduar. Ajo është të pranosh dobësitë dhe mangësitë. Ajo është t'i pranosh njerëzit ashtu siç janë në të vërtetë. Ajo është të shohësh përtej dukjeve te tiparet që nuk do të zbehen me kalimin e kohës. Ajo është t'i rezistosh impulsit për të klasifikuar të tjerët."[1]

Në Librin e Mormonit ne mësojmë të vërtetën e madhërishme që ne i "lut[emi] Atit me gjithë fuqinë e zemrës . . ., që të mbushe[m]i me këtë dashuri që ai ua jep të gjithë atyre që janë pasues të vërtetë të Birit të tij Jezu Krisht; që [ne] të mund të bëhe[m]i bijtë e [bijat e] Perëndisë; që kur ai të shfaqet, ne të jemi si ai, pasi ne do ta shohim atë ashtu sikurse është; që të mund të kemi këtë shpresë; që ne të mund të pastrohemi, madje ashtu si ai është i pastër" (Moroni 7:48).

Shkrime të Shenjta Shtesë

Gjoni 13:34–35; 1 Korintasve 13:1–13; 1 Nefi 11:21–23; Ethëri 12:33–34

Merreni Parasysh Këtë

Si është Krishti shembulli ynë i përkryer i dashurisë dhe dashurisë hyjnore?

SHËNIME

1. Tomas S. Monson, "Dashuria Nuk Ligështohet Kurrë", *Liahona*, nëntor 2010, f. 124.
2. *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 119–120.
3. *Daughters in My Kingdom,* f. 87.

Besim, Familje, Ndihmë

Nga Historia Jonë

"Një motër që sapo kishte mbetur e ve, ishte mirënjohëse për mësueset vizitore që vajtuan me të dhe e ngushëlluan atë. Ajo shkroi: 'Kisha nevojë me dëshpërim për dikë ku mund të drejtohesha; dikë që do të më dëgjonte. . . . Dhe ato më dëgjuan. Ato më ngushëlluan. Ato qanë me mua. Dhe ato më përqafuan . . . [e] më ndihmuan për të dalë nga dëshpërimi dhe depresioni i thellë i atyre pak muajve të parë të vetmisë.'

Një grua tjetër i përmblodhi ndjenjat e saj kur qe marrëse e dashurisë së vërtetë hyjnore nga një mësuese vizitore: 'E dija se isha më shumë se sa thjesht një numër në regjistër që të vizitohesha prej saj. . . . Unë e dija se ajo interesohej për mua.'"[2]

Si këto motra, shumë shenjtorë përqark botës mund të japin prova për vërtetësinë e këtij pohimi nga Presidenti Bojd K. Paker (1924–2015), Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve: "Sa ngushëlluese është të dish se pavarësisht se ku [mund] të shkojë [një familje], një familje e Kishës i pret ata. Që prej ditës kur vijnë, ai do t'i përkasë një kuorumi priftërie dhe ajo do t'i përkasë Shoqatës së Ndihmës."[3]

NDIKIMI I GRAVE TË DREITA, NGA XHULI ROXHERS

A PO BËJA MJAFTUESHËM?

Nga Bruk Barton

Një mësim rreth deleve të humbura më ndihmoi të kuptoja se si ta përmbushja më së miri thirrjen time.

Në moshën 23-vjeçare, u thirra si presidente e Shoqatës së Ndihmës në lagjen tonë për studentët e martuar. Më kujtohet papërshtatshmëria që ndjeva, e shoqëruar nga dëshira për të bërë më të mirën time. Isha e paduruar dhe e emocionuar, por dyshoja në aftësinë time për të qenë një udhëheqëse e mirë.

Pas disa muajsh si presidente e Shoqatës së Ndihmës, ndjeva se nuk po bëja mjaftueshëm. Dëshiroja të isha në gjendje të lidhesha me motrat dhe të isha në harmoni me nevojat e tyre individuale, por ndjeva se isha larg qëllimit tim.

Fola me peshkopin tim dhe i shpreha shqetësimet e mia. I shpjegova se si nuk mund të arrija t'i ndihmoja të gjitha motrat që dëshiroja. Përshkrova se si uroja të kisha pesë si vetja që ta kryenin punën sikurse mendoja unë se duhej. U përpoqa t'i mbaja shqetësimet e mia të lehta e me humor, por sytë e mi u mbushën shpejt me lot shkurajimi. Ai buzëqeshi dhe më dha një nga këshillat më të mira për udhëheqjen që kam marrë ndonjëherë.

"A e di tregimin e bariut i cili, kur humbi një nga tufa e tij, i la 'të nëntëdhjetë e nëntat' për ta gjetur atë?" pyeti ai (shih Lluka 15:4–7). Pohova me kokë.

"Duket se ka kaq shumë mençuri në atë shëmbëlltyrë", vazhdoi ai. "Bariu e dinte se të nëntëdhjetë e nëntat do të ishin mirë nëse ai i linte ato për të kërkuar delen e vetme të humbur."

Pastaj peshkopi më dha këshillën që vijon:

"Shiko, të nëntëdhjetë e nëntat kanë një mënyrë të shkëlqyer

përkujdesjeje për njëra-tjetrën kur ti nuk je. Ato do ta ngrenë njëra-tjetrën dhe do të mbahen shumë mirë. Të sugjeroj që të përqendrohesh tek ato që duken të humbura. Pjesa tjetër do të jetë në rregull."

Ndjeva një dëshmi të fortë se ajo që ai më tha, ishte e vërtetë dhe se nuk duhej të shqetësohesha për të gjithë tufën njëherësh. Qëllimi im ishte të gjeja ato që kishin humbur dhe t'i ftoja ato të ktheheshin sërish në tufë. Në atë mënyrë, qëllimet e Atit Qiellor mund të bëheshin të mundura dhe unë mund të isha një mjet në duart e Tij.

Teksa ia vija veshin këshillës së peshkopit, ndjeva një masë më të madhe kuptueshmërie për mënyrën se si Zoti do të donte që unë të shërbeja në mbretërinë e Tij. Mora edhe përmbushje shpirtërore që më forcoi në thirrjen time për shkak se po shërbeja siç kishte udhëzuar Shpëtimtari. Nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, peshkopi im më kishte dhënë një dhuratë të madhe kuptueshmërie dhe ndriçimi të mendjes.

Unë dëshmoj se, ndërsa lutemi dhe kërkojmë frymëzim nga udhëheqësit tanë të priftërisë, ata do të frymëzohen për të na treguar se si të udhëheqim në mënyra të drejta. ■

Autorja jeton në Juta, SHBA.

ILUSTRIMI ME KOMPOZIM FOTOGRAFISH NGA MIKE BOYLAND/ISTOCK/THINKSTOCK AND OLEKSIY FEDOROV/HEMERA/THINKSTOCK

KUNGUJ APO PJEPRA?

Nga Rejçëll Koks

Ndonjëherë nuk ekziston një zgjedhje e gabuar. Ekziston thjesht një zgjedhje.

Babai im qe mjaft i befasuar tek zbuloi se farat e kungullit që ai kishte mbjellë vitin e shkuar, vendosën të mbinin në mes të ngastrës së tij të pjeprave këtë verë. Pjeprat po përparonin mjaft mirë, por kështu po ndodhte edhe me kungujt. Aq mirë, në fakt, saqë im atë u tundua që t'i linte bimët e kungullit të vazhdonin të rriteshin. Prapëseprapë ai e dinte se po ta bënte, kungujt do ta mbytnin rritjen e pjeprave.

Ndaj atij i duhej të bënte një zgjedhje. Ai mundej ose t'i shkulte kungujt që pjeprat të kishin një mundësi më të madhe për të lulëzuar, ose t'i linte bimët e kungullit të rriteshin dhe t'i vështronte ato ndofta tek u zinin frymën bimëve të pjeprit, gjë që me gjasë do të jepte një prodhim më të pakët prej të dyjave. Kunguj apo pjepra? Kjo zgjedhje qe midis dy mundësive të mira.

Duke i peshuar të dyja, im atë vendosi t'i shkulte bimët e kungujve. Jo vetëm që u vonuan për të mbirë, por ai vendosi që i dëshironte më shumë pjeprat e *planifikuar* sesa kungujt befasues.

Kjo përvojë më shtyu të mendoj rreth zgjedhjeve që bëjmë, veçanërisht në marrëdhëniet tona me të tjerët. Qoftë me familjen tonë, miqtë tanë, punëdhënësin tonë apo ata me të cilët dalim në takime apo martohemi, kur një zgjedhje është midis dy gjërave të mira, dallimi i mundësisë së drejtë apo më të mirë ndonjëherë është i vështirë, veçanërisht kur duam ta shmangim bërjen e zgjedhjeve të gabuara. Frika e bërjes së zgjedhjes së gabuar ndonjëherë na paralizon dhe ajo frikë mund të na pengojë nga lëvizja përpara me besim. Por e vërteta është se, ndonjëherë nuk ekziston një zgjedhje *e gabuar*. Ekziston thjesht një zgjedhje. Në rastin e babait tim, ai e bazoi vendimin e tij tek ajo që ai *vlerësonte* më tepër. Ai e kishte zët t'i vështronte kungujt të thaheshin, por ai e dinte se do t'i vinte keq për dëmin që ata do t'u bënin pjeprave më vonë.

Në jetë, disa zgjedhje me të cilat përballemi shpesh, nuk kanë rëndësi, të tilla si: Çfarë ushqimi duhet të ha për mëngjes? Çfarë ngjyre duhet ta vesh fustanin sot? Kur përballemi me një zgjedhje midis dy gjërave të mira, ne mund të bëjmë siç bëri babai im dhe thjesht të pyetim: "Çfarë vlerësoj unë më shumë?" Pastaj të marrim një vendim e të lëvizim përpara me besim, duke mirëbesuar se Zoti do të na korrigjojë nëse e kemi gabim në njëfarë mënyre.

Por disa zgjedhje kanë vërtet *shumë* rëndësi. Presidenti Tomas S. Monson tha një herë: "Vendimet janë vazhdimisht para nesh. Për t'i marrë [vendimet] me mençuri, duhet kurajë – kurajë për të thënë jo, kurajë për të thënë po. Vendimet *vërtet* përcaktojnë fatin" ("Tre Parimet e Zgjedhjes", *Liahona*, nëntor 2010, f. 68). Kur përballemi me këto lloj zgjedhjesh, një pyetje më e mirë për t'u bërë është: "Çfarë vlerëson *Zoti* më shumë?" Nëse ia dimë përgjigjen asaj pyetjeje, gjithçka na duhet është t'i përputhim vlerat tona me të Tijat dhe më pas të vazhdojmë me atë zgjedhje. Ajo do të jetë gjithmonë zgjedhja e duhur. ■

Autorja jeton në Juta, SHBA.

ILUSTRIM NGA CAROLYN VIBBERT

JOZEF Shikuesi

Anali historik qartëson se si Jozef Smithi e përmbushi rolin e tij si një shikues dhe se si e përktheu Librin e Mormonit.

Nga Riçard E. Tërli i Riu, Ndihmës i Historianit dhe Arkivuesit të Kishës,
Robin S. Xhensen dhe Mark Ashurst-Mek-Gi, Departmenti i Historisë së Kishës

Më 6 prill 1830, ditën që Jozef Smithi organizoi Kishën e Krishtit (më vonë e quajtur Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme)[1], ai u shpalli njerëzve të mbledhur fjalët e një zbulese. "Vini re", zëri i Perëndisë e shpalli në zbulesë, "do të ketë një anal të mbajtur mes jush; dhe në të ti [Jozef Smithi] do të quhesh shikues" (DeB 21:1).

Shenja më e dukshme e rolit të Jozef Smithit si një shikues në Kishën e sapoformuar ishte Libri i Mormonit, i cili, siç e shpjegoi ai në mënyrë të përsëritur, u përkthye "nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë"[2]. Shumë prej njerëzve më të afërt të Jozefit në vitin përpara organizimit të Kishës e kishin dëshmuar procesin me anë të të cilit Libri i Mormonit doli në dritë dhe kishin një farë kuptueshmërie për domethënien e fjalës *shikues*.

Domethënia e Fjalës *Shikues*

Çfarë do të thoshte fjala *shikues* për profetin e ri dhe bashkëkohësit e tij? Jozefi u rrit në një familje që e lexonte Biblën, libër i cili i përmend shikuesit në mënyrë të përsëritur. Te 1 Samuelit, për shembull, shkruesi shpjegon: "Në të kaluarën në Izrael, kur dikush shkonte për t'u këshilluar me Perëndinë, thoshte: 'Çohu të shkojmë te shikuesi', sepse profeti i sotëm në të kaluarën quhej shikues" (1 Samuelit 9:9).

Bibla gjithashtu përmend njerëz duke marrë shfaqje shpirtërore me anë të objekteve fizike, të tilla si një bastun ose një bastun ose një shufër[3], një gjarpër prej bronzi mbi një shtizë (i cili u bë një simbol gjerësisht i përhapur për profesionin e mjekësisë)[4], një efod (një pjesë e veshjes priftërore që përfshiu dy gurë të çmuar)[5] dhe Urimin e Thumimin[6].

JOSEPH SMITH-I, ATRIBUAR DAVID ROGERS-IT, ME MIRËSINË E ARKIVAT E BIBLIOTEKËS SË KOMUNITETIT TË KRISHTIT, INDIPENDËNS, MISURI

ME MIRËSINË E BIBLIOTEKËS SË HISTORISË SË KISHËS

Jozefi dhe bashkëshortja e tij, Ema Hejl Smithi, jetuan në pjesën njëkatëshe të kësaj shtëpie gjatë një pjese të kohës së përkthimit të Librit të Mormonit. Godina dykatëshe në të djathtë të shtëpisë ishte një shtesë e mëvonshme.

Për mijëra anëtarë gjatë jetës së tij dhe miliona anëtarë që nga vdekja e tij, Jozef Smithi është njohur si profet, shikues dhe zbulues.

"Të shikuarit" dhe "shikuesit" ishin pjesë e kulturës amerikane dhe familjare, në të cilën u rrit Jozef Smithi. Të zhytur thellë në gjuhën e Biblës dhe në një përzierje të kulturave anglo-europiane, të sjella nga emigrantët në Amerikën Veriore, disa njerëz në fillimin e shekullit të 19-të besonin se ishte e mundur që individët e talentuar të "shihnin", ose të merrnin shfaqje shpirtërore, nëpërmjet objekteve materiale, të tilla si gurët shikues.[7]

I riu Jozef Smith i pranoi mënyra të tilla, të njohura mes njerëzve të kohës së tij, duke përfshirë idenë e përdorimit të gurëve shikues për të parë për objekte të humbura ose të fshehura. Përderisa rrëfimi biblik e tregoi Perëndinë duke përdorur objekte fizike për ta përqendruar besimin e njerëzve ose për të komunikuar shpirtërisht në kohët e lashta, Jozefi dhe të tjerët hamendësuan të njëjtën gjë për kohën e tyre. Prindërit e Jozefit, Jozef Smith Plaku dhe Lusi Mek Smithi, e pohuan zhytjen e familjes në këtë kulturë dhe përdorimin nga ana e tyre të objekteve fizike në këtë mënyrë dhe fshatarët e Palmirës dhe të Mançesterit në shtetin e Nju-Jorkut, ku jetoi familja Smith, e kërkuan Jozefin për të gjetur objekte të humbura përpara se ai të shpërngulej në Pensilvani në fund të vitit 1827.[8]

Për ata njerëz që nuk e kuptojnë mënyrën se si e jetonin fenë e tyre njerëzit e shekullit të 19-të në krahinën e Jozefit, gurët shikues mund të jenë të panjohur dhe studiuesit e kanë debatuar prej kohësh këtë periudhë të jetës së tij. Pjesërisht për shkak të periudhës së Ndriçimit të Mendjes ose Epokës së Arsyes, një periudhë që e theksonte shkencën dhe botën e vëzhgueshme më shumë se çështjet shpirtërore, shumë njerëz në kohën e Jozefit arritën të ndienin se përdorimi i objekteve fizike, të tillë si gurët ose shufrat apo bastunët, ishte supersticioz ose i papërshtatshëm për qëllime fetare.

Në vitet e mëvonshme, kur Jozefi e tregoi këtë ngjarje mbresëlënëse, ai theksoi vegimet dhe përvoja të tjera shpirtërore të tij.[9] Ndryshe nga ai, disa nga bashkëpunëtorët e tij të mëparshëm u përqendruan në përdorimin e tij të hershëm të gurëve shikues në një përpjekje për ta shkatërruar famën e tij në një botë që po i mohonte gjithnjë e më shumë praktika të tilla. Në përpjekjet e tyre predikuese, Jozefi të tjerë të hershëm zgjodhën të mos përqendroheshin mbi ndikimin e kulturës popullore në përpjekjet e tyre për ta shpallur ungjillin, teksa shumë të kthyer të mundshëm në besim po përjetonin një ndryshim në mënyrën se si ata e kuptonin fenë në Epokën e Arsyes. Në ato që u bënë zbulesa të pranuara si shkrime të shenjta, megjithatë, Jozefi vazhdoi të jepte mësim se gurët shikues dhe mjete të tjera shikuese, si edhe aftësia për të punuar me to, ishin dhurata të rëndësishme dhe të shenjta nga Perëndia.[10]

Mjetet e Përdorura për të Përkthyer Librin e Mormonit

Gurët shikues gjithashtu shfaqen në rrëfimet historike që përshkruajnë Jozef Smithin dhe përkthimin e Librit të Mormonit. Historia zyrtare e Jozefit, e filluar në vitin 1838, përshkruan vizitën e një engjëlli, të njohur si Moroni, i cili i tregoi atij rreth fletëve të arta, të groposura te një kodër aty pranë. Jozefi tregon se teksa po bisedonte me engjëllin, një "vegim u hap" kaq qartë në mendjen e tij sa ai e "njoh[u] vendin" kur e pa atë më vonë vetë (Joseph Smith – Historia 1:42).

Në historinë që Jozefi filloi të hartonte në vitin 1838, Moroni e paralajmëron atë "se Satani do të përpiqej të më tundonte mua (si pasojë e rrethanave të varfra të familjes së atit tim), t'i merrja fletët për qëllim pasurimi". Këtë engjëlli e ndaloi, tregon Jozefi, duke thënë se, në qoftë se ai kishte "ndonjë motiv tjetër" nga ndërtimi i mbretërisë së Perëndisë, ai "nuk mund t'i merr[te] ato" (Joseph Smith – Historia 1:46). Në historinë e tij të mëparshme të vitit 1832, Jozefi

JOSEPH SMITH, ATRIBUAR DAVID ROGERS-IT, ME MIRËSINË E ARKIVAVE TË BIBLIOTEKËS SË KOMUNITETIT TË KRISHTITË, INDIPENDENS, MISURI

shpjegon: "Unë . . . i kërkova Fletët për të fituar pasurim dhe nuk e mbajta urdhërimin që duhej ta kisha syrin të drejtuar te Lavdia e Perëndisë"[11]. Si rrjedhim, atij iu kërkua të kthehej te kodra çdo vit për katër vjet, derisa të ishte i përgatitur për t'i marrë fletët (shih Joseph Smith – Historia 1:53–54).

Jozefi tregoi se, kur më së fundi i mori fletët nga Moroni në vitin 1827, ai gjithashtu mori dy gurë që do të përdoreshin në përkthimin e tyre. Ai dhe të njohur të afërt lanë rrëfime për këta gurë, duke i përshkruar ata si të bardhë ose të tejdukshëm në pamje, të vendosur në harqe ose në skelete të argjendta si syzet moderne ose gjyzlykët dhe të lidhura me një parzmore të madhe.[12] Siç përshkruhet, ky mjet shikues do të kishte qenë masiv. Nëna e Jozef Smithit tha se ai i shkëputste gurët nga parzmorja për lehtësi ndërsa i përdorte ato.[13]

Teksti i Librit të Mormonit i quan këta gurë "interpretuesit" dhe shpjegon se ata "ishin përgatitur që nga fillimi dhe ishin pasuar nga një brez në tjetrin, me qëllim që të përkthenin gjuhët", duke u "mba[jtur] dhe [duke] u ru[ajtur] nga dora e Zotit" (Mosia 28:14–15, 20).

Libri gjithashtu rrëfen se si Zoti i dha "dy gurë" vëllait të Jaredit, me premtimin se ata do t'i ndihmonin brezat e ardhshëm që të merrnin fjalët e tij. "Shkruaji këto gjëra dhe vulosi", e udhëzon Zoti atë, "dhe unë do t'ua tregoj fëmijëve të njerëzve, në kohën time të përshtatshme." Këta gurë, shpjegon Zoti, "[do] t'i qartësojnë në sytë e njerëzve, këto gjëra që ti do të shkruash" (Ethëri 3:24, 27).

Në kohën kur Jozef Smithi e përfundoi diktimin për shkruesit të përkthimit prej tij të Librit të Mormonit në mes të vitit 1829, kuptimi i fjalës *shikues* ishte qartësuar më tej në tekst. Libri i Mormonit përmban një profeci të treguar nga Jozefi i Egjiptit duke shpallur se një nga pasardhësit e tij – në mënyrë të qartë Jozef Smithi – do të ishte "një shikues [i] zgjedhur" duke sjellë pasardhës të tjerë "në njohurinë e besëlidhjeve" që Perëndia i bëri me paraardhësit e tyre (2 Nefi 3:6, 7).



ME MIRËSINË E BIBLIOTEKËS SË HISTORISË SË KISHËS; FOTOGRAFIA ËSHTË ZGJERUAR PËR QARTËSI

Hollësi nga një faqe e dorëshkrimit origjinal të Librit të Mormonit, që përmbante largimin e familjes së Lehit nga Jerusalemi në atë që është sot 1 Nefi 2. Jozef Smithi ua diktoi Librin e Mormonit disa shkruesve, përfshirë Oliver Kaudërin, i cili ishte shkruesi i këtyre rreshtave.

Në një rrëfim tjetër në Librin e Mormonit, Alma i Riu ia jep interpretuesit birit të tij, Helamanit. "T'i ruash këta interpretues", e këshilloi Alma atë, duke iu drejtuar dy gurëve në harqet e argjendta. Por Alma gjithashtu citon një profeci që duket se i drejtohet një guri të vetëm: "Dhe Zoti tha: Unë do të përgatis për shërbëtorin tim Gazelem një gur i cili do të bëjë që drita e tij të ndriçojë në errësirë" (Alma 37:21, 23).

Në mënyrë të dukshme, edhe pse e dhënë në kontekstin e "interpretuesve" (shumës), kjo profeci flet rreth dhënies një shërbyesi një gur (njëjës) "i cili do të bëjë që drita e tij të ndriçojë në errësirë".[14] Shenjtorët e hershëm të Ditëve të Mëvonshme besonin se ky shërbyes i profetizuar ishte Jozef Smithi.[15]

Në fakt, prova historike tregon se përveç dy gurëve shikues, të njohur si "interpretuesit", Jozef Smithi përdori të paktën një gur tjetër shikues në përkthimin e Librit të Mormonit, shpesh duke e vendosur atë brenda një kapeleje me qëllim që të bllokohej drita

ENGJËLLI MORONI DUKE JA DORËZUAR FLETËT JOZEF SMITHIT, NGA C. C. A. CHRISTENSEN

Anëtarët e Kishës gjatë gjithë historisë së saj janë përpjekur ta kuptojnë historinë e hershme të Jozef Smithit dhe të gjetjes e përkthimit të fletëve të arta. Ky imazh nga artisti C. C. A. Christensen në vitin 1886 paraqet Jozef Smithin duke marrë fletët nga engjëlli Moroni.

nga jashtë. Sipas bashkëkohësve të Jozefit, ai e bëri këtë me qëllim që t'i shihte më mirë fjalët mbi gur.[16]

Në vitin 1833, Jozef Smithi dhe bashkëpunëtorët e tij filluan të përdorin termin biblik "Urimi dhe Thumimi" për t'iu drejtuar çdo guri të përdorur për të marrë zbulesa hyjnore, duke përfshirë interpretuesit nefitë dhe gurin e vetëm shikues.[17] Kjo terminologji e pasaktë i ka ndërlikuar përpjekjet për ta rindërtuar metodën e përpiktë me anë të së cilës Jozef Smithi e përktheu Librin e Mormonit. Përveç përdorimit të interpretuesve, sipas Martin Harrisit, Jozefi gjithashtu përdori një nga gurët e tij shikues për lehtësi gjatë përkthimit të Librit të Mormonit. Burime të tjera e vërtetojnë ndryshimin nga ana e Jozefit të mjeteve të përkthimit.[18]

Pasi u Botua Libri i Mormonit

Pas botimit të Librit të Mormonit në mars të vitit 1830, Jozef Smithi dhe nëpunësit e tij filluan të punojnë me atë që tani njihet si Përkthimi i Biblës prej Joseph Smith-it, një rishikim profetik i Variantit të Mbretit Xhejms.[19] Nëpërmjet rrëfimit të Jozefit, përdorimi i interpretuesve nefitë për këtë projekt përkthimi nuk ishte një mundësi, sepse ai nuk i kishte më ata.

Historia e Jozefit shpjegon se "nëpërmjet urtësisë së Perëndisë, [fletët dhe interpretuesit] mbetën të sigurta në duart e mia, derisa unë të përfundoja me to atë që ishte kërkuar nga dora ime. Kur, në përputhje me marrëveshjet, lajmëtari erdhi për to, unë ia dorëzova atij; dhe ai i ka ato në ngarkim deri në këtë ditë" (Joseph Smith – Historia 1:60).

Siç e shpjegoi atë Presidenti Brigam Jang (1801–1877): "Jozefi i vendosi U[rimin dhe] T[humimin] sërish me fletët kur ai e kishte përfunduar përkthimin"[20].

Jozefi kishte gurë të tjerë shikues por, sipas fjalëve të Plakut Orson Prat (1811–1881), anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve dhe më vonë Historiani i Kishës, gjithashtu në këtë kohë Jozefi ishte pjekur në kuptueshmërinë e tij shpirtërore. Në një mbledhje më 28 qershor 1874, ku morën pjesë Presidenti Brigam Jang dhe shumë Autoritete të tjera të Përgjithshme, Plaku Prat u tregoi dëgjuesve të tij se kishte qenë "i pranishëm shumë herë" kur Jozef Smithi "po përkthente Dhiatën e Re". Ngaqë nuk pa mjete përkthimi të përdoreshin gjatë procesit të përkthimit, ai pyeste veten përse Jozefi "nuk i përdori Urimin dhe Thumimin, sikurse në përkthimin e Librit të Mormonit".

Teksa Plaku Prat e shikonte Profetin të përkthente, "Jozefi, sikur t'i kishte lexuar mendimet e tij, ngriti sytë dhe shpjegoi se Zoti ia dha Urimin dhe Thumimin kur ishte i papërvojë lidhur me Shpirtin e frymëzimit. Por tani ai kishte përparuar kaq shumë sa i kuptonte veprimet e atij Shpirti dhe nuk kishte nevojë për ndihmën e atij mjeti."[21]

Brigam Jangu i tregoi dëgjuesve mendimet e tij rreth marrjes se një guri shikues. "Nuk e di që të kem pasur ndonjëherë një dëshirë për ta pasur një [gur]", mendoi ai.[22] Thënia e Brigamit shprehu kuptueshmërinë e tij që gurët shikues nuk ishin thelbësorë për të qenë një shikues.

Më 25 tetor 1831, Jozef Smithi mori pjesë në një konferencë në Orinxh të Ohajos. Gjatë konferencës, vëllai i tij, Hajrëmi, tha që ai "mendoi se ishte më mirë që informacioni për daljen në dritë të Librit të Mormonit t'u tregohej nga vetë Jozefi Pleqve të pranishëm, që ata të gjithë të mund ta dinin për veten e tyre". Sipas procesverbalit të mbledhjes, Jozefi "tha se nuk ishte qëllimi që t'i tregoheshin botës të gjitha detajet e daljes në dritë të Librit të Mormonit" dhe "se nuk ishte e domosdoshme për të t'i tregonte këto gjëra"[23]. Duke u pjekur në rolin e tij si shikues dhe duke arritur të besonte se gurët shikues nuk ishin thelbësorë për zbulesën, ndoshta ai shqetësohej që

FOTOGRAFI RRETH VITIT 1866, ME MIRËSINË E BIBLIOTEKËS SË HISTORISË SË KISHËS

Fineas Jangu, i ulur në mes të vëllezërve Jang dhe në të majtë të Brigam Jangut, e mori nga Oliver Kaudëri një gur shikues të përdorur në përkthimin e Librit të Mormonit dhe ia dha atë vëllait të tij, Brigamit.

FOTOGRAFI NGA WELDEN C. ANDERSEN DHE RICHARD E. TURLEY JR.

Gurët e paraqitur këtu janë shoqëruar prej kohësh me Jozef Smithin dhe përkthimin e Librit të Mormonit. Gurit që Jozef Smithi përdori në përpjekjen e përkthimit të Librit të Mormonit, shpesh iu referua si një gur me ngjyrë kafe, me një formë vezake. Ky gur kaloi nga Jozef Smithi tek Oliver Kaudëri dhe më pas iu kalua Kishës nëpërmjet Brigam Jangut dhe të tjerëve.

ÇFARË I NDODHI GURIT SHIKUES?

Sipas historisë së Jozef Smithit, ai ia ktheu engjëllit Urimin dhe Thumimin, ose "interpretuesit" nefitë. Por çfarë ndodhi me gurin ose gurët e tjerë shikues, të cilët Jozefi i përdori në përkthimin e Librit të Mormonit?

Dejvit Uitmeri shkroi se, "pasi u përfundua përkthimi i Librit të Mormonit, në fillim të pranverës së vitit 1830, përpara 6 prillit, Jozefi ia dha gurin Oliver Kaudërit dhe më tha mua, si edhe të tjerëve, se ai kishte mbaruar punë me të dhe nuk e përdorte më gurin"[1].

Oliveri, i cili kishte qenë jashtë Kishës për një dhjetëvjeçar derisa u pagëzua sërish në vitin 1848, planifikoi të shkonte drejt perëndimit për të qenë me shenjtorët në Juta, por ai vdiq në vitin 1850 në Riçmond të Misurit, përpara se ta bënte udhëtimin.[2] Fineas Jangu, i cili kishte ndihmuar për ta sjellë Oliver Kaudërin sërish në Kishë, e mori gurin shikues nga e veja e Oliverit, e cila ishte motra e Dejvid Uitmerit, Elisabeth En Uitmer Kaudëri. Fineasi më pas ia dha atë vëllait të tij, Brigam Jangut.[3]

"Unë e kam Gurin e parë Shikues të Jozefit, të cilin e mora nga O[liver] K[audëri]", e pranoi Presidenti Jang në vitin 1853. Pati edhe të tjerë. "Jozefi pati 3, të cilët i ka Ema", shtoi ai, "2 gurë të vegjël dhe 1 gur të madh"[4]. Dy vjet më vonë, Brigam Jangu i tha një grupi udhëheqësish të mbledhur të Kishës se "Oliveri ma dërgoi gurin e parë Shikues të Jozefit. Oliveri gjithmonë e mbajti atë derisa ma dërgoi mua"[5].

Pasi Brigam Jangu vdiq, një nga bashkëshortet e tij, Zina D. H. Jangu, e cila më vonë u bë presidentja e tretë e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, mori një gur shikues ngjyrë kafe nga zotërimet e tij, i cili përputhej me përshkrimet e gurit që Jozefi e përdori për të përkthyer Librin e Mormonit dhe ia dhuroi atë Kishës.[6] Që nga ajo kohë, udhëheqësit vijues të Kishës e kanë pranuar që Kisha e ka në zotërim gurin shikues.[7]

SHËNIME

1. David Whitmer, *An Address to All Believers in Christ* (1887), f. 32.
2. Për më shumë informacion rreth kthimit të Oliver Kaudërit në Kishë përpara vdekjes së tij, shih Scott F. Faulring, "The Return of Oliver Cowdery", në John W. Welch dhe Larry E. Morris, botimet, *Oliver Cowdery: Scribe, Elder, Witness* (2006), f. 321–362.
3. Shih Procesverbal, 30 shtator 1855, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejk-Siti; "David Whitmer", *The Historical Record,* tetor 1888, f. 623; Maria L. Cowdery Johnson-i drejtuar David Whitmer, 24 janar 1887, Arkivat e Bibliotekës së Komunitetit të Krishtit, Independëns, Misuri; dhe Franklin D. Richards, Ditar, 9 mars 1882, Biblioteka e Historisë së Kishës.
4. Procesverbal, 17 prill 1853, Biblioteka e Historisë së Kishës.
5. Procesverbal, 30 shtator 1855, Biblioteka e Historisë së Kishës.
6. Shih Zina Young drejtuar Franklin D. Richards, 31 korrik 1896, në Journal History of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 31 korrik 1896, f. 4, Biblioteka e Historisë së Kishës.
7. Shih B. H. Roberts, *A Comprehensive History of the Church,* 6:230–231; Joseph Fielding Smith, *Doctrines of Salvation,* përmb. Bruce R. McConkie, 3 vëll. (1954–1956), 3:225; Bruce R. McConkie, *Mormon Doctrine,* bot. i 2-të (1966), f. 818–819.



ME MIRËSINË E BIBLIOTEKËS SË HISTORISË SË KISHËS

Në vitin 1883,* The Contributor [Dhënësi], *një revistë e botuar nga Kisha, e theksoi Dëshminë e Tre Dëshmitarëve të Librit të Mormonit. Shenjtorët e ditëve të mëvonshme prej kohësh e kanë dalluar rolin vendimtar që çdo njeri luajti për ta ndihmuar Jozef Smithin që të përkthente dhe botonte Librin e Mormonit.

njerëzit mund të përqendroheshin më shumë mbi mënyrën se si libri doli në dritë dhe më pak te libri vetë.

Çështja më e dukshme që ngriti Jozef Smithi rreth përkthimit të Librit të Mormonit, ishte që ai e bëri atë "nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë"[24]. Libri vetë, siç u dha ai mësim udhëheqësve të Kishës, "ishte më i sakti nga ndonjë Libër mbi tokë dhe gurthemeli i besimit tonë" dhe duke iu bindur porosive të tij, lexuesi do t'i afrohet "më shumë Perëndisë . . . se nga ndonjë libër tjetër"[25]. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 115.
2. Preface to Book of Mormon, rreth gushtit 1829, te *Documents, Vëllimi 1: korrik 1828–qershor 1831,* vëll. 1 i serisë Documents të *The Joseph Smith Papers* (2013), f. 93. Shih edhe "Dëshmia e Tre Dëshmitarëve", f. vii, Libri i Mormonit.
3. Shih Eksodi 4:1–5, 17, 20–21; 7:8–21; 8:16–19; 9:22–26; 10:12–15; 14:15–18; 17:1–13; Numrat 17:1–10; 20:7–11; Hebrenjve 9:4.
4. Shih Numrat 21:7–9; Gjoni 3:14–15.
5. Shih Eksodi 28:12; 35:9, 27; 1 Samuelit 23:9–12; 30:7–8.
6. Shih Eksodi 28:30; Levitiku 8:8; Numrat 27:21; Ligji i Përtërirë 33:8; 1 Samuelit 28:6; Ezdras 2:63; Nehemias 7:65.
7. Për më shumë informacion për këtë kulturë fetare të shekullit të 19-të, shih *Journals, Volume 1: 1832–1839,* vëll. 1 i serisë Journals të *The Joseph Smith Papers* (2008), f. xix; dhe *Revelations and Translations, Volume 3: Printer's Manuscript of the Book of Mormon,* vëll. 3 i serisë Revelations and Translations të *The Joseph Smith Papers* (2015), f. xv–xvi; Dallin H. Oaks, "Recent Events Involving Church History and Forged Documents", *Ensign,* tetor 1987, f. 68–69.
8. Shih thënien e Jozef Smith Plakut, siç citohet te Francis W. Kirkham, *A New Witness for Christ in America: The Book of Mormon,* vëll. 2 (1959), f. 366; shih edhe Lucy Mack Smith, "Lucy Mack Smith, History, 1844–1845", libri 3, faqe 10, josephsmithpapers.org/paperSummarylucy-mack-smith-history-1844-1845. Martin Harrisi solli ndërmend vënien në provë të aftësisë së Jozefit duke e bërë atë të gjente një gjilpërë në një grumbull kashte (shih "Mormonism—No. II", *Tiffany's Monthly,* korrik 1859, f. 164).
9. Shih, për shembull, Joseph Smith – Historia te Perla me Vlerë të Madhe.
10. Shih Doktrina e Besëlidhje 130:10–11. Shih edhe fjalët më të hershme të asaj që tani është Doktrina e Besëlidhje 8, drejtuar Oliver Kaudërit teksa ai dëshironte ta ndihmonte Jozef Smithin në përkthimin e Librit të Mormonit (Revelation, prill 1829–B, në *Documents, Volume 1: korrik 1828–qershor 1831,* f. 44–47).
11. Joseph Smith, "History, ca. Summer 1832", në *Histories, Volume 1: 1832–1844,* vëll. 1 i serisë Histories të *The Joseph Smith Papers* (2012), f. 14.
12. Shih Joseph Smith – Historia 1:35; Joseph Smith, "Church History", në *Histories, Volume 1: 1832–1844,* f. 495; Martin Harris, në "Mormonism—No. II", f. 165–166; "Lucy Mack Smith, History, 1844–1845", libri 5, faqet 7–8, josephsmithpapers.org.
13. Shih, për shembull, "Lucy Mack Smith, History, 1844–1845", libri 5, josephsmithpapers.org.
14. Në mënyrë të kuptueshme, ky dallim i ka hutuar komentuesit. Shih, për shembull, Bruce R. McConkie, *Mormon Doctrine,* bot. i 2-të (1966), f. 307–308; Joseph Fielding McConkie dhe Robert L. Millet, *Doctrinal Commentary on the Book of Mormon,* 4 vëll. (1987–1992), 3:278; dhe Matthew B. Brown, *All Things Restored: Confirming the Authenticity of LDS Beliefs* (2000), f. 62.
15. Shih William W. Phelps, Funeral Sermon of Joseph and Hyrum Smith, Church History Library, Salt Lake City; Orson Pratt, "Explanation of Substituted Names in the Covenants," *The Seer,* mars 1854, f. 229; William W. Phelps, letër drejtuar Brigam Jangut, 10 prill 1854, nën Brigham Young, Office Files, 1832–1878, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejk-Siti; dhe *Revelations and Translations, Volume 2: Published Revelations,* vëll. 2 i serisë Revelations and Translations të *The Joseph Smith Papers* (2011), f. 708–709
16. Për më shumë informacion mbi përkthimin, shih "Book of Mormon Translation", në dispozicion te lds.org/topics/book-of-mormon-translation. Shih edhe Russell M. Nelson, "A Treasured Testament", *Ensign,* korrik 1993, f. 61–65; Neal A. Maxwell, "By the Gift and Power of God", *Ensign,* janar 1997, f. 36–41.
17. Uillford Udrafi, për shembull, e quajti një gur shikues, të cilin e pa në Navu, një Urim dhe Thumim (ditari i Uillford Udrafit, 27 dhjetor 1841, Biblioteka e Historisë së Kishës). Shih edhe *Revelations and Translations, Volume 3: Printer's Manuscript of the Book of Mormon,* f. xix.
18. Shih *Revelations and Translations, Volume 3: Printer's Manuscript of the Book of Mormon,* f. xviii–xix.
19. Për një përmbledhje të shkurtër të fillimeve të kësaj përpjekjeje, shih *Documents, Volume 1: korrik 1828–qershor 1831,* f. 150–152.
20. Procesverbal, 17 prill 1853, Biblioteka e Historisë së Kishës.
21. "Two Days' Meeting at Brigham City, June 27 and 28, 1874", *Millennial Star,* 11 gusht 1874, f. 498–499.
22. Procesverbal, 30 shtator 1855, Biblioteka e Historisë së Kishës.
23. Procesverbal, 25–26 tetor 1831, në *Documents, Volume 2: korrik 1831–janar 1833,* vëll. 2 i serisë Documents të *The Joseph Smith Papers* (2013), f. 84.
24. Preface to Book of Mormon, rreth gushtit 1829, në *Documents, Volume 1: korrik 1828–qershor 1831,* f. 93. Shih edhe "Dëshmia e Tre Dëshmitarëve", f. vii, Libri i Mormonit.
25. Jozef Smithi, tek ditari i Uillford Udrafit, 28 nëntor 1841, Biblioteka e Historisë së Kishës; ose parathënia e Librit të Mormonit.

NËPËRMJET DHURATËS DHE FUQISË SË PERËNDISË, NGA SIMON DEWEY, ME MIRËSINË E ALTUS FINE ARTS

ILUSTRIMI I PROCESIT TË PËRKTHIMIT

Me kalimin e viteve, artistët janë përpjekur ta portretizojnë përkthimin e Librit të Mormonit, duke i treguar pjesëmarrësit në shumë rrethana dhe poza me objekte të ndryshme të materialit. Çdo interpretim artistik bazohet mbi këndvështrimet, kërkimin dhe përfytyrimin e vetë artistit të tij, nganjëherë i ndihmuar nga informacioni dhe udhëzimi prej të tjerëve. Këtu gjenden disa skena të krijuara përgjatë viteve.

Interpretimi i artistit për Jozef Smithin duke studiuar fletët. Jozefi tregoi se ai "i kopjoi një numër të konsiderueshëm" shkronjash nga fletët. Pasi i përktheu këto shkronja "me anë të Urimit dhe Thumimit", Martin Harrisi ia çoi shkronjat Çarls Antonit dhe shkollarëve të tjerë për të vërtetuar përkthimin (Joseph Smith – Historia 1:62–64).

JOZEF SMITHI DUKE PËRKTHYER LIBRIN E MORMONIT, NGA DEL PARSON

Portretizimi i artistit për Jozef Smithin dhe Oliver Kaudërin duke punuar për përkthimin e Librit të Mormonit. Ndryshe nga çfarë është paraqitur këtu, Oliver Kaudëri tha se ai nuk i pa fletët deri pasi përkthimi u përfundua. Dëshmitarët e procesit raportuan se gjatë përkthimit, fletët ishin të mbrojtura për të mos u parë, të tillë si të ishin të mbuluara me një cohë pëlhure.

Interpretimi i artistit për Jozef Smithin duke përkthyer teksa e mbante parzmoren me interpretuesit ose gjyzlykët e bashkëngjitur, më vonë të njohur si Urimi dhe Thumimi.

ILUSTRIMI NGA ROBERT T. BARRETT

PËRKTHIMI I FLETËVE, NGA EARL JONES, ME MIRËSINË E MUZEUT TË HISTORISË SË KISHËS

Përshkrimi i artistit për Jozef Smithin dhe një shkrues duke përkthyer me një batanije të vendosur në mes tyre. Edhe pse nuk përmendet asnjë batanije në shumicën e përshkrimeve të procesit të përkthimit, një batanije me sa duket u përdor në një kohë të hershme për ta veçuar shkruesin nga të shikuarit e fletëve, gjyzlykëve ose parzmores. Gjatë pjesës së mëvonshme të përpjekjes së përkthimit, një batanije mund të jetë përdorur për t'i veçuar përkthyesin dhe shkruesin nga njerëz të tjerë, kureshtarë për ta vëzhguar përkthimin.

Fjalë PËR TA NDRYSHUAR Botën TONË

Nga Norman C. Hill
President, Misioni Perëndimor i Akrës në Ganë

Një këshill distrikti në Ganë vë në dukje se si këshillimi së bashku dhe përdorimi i burimeve vendore mund të krijojnë mundësi për rritje vetjake dhe shërbim ndaj të tjerëve.

Motra Vida Osei nga Gana donte të mësonte të lexonte dhe shkruante anglisht. Ajo i kishte provuar programet e komunitetit disa herë, por e kishte humbur kurajën dhe kishte hequr dorë brenda disa javësh. Atëherë, një të diel, teksa frekuentonte mbledhjet në Degën e Dytë, ajo mësoi se Distrikti Asamankese po sponsorizonte një program për të mësuar shkrim-këndimin e anglishtes. Vendosi ta provonte dhe të regjistrohej.

Shpejt mësoi se ky program ishte i ndryshëm. Ajo do të ishte në gjendje ta frekuentonte me shoqe nga kisha. Shkrimet e shenjta përdoren si materiale studimi, kështu që ajo do të mësonte anglishten dhe ungjillin në të njëjtën kohë.

Dy muaj pasi e filloi klasën, Vida bëri lutjen e saj të parë në klasë – të parën fare. Tre muaj pas fillimit, ajo dha bisedën e saj të parë fare në mbledhjen e sakramentit, pjesërisht në tuisht, një gjuhë vendore afrikane, dhe pjesërisht në anglisht. Katër muaj pas fillimit, ajo filloi të shkruante në një fletore të vjetruar porositë, shpenzimet dhe çmimet për punën e saj si rrobaqepëse e vetëpunësuar. Ajo bëri më pak gabime me klientët, mori çmime më të ulëta nga shitësit dhe bëri më shumë para sesa kishte bërë më parë në çfarëdo muaji të kaluar.

"Isha shumë e druajtur të ndiqja një klasë shkrim-këndimi me këdo", tha ajo. "Por kur klasa e shkrim-këndimit u mbajt në një shtëpi mbledhjesh të kishës, me anëtarë që i njihja, mora kurajën që të përpiqesha sërish. Dhe tani unë mund t'i lexoj shkrimet e shenjta dhe ta përmirësoj biznesin tim nëpërmjet leximit dhe shkrimit të anglishtes."

Në pjesën e Afrikës në jug të shkretëtirës së Saharasë, shumë njerëz, veçanërisht gratë, nuk dinë se si të lexojnë dhe të shkruajnë. Analfabetizmi është kaq gjerësisht i përhapur sa një fjalë e urtë afrikane thotë: "Nëse do ta fshehësh diçka, shkruaje atë në një libër". Për gratë shenjtore të ditëve të mëvonshme si Vida, megjithatë, njohuria për shkrim-këndim është duke u shtuar.



ILUSTRIMI NGA TAYLOR CALLERY

Pjesëmarrësit, anëtarët e familjeve dhe miqtë festojnë në ceremonitë e diplomimit për programin e shkrim-këndimit të sponsorizuar nga distrikti.

Sfida për t'u Kapërcyer

Infrastruktura e kufizuar dhe arsimimi i kufizuar publik në shumicën e shteteve në jug të shkretëtirës së Saharasë nënkuptojnë mundësi të kufizuara, veçanërisht për vajzat. Për shkak të kostos së lartë të shkollimit dhe gjendjes së nënshtruar të vajzave në shoqëri, për shumë njerëz leximi duket si një aftësi e paarritshme. Në Ganë, për shembull, edhe pse anglishtja është gjuha zyrtare, vlerësimet thonë se më pak se gjysma e grave të rritura flasin anglisht. Në zonat fshatare të Ganës, dy të tretat e grave të rritura janë analfabete.

"Shumica e grave të rritura në qytezat dhe fshatrat tona nuk flasin anglisht", thotë Seth Opongu, presidenti i Distriktit Abomosu në Misionin Perëndimor të Akrës në Gana. "Gjuha jonë vendore, tuishtja, ka qenë një gjuhë e pashkruar për shekuj. Vetëm kohët e fundit është krijuar një alfabet për tuishten, prandaj pak njerëz e lexojnë, nëse munden."

"Motrat duhet të mbështeten te njerëz të tjerë – kryesisht bashkëshortët e tyre nëse janë të martuara, ose në fjalët që iu thuhen nga mikeshat e tyre, nëse nuk janë të martuara – për t'i kuptuar parimet e ungjillit dhe rregulloren e Kishës", shpjegon Xhorxhina Amoaka, presidentja e Shoqatës së Ndihmës për distriktin. "Shumë kanë dëshira të mëdha për të shërbyer, por ato nuk mund t'i lexojnë manualet apo revistat, kështu që mundësitë e tyre për të marrë pjesë në kishë janë të kufizuara."

Këshilla nga Këshilli

Derisa gratë nuk flasin anglisht në shtëpitë e tyre ose në treg, pjesëmarrja në Kishë siguron nxitjen e tyre kryesore për ta mësuar gjuhën. Prapëseprapë anëtarët për një kohë të gjatë dhe të kthyerit e rinj në besim mund të hasin kundërshtim nga familja lidhur me programet e mësimit të shkrim-këndimit. Këshilli i distriktit e diskutoi këtë shqetësim dhe më pas Presidenti Opong foli me udhëheqësit e priftërisë dhe udhëheqëset e organizatave ndihmëse në secilën degë rreth një programi për të gjithë distriktin lidhur me të mësuarin e shkrim-këndimit. Edhe pse lejohej për të gjitha gratë në komunitet, programi do të përqendrohej te gratë në Kishë. Në vend që të ftoheshin individët veç e veç, ftesat do të drejtoheshin për të marrë pjesë në grupe – për shembull, presidencat e Shoqatës së Ndihmës dhe të Fillores do të merrnin pjesë së bashku, kështu që të mund ta mbështetnin njëra-tjetrën.

Bazuar në diskutimet me degët, udhëheqja e distriktit vendosi të mbante klasa për të mësuar shkrim-këndim në secilën degë të dielave, si edhe dy herë gjatë javës. Pas një përpjekjeje të përqendruar gjashtëmujore, certifikatat e përfundimit do t'u jepeshin atyre që frekuentonin rregullisht dhe i përfundonin detyrat e caktuara për në shtëpi.

Burimet iu Përshtatën Nevojave

"Një nga sfidat ishte të gjendej një mënyrë për t'iu mësuar lexim dhe shkrim njerëzve që kanë vetëm një gjuhë të folur", shpjegon Plaku Xhim Dalton, një misionar i moshuar që shërben në distrikt. "Për shkak të traditës së gjatë të tuishtes si një gjuhë vetëm e folur dhe e pashkruar, shumica e njerëzve që e flasin atë nuk dinë se si ta shkruajnë, kështu që ne duhej t'ia fillonim duke u mësuar atyre se si të shkruajnë."

Ransford Darkuahu, i këshillit të lartë të Distriktit Abomosu, punoi me dy misionare të kthyer nga misionet, Frensis Ansahun dhe Seselia Amankuahun, për të përdorur një manual të prodhuar në zonën vendore. Pjesëmarrësve iu tregoheshin figura dhe iu kërkohej të shkruanin rreth asaj që shihnin. Kjo i ndihmoi ata të zhvillonin aftësitë bazë të shkrimit ndërkohë që mësonin të mendonin në anglisht. Sapo disa aftësi bazë ishin fituar, burime më të përparuara për të mësuar mund të përdoreshin më pas.

Përgatitja dhe Përshtatja

Përpara se të fillonte programi, specialistë për shkrim-këndimin përgatitën instruktorë jo vetëm për metodat e të mësuarit, por edhe për mënyrën se si të jepnin mësim për higjienën e përditshme dhe aftësitë për jetën familjare. Por edhe përgatitja më e mirë nuk mund t'i kishte parashikuar disa nga sfidat e hasura kur klasat filluan: ndërprerjet e vazhdueshme të energjisë elektrike në zonën i bënë klasat

e mbrëmjes të vështira për t'u drejtuar, ankth u krijua nga thashethemet se minatorët e papërmbajtshëm të arit po sorollateshin nëpër rrugë natën dhe me raste ata që i kishin çelësat nuk ishin në gjendje të vinin në kohë për t'i hapur godinat e kishës.

Edhe një herë, këshilli i distriktit diskutoi për atë që nevojitej të bëhej. Në përgjigje të këshillës së tyre, grupet e pjesëmarrësve filluan të vinin në klasë së bashku. Atyre iu dhanë elektrikë dore që t'i ndihmonin të ecnin të sigurt përgjatë shtigjeve të formuara nga hapat. Udhëheqësit vendorë autorizuan përdorimin e gjeneratorëve për të pasur drita natën në godinat e kishës. Anëtarëve të mirëbesuar, të cilët jetonin pranë godinave, iu dhanë çelësa që të mund t'i hapnin godinat në kohë.

Prezantimet gjatë Diplomimit

Gjashtëdhjetë e një anëtarë dhe kërkues e filluan programin. Dyzet e tre i përfunduan të gjitha sesionet dhe detyrat e shtëpisë. Gjatë diplomimit, ato u ftuan të jepnin prezantime të shkurtra.

"Përpara se të fillonte programi i shkrim-këndimit, unë nuk mund të lexoja aspak", tha Sandra Obeng Amohu e Degës Sankubenase. "Kur bashkëshorti im udhëtonte për punë, unë kurrë nuk pata mbrëmje familjare. Disa javë më parë kur ai kishte ikur, djali im më i madh më ndihmoi të lexoja manualin dhe unë iu dhashë një mësim në anglisht fëmijëve të mi. Që nga ajo kohë, e kam bërë këtë gjë çdo javë që bashkëshorti im nuk është në shtëpi."

Prosper Gajkete, i cili pavarësisht nga aftësitë e tij të kufizuara të anglishtes, ka mbetur një anëtar besnik në Degën e Dytë të Abomosut, lexoi një dëshmi prej tri fjalish që e shkroi vetë. Ai tha se nuk mund të lexonte ose shkruante përpara klasës, por tani ai mund t'i ndihmojë fëmijët e tij të vegjël me detyrat e tyre të shtëpisë. "Falë asaj që kam mësuar", tha ai, "unë mund të jem një atë më i mirë".

"Tani unë mund t'i lexoj shkrimet e shenjta vetë", tha Kuaku Sasu nga Dega Kuabeng. "Më parë e dija që Libri i Mormonit ishte i vërtetë, edhe pse nuk mund ta lexoja atë. Tani e di se është i vërtetë *teksa* e lexoj atë. Dëshmia ime po rritet e rritet."

Anëtaret e presidencës së Shoqatës së Ndihmës së Degës Asunafo thanë se ato përkushtuan çdo të enjte për të folur me njëra-tjetrën vetëm në anglisht. "Ajo i bëri disa biseda më të gjata atë ditë ngaqë ne nuk mund të mendonim për fjalët e duhura që t'ia thoshim njëra-tjetrës", tha Evelin Agueiua, presidentja e Shoqatës së Ndihmës. "Por shpejt filluam të përkthenim për njëra-tjetrën, duke gjetur fjalët e duhura për t'i thënë. Ngaqë po mësonim së bashku, asnjërës prej nesh nuk i vinte turp ose nuk kishte frikë se thoshte fjalët e gabuara. Ne thjesht e ndihmonim njëra-tjetrën."

Përfitimet Shtohen

Gratë që e përfunduan programin e shkrim-këndimit në Distriktin Abomosu, thanë se ato u ndien më mirë rreth vetes dhe kishte më shumë të ngjarë të merrnin pjesë në kishë. Ato u bënë më të gatshme për të pranuar thirrje, për të lexuar shkrimet e shenjta dhe për të dhënë mësim si në kishë ashtu edhe në shtëpi. Disa burra gjithashtu e përfunduan programin. Duke qenë fermerë që kryesisht punonin për të ushqyer familjet e tyre, ata thanë se tani janë më në gjendje të llogaritin shpenzimet dhe shitjet e prodhimit të tyre, të ndihmojnë fëmijët për detyrat e tyre të shtëpisë dhe të lexojnë shkrimet e shenjta vetë dhe me familjet e tyre.

Të nxitur nga suksesi në Abomosu, Distrikti fqinj Asamankese ka filluar programin e vet të shkrim-këndimit.

"Aftësimi për të lexuar e shkruar po e ndryshon jetën tonë dhe jetën e fëmijëve tanë", tha Gledis Aseidu nga Dega Sankubenase. "Fjalët po e ndryshojnë botën tonë dhe ne e falënderojmë Atin tonë në Qiell." ■



MBËSHTETJA E FRYMËZUAR TE VETJA

"Nuk ka përgjigje që të zbatohet për të gjithë në mirëqenien e Kishës. Ai është një program i të ndihmuarit të vetes ku individët janë përgjegjës për mbështetjen përkatëse te vetja. Burimet tona përfshijnë lutjen vetjake, talentet dhe aftësitë përkatëse që na janë dhënë nga Perëndia, pasuri që na vihen në dispozicion nga vetë familjet tona dhe anëtarët e fisit, burimet e ndryshme të komunitetit dhe me siguri mbështetjen përkujdesëse të kuorumeve të priftërisë e të Shoqatës së Ndihmës. . . .

Në fund të fundit, ju duhet të bëni në zonën tuaj atë që kanë bërë dishepujt e Krishtit në çdo periudhë ungjillore: të këshilloheni bashkë, të përdorni gjithë burimet që keni në dispozicion, të kërkoni frymëzimin e Frymës së Shenjtë, të kërkoni miratimin e Zotit dhe pastaj të përvishni mëngët e të filloni nga puna."

Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, "Ndihma sipas Mënyrës së Zotit", *Liahona,* nëntor 2011, f. 53–56.

FIGURË E BËRË NË PËLHURË NGA AFRICANWAY/ISTOCK/THINKSTOCK



Nga Karol F. Mek-Konki,
Këshilltare e Parë
në Presidencën e
Përgjithshme të

Duke i Mësuar Rinisë

SE SI TË UDHËHEQË SIPAS MËNYRËS SË SHPËTIMTARIT

Të rinjtë dhe të rejat tona nuk janë thjesht udhëheqësit e ardhshëm. Ata janë udhëheqës sot. Ne mund t'i ndihmojmë ata të udhëheqin si Shpëtimtari.

Prindërve dhe udhëheqësve të rinisë, Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, u foli për baraspeshimin delikat që na nevojitet të gjejmë: "Ftojini të rinjtë të veprojnë. Ju duhet të jeni atje, por duhet të largoheni nga udha e tyre. Ju duhet të siguroni drejtim pa e kryer vetë drejtimin."[1]

Prindërit dhe udhëheqësit mund t'i ndihmojnë të rinjtë dhe të rejat të kuptojnë parime që do t'i përgatitin ata për të udhëhequr me drejtësi dhe për ta ngritur mbretërinë e Perëndisë në tokë.

Kur isha 14 vjeçe, u takova me disa të reja që ishin udhëheqëse të shkëlqyera. Në atë kohë, familja ime lëvizi në anën tjetër të Shteteve të Bashkuara dhe u bëmë anëtarë të një lagjeje të re. Nuk më kujtohet se kush shërbente në presidencën e klasës së Trëndafilave, por më kujtohet qartësisht se të rejat ishin shumë dashamirëse me mua. Ato me çiltërsi e përqafuan një vajzë të re, të frikësuar dhe të imtë, si një shoqe të humbur prej kohësh dhe më bënë të ndihesha e mirëpritur. Duke ardhur nga Delaueri, ku isha e vetmja vajzë mormone në shkollën time nëntëvjeçare dhe ku e vetmja vajzë tjetër mormone që e njihja jetonte një orë larg me makinë nga shtëpia ime, unë mendova: *"Kjo* duhet të jetë se me çfarë ngjan qielli!"

Për herë të parë në jetën time, unë kisha një rreth shoqesh, të cilat i jetonin standardet në broshurën *Për Forcën e Rinisë*, që më ftuan të merrja pjesë në aktivitete dhe që i ndanë dëshmitë e tyre për ungjillin me mua. Shembujt e tyre të dashurisë së përzemërt bënë më shumë që të më jepnin siguri për Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në atë kohë, sesa mund ta kishte bërë ndonjë bisedë apo mësim. Në dashurinë dhe dritën e tyre, të ngjashme me të Krishtit, ato ishin mesazhi i ungjillit të Krishtit dhe ishin ato që më udhëhoqën dhe udhërrëfyen për në tufën e Tij.

Ç'gjë ishte ajo që i bëri shoqet e mia të reja udhëheqëse të mëdha?

Një misionar i ri e përkufizoi udhëheqjen shumë thjesht. Ai tha: "Ne duhet të jemi në vendin e duhur, në kohën e duhur, duke bërë vullnetin e Zotit dhe duke e ndihmuar një njeri që ka nevojë për ndihmën tonë. Ajo është çfarë na bën ne një udhëheqës."[2] Duke u nisur nga kush ata janë dhe nga Drita e Krishtit që shkëlqen brenda tyre, të rinjtë dhe të rejat besnike anembanë kësaj Kishe kanë aftësinë që *të udhëheqin sipas mënyrës së Shpëtimtarit* dhe "të ndihmojnë njerëzit e tjerë të bëhen pasues të vërtetë të . . . Jezu Krishtit"[3].

Si udhëheqës, ne drejtojmë, udhëzojmë dhe ecim krah për krah me të rinjtë dhe të rejat tona. Por janë presidencat e klasave dhe të kuorumeve që janë përgjegjës për udhëheqjen dhe drejtimin e punës së klasave dhe kuorumeve të tyre, duke përfshirë përzgjedhjen e mësimeve të së dielës dhe planifikimin e aktiviteteve gjatë ditëve të javës. Udhëheqësit e klasave dhe të kuorumeve thirren dhe veçohen nën drejtimin e atyre që mbajnë çelësat e priftërisë; prandaj ata kanë autoritetin për të udhëhequr dhe për të forcuar të

rinjtë dhe të rejat e tjera. Ata ndjekin shembullin e Shpëtimtarit dhe mësojnë të shërbejnë siç shërbeu Ai dhe të jenë shërbestarë siç ishte Ai.

Mundësi për Udhëheqje nga Rinia

Udhëheqja fillon në shtëpi. "Plotësimi i detyrës sonë ndaj Perëndisë si prindër dhe udhëheqës, fillon me udhëheqjen me anë të shembullit – duke i jetuar parimet e ungjillit me qëndrueshmëri dhe zell në shtëpi", na mësoi Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. "Kjo kërkon vendosmëri dhe zell përditë."[4] Prindërit japin mësim doktrinën e Krishtit. Ata e ndihmojnë rininë të caktojë synime dhe t'i plotësojë ato. Programet Përparimi Personal dhe Detyra ndaj Perëndisë i ndihmojnë të rejat dhe të rinjtë që t'i forcojnë dëshmitë e tyre për Jezu Krishtin, të përgatiten për të bërë e mbajtur besëlidhje të shenjta dhe të përmbushin rolet dhe përgjegjësitë e tyre hyjnore në familje, shtëpi dhe Kishë.

Në kishë, udhëheqësit e Priftërisë Aarone dhe të Të Rejave mund t'i ndihmojnë të rinjtë dhe të rejat, që shërbejnë në presidencat e kuorumeve dhe klasave, për t'i kuptuar detyrat e tyre të shenjta dhe për t'i lartësuar thirrjet e tyre që të ushqejnë shpirtërisht dhe të forcojnë të gjithë anëtarët e tjetër të kuorumeve dhe të klasave.

Si udhëheqës të rritur, ne i përgatitim të rinjtë dhe të rejat që të drejtojnë mbledhjet e kuorumeve dhe të klasave, si dhe aktivitetet e Përbashkëta. Ne takohemi me rininë në mbledhjet e presidencave, ndërkohë që ata vendosin mënyra se si t'u shërbejnë atyre që po hasin vështirësi, se si ta përfshijnë të gjithë rininë në mësimet e së dielës dhe se si të planifikojnë aktivitete, projekte shërbimi, kampe dhe konferenca të rinisë.

Ne i nxitim presidencat e rinisë që t'i ndihmojnë të gjithë anëtarët e kuorumeve dhe të klasave për të marrë pjesë në çdo fushë të punës së shpëtimit, duke përfshirë punë misionare nga anëtarët, mbajtjen aktive të të kthyerve në besim, aktivizimit e anëtarëve më pak aktivë, punën në tempull, punën për historinë familjare dhe mësimdhënien e ungjillit.[5] Presidencat e rinisë i ndihmojnë të gjithë të rinjtë dhe të rejat që të mësojnë gëzimin dhe bekimin e të shërbyerit në emrin e Shpëtimtarit dhe të të ushqyerit të deleve të Tij.

Puna e udhëheqësit nuk është të bëjë fletushka të përsosura me anë të programit Pinterest apo të japë leksione të mbushura me fakte. Puna e udhëheqësit është t'i ndihmojë të rinjtë e të rejat të mësojnë dhe të vënë në jetë parime, të cilët do t'i ndihmojnë *ata* të udhëheqin sipas mënyrës së Shpëtimtarit. Sa vijon janë katër nga ato parime.[6]

Përgatitini Shpirtërisht

Ndihmojeni rininë të kuptojë fuqinë e përgatitjes së saj vetjake, shpirtërore. Mësojuni atyre të ushtrojnë besim te besëlidhjet që i bëjnë në ordinancën e sakramentit. Gatishmëria e tyre për të marrë mbi vete emrin e Krishtit, për ta kujtuar Atë dhe për t'i zbatuar urdhërimet e Tij i kualifikon ata që të kenë gjithmonë shoqërimin e Frymës së Shenjtë. Ata nuk janë të vetëm në shërbimin e tyre kur janë në gjendje të marrin, dallojnë dhe veprojnë sipas nxitjeve të Frymës së Shenjtë.

Ata përgatiten shpirtërisht duke kërkuar udhëzim nëpërmjet lutjes së zjarrtë dhe duke i hetuar shkrimet e shenjta për përgjigje. Ata përpiqen t'i zbatojmë urdhërimet me qëllim që Fryma e Shenjtë t'iu flasë në zemrën dhe mendjen e tyre, që ata të mund të ndiejnë dhe të dinë se kush ka nevojë për ndihmën e tyre dhe çfarë mund të bëjnë ata. Ata e ndiejnë dashurinë e pastër të Krishtit për çdo anëtar/e të klasës ose kuorumit.

PËRMASA E DUHUR E UDHËRRËFIMIT

Rinia ka nevojë për nivele të ndryshme të mbështetjes ndërkohë që mësojnë se si të udhëheqin. Disa mund të bëjnë më shumë vetë; të tjerëve do t'iu nevojitet më shumë udhëzim. Prindërit mund të këshillohen së bashku teksa i ndihmojnë fëmijët e tyre të mësojnë se si të udhëheqin dhe presidencat e Të Rinjve dhe Të Rejave mund të këshillohen së bashku dhe me peshkopët dhe këshilltarët e tyre, ndërkohë që përcaktojnë se sa udhëzim t'i japin çdo të riu dhe çdo të reje në lagje. Synimi: ta ndihmojnë çdo të ri dhe çdo të re që të përmirësohet, duke filluar nga gjendja ku është.

Përgatitja shpirtërore u jep të rinjve vetëbesimin se ata janë vepruesit e Zotit dhe se ata janë në punën e Tij (shih DeB 64:29).

Merrni Pjesë në Këshilla

Mësojini rinisë urdhrin themeltar dhe fuqinë zbuluese të këshillave, kur marrin pjesë në këtë proces të krijuar në mënyrë hyjnore, nëpërmjet të cilit qeveriset Kisha e Zotit dhe bekohen individët e familjet.[7] Komiteti i peshkopatës për rininë dhe mbledhjet e presidencave të kuorumeve dhe klasave janë këshillat ku të rinjtë e të rejat i mësojnë detyrat e tyre dhe marrin përgjegjësi për t'iu dhënë shërbesë të tjerëve.

Anëtarët e këshillave:

- Bashkohen me drejtimin e udhëheqësve të priftërisë dhe e ndjekin drejtimin e atyre që mbajnë çelësat e priftërisë.
- I japin mendimet dhe idetë e tyre me një shpirt drejtësie, shenjtërie, besimi, virtyti, durimi, dashurie hyjnore dhe dashamirësie vëllazërore.
- Punojnë së bashku, sikurse udhëzohen nga Fryma e Shenjtë, për të planifikuar se çfarë do të bëjnë për t'i ndihmuar njerëzit nevojtarë.

Jepuni Shërbesë të Tjerëve

Të rinjtë dhe të rejat udhëheqin sipas mënyrës së Shpëtimtarit kur ata japin shërbesë me dashuri e mirësi. Jozef Smithi na mësoi: "Asgjë nuk është kaq e mirëllogaritur për t'i çuar njerëzit që të braktisin mëkatin sesa t'i marrësh ata për dore dhe t'i mbrosh ata me butësi. Kur persona shfaqin mirësinë dhe dashurinë më të vogël ndaj meje, o çfarë fuqie ka kjo mbi mendjen time."[8]

Shpëtimtari na mësoi vlerën e çmuar dhe të paçmueshme të çdo shpirti (shih DeB 18:10–15). Ndihmojeni rininë tonë të kuptojë të vërtetën e lavdishme që Jezu Krishti e dha jetën e Tij dhe hapi udhën që të gjithë njerëzit të mund të vijnë tek Ai. Në mirënjohje për atë që Ai ka bërë, shërbëtorët e vërtetë të Zotit i afrohen dhe i japin shërbesë me dashamirësi të përzemërt çdo të riu dhe çdo të reje, për të cilët Shpëtimtari sakrifikoi gjithçka.

Jepeni Mësim Ungjillin e Jezu Krishtit

Ndihmojini të rinjtë dhe të rejat që të dallojnë mundësitë për ta dhënë mësim ungjillin dhe që të kuptojnë se mësimdhënia e tyre më e rëndësishme do të jetë shembulli i tyre. Kur rinia jeton sipas fjalëve të profetëve dhe i mban standardet e dhëna në broshurën *Për Forcën e Rinisë*, ata udhëheqin sipas mënyrës së Shpëtimtarit. Nëpërmjet integritetit moral të fjalëve dhe veprimeve të tyre, ata tregojnë se çfarë do të thotë të jesh një dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit. Ata qëndrojnë si dëshmitarë të Tij pa hipokrizi. Më pas, kur të japin dëshmi, të ndihmojnë për të dhënë mësim një të diel apo t'ua thonë të vërtetat e ungjillit shokëve dhe shoqeve të tyre, ata do të mbushen me Shpirtin dhe fjalët e tyre do të kenë fuqi për të kthyer në besim.

Udhëhiqni sipas Mënyrës së Shpëtimtarit

Që të udhëhiqni sipas mënyrës së Shpëtimtarit është një privilegj i shenjtë, i cili do t'i kërkojë rinisë që të japin gjithçka munden teksa i shërbejnë Zotit në shtëpi, në Kishë dhe në komunitet. Të rinjtë dhe të rejat që udhëheqin sipas mënyrës së Shpëtimtarit, bëhen mesazhi i ungjillit të Krishtit, përgjigjja ndaj lutjes së dikujt, engjëjt që u japin shërbesë njerëzve nevojtarë dhe drita e Krishtit për botën. ■

SHËNIME

1. David A. Bednar, "Youth and Family History", lds.org/youth/family-history/leaders.
2. Letër nga nipi i Karol F. Mek-Konkit, 13 mars 2015.
3. *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 3.1.
4. Robert D. Hejls, "Detyra Jonë ndaj Perëndisë: Misioni i Prindërve dhe Udhëheqësve ndaj Brezit të Ri", *Liahona,* maj 2010, f. 95.
5. Shih *Manuali 2,* 5.
6. Shih *Manuali 2,* 3.2.
7. Shih *Manuali 2,* 4.1.
8. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 421, 456.

KREMTIMI I MBRËMJES FAMILJARE

Në vitin 1915, profetët e ditëve të mëvonshme na këshilluan që ta veçonim një mbrëmje në javë për familjet tona. Në fillim ajo u quajt "mbrëmja e shtëpisë" – një kohë për të mësuar ungjillin dhe për t'u zbavitur së bashku, ndërkohë që i forconim lidhjet tona tokësore dhe të përjetshme.

Njëqind vjet më vonë, mbrëmja familjare vazhdon të na ndihmojë për të krijuar familje që do të vazhdojnë për përjetësinë. Profetët premtojnë se nëpërmjet saj, besim më i madh dhe forcë shpirtërore më e madhe do të rritet në zemrën tonë dhe mbrojtje, unitet e paqe më e madhe do të banojnë në shtëpitë tona.

Ne të gjithë i përkasim një familjeje në tokë dhe jemi pjesë e familjes së Atit tonë në Qiell. Kudo ku jemi në botë dhe cilado qoftë gjendja jonë në jetë, ne mund të festojmë e të marrim pjesë në mbrëmjen familjare. ■

Majtas: Familja Moua kohët e fundit u vendos në Tajlandë, ku ata mësuan ungjillin dhe u pagëzuan. Gjatë mbrëmjes familjare ata studiojnë Librin e Mormonit si në hmongisht, gjuhën e tyre amtare, ashtu edhe në tajlandisht, gjuhën e vendit të tyre të ri.

Poshtë: Zbavitja dhe luajtja e lojërave është një mënyrë se si familja Santos në Portugali krijon ndjenja të afërta miqësore në mbrëmjen familjare.

Djathtas: Familja do të thotë më shumë se sa nëna, babai dhe fëmijët në Republikën Demokratike të Kongos. Kështu që kur Vëllai Suekameno e mbledh familjen e tij për mbrëmjen familjare, shumë njerëz nga fshati ndihen të mirëpritur që të bashkohen me ta.

Lart: Motra Gerkan nga Filipinet përdor këngët e Fillores dhe muzikën tradicionale për t'iu mësuar fëmijëve të saj gëzimin e ungjillit.

Lart: Familja Anderson, e fotografuar këtu në kuzhinën e shtëpisë së tyre në Xhorxhia të SHBA-së, pëlqen shumë bërjen e biskotave. Ata nganjëherë i përdorin ato si pjesë të një mësimi ose thjesht si një ëmbëlsirë.

Lart: Vëllai dhe Motra Rejnolds nga Uashingtoni në SHBA kërkojnë mënyra për ta dhënë mësim ungjillin në mënyrë të thjeshtë, që fëmijët e tyre të vegjël të mund të mësojnë dhe kuptojnë.

Djathtas, nga lart: Familja Espinoza nga Bolivia përfshin gjyshen e tyre të nderuar në mbrëmjen familjare, teksa këndojnë dhe mësojnë për ungjillin.

Për familjen Jin në Xhorxhia të SHBA-së, historia familjare është një veprimtari e parapëlqyer i mbrëmjes familjare. Ata kënaqen duke iu mësuar fëmijëve të tyre rreth trashëgimisë së tyre koreane.

Familja Ligërtud nga Australia nganjëherë dalin shëtitje si pjesë e mbrëmjes së tyre familjare, duke eksploruar pjesë të bukura të qytetit të tyre.

Shihni faqen 3 në secilin botim të revistës Liahona *për ide për mbrëmje familjare.*

Shpërndani foto ose video të mbrëmjes suaj familjare duke përdorur #FamilyNight.

Mësoni më shumë në facebook.com/liahona.magazine.

Duke e kup-tuar dhe duke e ndjekur me bindje planin e Perëndisë, ne e ruajmë veten që të mos endemi jashtë shtegut, i cili na kthen sërish drejt Atit tonë Qiellor.

Nga Plaku
Robert D. Hejls,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Plani i Shpëtimit

NJË THESAR I SHENJTË DITURIE PËR TË NA UDHËRRËFYER NE

Kyçi i suksesit tonë në jetën para lindjes ishte mbështetja jonë për planin e Atit. Ai është po ashtu kyçi i suksesit tonë në jetën në vdekshmëri.

Shpesh kam përsiatur për mungesën e shpresës së fëmijëve të Perëndisë duke u endur në botën e errët dhe të zymtë, duke mos ditur se kush janë, nga erdhën, përse janë këtu në tokë ose ku do të shkojnë pas jetës së tyre në vdekshmëri.

Ne nuk kemi nevojë të endemi. Perëndia ka zbuluar të vërteta të përjetshme për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Ato gjenden në planin e Tij të madh për fëmijët e Tij. Në shkrimet e shenjta ky plan njihet si "plani i shëlbimit"[1], "plani i lumturisë"[2] dhe "plani i shpëtimit"[3].

Duke e kuptuar dhe duke e ndjekur me bindje planin e Perëndisë, ne e ruajmë veten që të mos endemi jashtë shtegut, i cili na kthen sërish drejt Atit tonë Qiellor.[4] Atëherë, dhe vetëm atëherë, mund ta jetojmë llojin e jetës që Ai jeton, që është "jet[a e] përjetshme, . . . më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë"[5].

Dhurata e jetës së përjetshme ia vlen çdo përpjekje për ta studiuar, mësuar e zbatuar planin e shpëtimit. I gjithë njerëzimi do të ringjallet dhe do ta marrë bekimin e pavdekësisë. Por që të fitojmë jetë të përjetshme – jetën që jeton Perëndia[6] – ia vlen ta jetojmë planin e shpëtimit me gjithë zemrën, mendjen, fuqinë dhe forcën tonë.

AHET, NGA ASHER BROWN DURAND, © MUZEU METROPOLITAN I ARTIT, BURIMI I PAMJES: ART RESOURCE, NJ, NUK MUND TË KOPJOHET.

Të Kuptuarit e Planit të Shpëtimit

Sa fuqizuese është ta dimë planin! Plani i shpëtimit është një nga thesaret më të mëdha të diturisë së dhënë ndonjëherë njerëzimit, sepse ai shpjegon qëllimin e përjetshëm të jetës. Pa të, ne me të vërtetë endemi në errësirë. Kjo është arsyeja përse modeli i Perëndisë është që t'iu japë urdhërime fëmijëve të Tij "*pasi* u[a] bëri të ditur planin e shëlbimit"[7].

Dëshira ime është që ta ndihmoj secilin prej nesh që të përfitojë nga ky thesar diturie – që ta kuptojmë më mirë planin e shpëtimit dhe që ta zbatojmë atë kuptueshmëri në jetën tonë të përditshme.

Liria e Zgjedhjes

Ngaqë liria e zgjedhjes është thelbësore për këtë plan, le ta fillojmë atje. Ati ynë na ka dhënë aftësinë për të vepruar ose për të mos pranuar të veprojmë[8] sipas të vërtetave të përjetshme – të vërtetave që e bëjnë Perëndinë atë që Ai është dhe qiellin atë që ai është.[9] Nëse e përdorim lirinë tonë të zgjedhjes për t'i pranuar e jetuar këto të vërteta, ne marrim gëzim të përhershëm. Anasjelltas, nëse e përdorim lirinë tonë të zgjedhjes për të mos u bindur, për t'i mohuar ligjet e Perëndisë, ne përjetojmë vuajtje dhe hidhërim.[10]

Jezu Krishti ishte Biri i dashur, i zgjedhur dhe i parashuguruar i Atit që nga fillimi.

Liria e zgjedhjes siguron një prapaskenë të përshtatshme për të tre kapitujt e planit të shpëtimit: jetën para lindjes, jetën në vdekshmëri dhe jetën pas vdekjes.

Jeta Para Lindjes

Siç shpallet te "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", secili prej nesh "është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë" me "një natyrë dhe destinacion hyjnor"[11]. Në këshillin në botën para lindjes, Ati Qiellor na shpjegoi planin e Tij të shëlbimit.[12] Plani u bazua mbi doktrinën, ligjin dhe parimet që kanë ekzistuar gjithmonë.[13] Ne mësuam që, nëse e pranojmë dhe e ndjekim planin, neve do të na kërkohet ta lëmë me dëshirë praninë e Atit tonë dhe të vihemi në provë për të treguar nëse do të zgjidhnim të jetonim sipas ligjeve dhe urdhërimeve të Tij.[14] Ne u gëzuam për këtë mundësi[15] dhe me mirënjohje e mbështetëm planin, sepse ai na ofronte mënyrën se si të bëheshim si Ati ynë Qiellor dhe të trashëgonim jetë të përjetshme.

Por plani nuk ishte pa rrezik: nëse zgjedhim në vdekshmëri që të mos jetojmë sipas ligjeve të përjetshme të Perëndisë, ne do të marrim diçka më pak sesa jeta e përjetshme.[16] Ati e dinte se ne do të pengoheshim dhe mëkatonim, ndërkohë që mësonim me anë të përvojës në vdekshmëri, kështu që Ai siguroi një Shpëtimtar për të shëlbuar nga mëkati të gjithë ata që pendohen dhe për t'i shëruar plagët shpirtërore dhe emocionale të atyre që binden.[17]

Jezu Krishti ishte Biri i dashur, i zgjedhur dhe i parashuguruar i Atit që nga fillimi.[18] Ai e mbështeti planin e Atit dhe ofroi të ishte Shpëtimtari ynë, duke thënë: "Ja ku jam, dërgomë mua"[19]. Prandaj Jezusi u caktua nga Ati të ishte Ai që do të jetonte një jetë të pamëkatë në vdekshmëri, do të shlyente për mëkatet dhe fatkeqësitë tona dhe do të ringjallej për t'i këputur lidhjet e vdekjes.

Luciferi, i cili u njoh më pas si Satani, gjithashtu jetoi në ekzistencën para lindjes.[20] Për arsye egoiste, ai e mohoi planin, kërkoi ta shkatërronte lirinë e njeriut për të zgjedhur dhe ngriti krye kundër Atit.[21] Si pasojë, Satani dhe ata që e ndoqën, nuk do të kenë kurrë një trup. Ata e humbën mundësinë e tyre për të marrë pjesë në planin e Atit dhe e humbën fatin e tyre hyjnor.[22] Sot ata e vazhdojnë luftën e tyre të kryengritjes kundër Perëndisë dhe kërkojnë ta kthejnë mendjen dhe zemrën e njerëzimit kundër Tij.[23]

Kjo tokë u projektua dhe u krijua për ata që e pranuan planin e Atit.[24] Këtu ne marrim një trup të krijuar në shëmbëlltyrën dhe ngjashmërinë e Perëndisë. Këtu ne vihemi në provë dhe provohemi. Këtu ne fitojmë përvojën e nevojshme për të trashëguar jetë të përjetshme.[25]

Jeta në Vdekshmëri

Perëndia krijoi Adamin dhe Evën dhe i bashkoi ata si bashkëshort e bashkëshorte, i vendosi në Kopshtin e Edenit dhe i urdhëroi të kishin fëmijë.[26] Duke e ushtruar lirinë e tyre të zgjedhjes, Adami dhe Eva së bashku ranë prej pranisë së Perëndisë dhe u bënë qenie të vdekshme.[27] Kjo e

DETAJ NGA *KRISHTI NË EMAUS*, NGA CARL HEINRICH BLOCH; DETAJ NGA *ADAMI DHE EVA*, NGA DOUGLAS M. FRYER

Duke e ushtruar lirinë e tyre të zgjedhjes, Adami dhe Eva së bashku ranë prej pranisë së Perëndisë dhe u bënë qenie të vdekshme.

përmbushi planin e Atit duke bërë të mundur që ata të kishin fëmijë, gjë të cilën nuk mund ta bënin në Kopshtin e Edenit.[28] Me anë të ligjit të përjetshëm, fuqia hyjnore e riprodhimit duhet të përdoret brenda kufizimeve të caktuara nga Ati ynë Qiellor. Bërja e kësaj gjëje siguron mundësinë për gëzim të përjetshëm. Çfarëdo përdorimi i kësaj fuqie të shenjtë jashtë kufijve të Perëndisë do të përfundojë më së fundi në mjerim.[29]

Satani, i cili dëshiron që të gjithë njerëzit "të jenë të mjeruar sikurse është ai vetë"[30], përpiqet të na largojë nga mundësitë e vëna në dispozicion nëpërmjet planit të Atit. Përse Ati Qiellor e lejon Satanin të na tundojë? Sepse Ai e di që kundërshtimi është i nevojshëm për rritjen dhe provimin tonë në vdekshmëri.[31] Kundërshtimi na jep një mundësi që të kthehemi te Perëndia dhe të mbështetemi tek Ai. Ngaqë e mira dhe e liga janë vazhdimisht përpara nesh, ne mund t'i shprehim me qartësi dëshirat e zemrave tona duke e përqafuar njërën dhe duke e mohuar tjetrën.[32] Kundërshtimi mund të gjendet tek tundimet e Satanit, por edhe te vetë dobësia jonë, pavendosmëritë e vdekshmërisë që trashëgohen në gjendjen njerëzore.[33]

Për të na ndihmuar që të zgjedhim me urtësi, Perëndia ka zbuluar planin e Tij të shëlbimit dhe ka dhënë urdhërimet[34], Dritën e Krishtit[35] dhe shoqërimin e Frymës së Shenjtë[36]. Prapëseprapë, edhe me të gjitha këto dhurata, çdonjëri prej nesh, në këtë botë të rënë, kryen mëkat dhe prandaj ne të gjithë jemi të paaftë që të hyjmë në praninë e Perëndisë bazuar në vetë meritat tona.[37] Kjo është arsyeja përse plani i Tij i mëshirshëm siguron një Shpëtimtar.

Jezu Krishti erdhi në tokë si Biri i Vetëmlindur i Perëndisë dhe e përmbushi misionin e caktuar Atij përsosurisht duke iu nënshtruar vullnetit të Atit në të gjitha gjërat.[38] Sipas planit mëshirëplotë të Atit, efektet e Rënies mposhten nëpërmjet Ringjalljes së Shpëtimtarit[39], pasojat e mëkatit mund të kapërcehen dhe dobësia mund të kthehet në forcë, në

Vetë thelbi i jetës së përjetshme përfshin martesën e përjetshme të burrit dhe të gruas, e cila është një pjesë thelbësore e bërjes si prindërit tanë qiellorë.

qoftë se e vëmë veten tonë në dispozicion të Shlyerjes së Jezu Krishtit[40].

Ne mund të kualifikohemi për jetë të përjetshme vetëm nëpërmjet bindjes ndaj urdhërimeve. Kjo kërkon të kemi besim te Zoti Jezu Krisht, të pendohemi, të pagëzohemi, të marrim dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe të durojmë deri në fund duke e ndjekur shembullin e Shpëtimtarit.[41] Në parim, ne duhet t'i marrim të gjitha ordinancat thelbësore të priftërisë dhe të durojmë deri në fund në mbajtjen e besëlidhjeve të lidhura me to.

Jeta Pas Vdekjes

Pasi të vdesim, ne vërtet do të qëndrojmë një ditë përpara Shpëtimtarit për t'u gjykuar.[42] Ngaqë Perëndia është i mëshirshëm, ata që e ushtrojnë besimin e tyre në Krishtin deri në pendim, do të falen dhe do të trashëgojnë gjithçka që Ati ka, përfshirë jetën e përjetshme.[43] Ngaqë Perëndia është i drejtë, çdo njeri që nuk pendohet, nuk do ta marrë dhuratën e jetës së përjetshme.[44] Çdo njeri do të shpërblehet sipas besimit, pendimit, mendimeve, dëshirave dhe veprave të tij ose të saj.[45]

Zbatimi i Planit të Shpëtimit në Jetën Tonë të Përditshme

Pasi e kuptojmë tablonë e madhërishme të planit dhe e shohim veten tonë tek ajo, ne fitojmë diçka të paçmuar, madje thelbësore: këndvështrimin e përjetshëm. Këndvështrimi i përjetshëm na ndihmon në marrjen e vendimeve dhe në veprimet tona të përditshme. Ai i bën të qëndrueshme mendjen dhe shpirtin tonë. Kur opinionet që përpiqen të na bindin, por me të meta të përjetshme, shtillen përreth nesh, ne qëndrojmë të palëkundur dhe të palëvizshëm.

Sikurse na mësoi Plaku Nil A. Maksuell (1926–2004) i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve: "Pa një kuptueshmëri të planit të shpëtimit, duke përfshirë ekzistencën tonë para lindjes dhe gjykimin e ringjalljen, përpjekja për t'i dhënë kuptim kësaj jete si e vetme do të ishte sikur të shihnim vetëm aktin e dytë të një pjese teatrale me tre akte"[46]. Ne duhet të

kuptojmë aktin e parë (jetën para lindjes) me qëllim që të dimë se si të bëjmë zgjedhjet më të mira në aktin e dytë (jetën në vdekshmëri), i cili do të përcaktojë se çfarë na ndodh në aktin e tretë (jetën pas vdekjes).

E thënë ndryshe, kuptueshmëria e planit të shpëtimit, e shoqëruar me lutjen e sinqertë, e ndryshon mënyrën se si ne e shohim jetën, këdo përreth nesh dhe veten tonë. Kuptueshmëria e planit e qartëson vegimin tonë shpirtëror dhe na lejon t'i shohim gjërat ashtu siç janë vërtet.[47] Ashtu sikurse Urimi e Thumimi e aftësuan Profetin Jozef Smith që të merrte zbulesë dhe udhërrëfim[48], po ashtu do të na tregojë njohuria për planin mënyrën se si të "veproj[më] në përputhje me doktrinën dhe parimin që i përkasin së ardhmes, lidhur me lirinë e zgjedhjes morale", që Zoti na e ka dhënë.[49] Si rrjedhim, besimi ynë do të forcohet dhe ne do ta dimë se si ta hartojmë udhëtimin e jetës sonë dhe se si të marrim vendime në përputhje me të vërtetën e përjetshme.

Ja disa shembuj që janë veçanërisht domethënës në kohën tonë.



Sipas planit të mëshirshëm të Atit, efektet e Rënies mposhten nëpërmjet Ringjalljes së Shpëtimtarit.

ILLUSTRIMI NGA JAMES JOHNSON; *IMAZHI I KRISHTIT*, NGA HEINRICH HOFFMANN

Qëllimi i Martesës në Planin e Perëndisë

Martesa dhe familja po sulmohen ngaqë Satani e di se ato janë thelbësore për të fituar jetë të përjetshme – po aq thelbësore sa Krijimi, Rënia, dhe Shlyerja dhe Ringjallja e Jezu Krishtit.[50] Ngaqë nuk ia doli mbanë të shkatërronte ndonjë prej këtyre shtyllave të planit, Satani kërkon të shkatërrojë kuptueshmërinë dhe praktikën tonë të martesës e familjes.

Me planin e Atit Qiellor si një pikë e palëvizshme referimi, qëllimi i martesës vjen qartësisht në fokus. Urdhërimi për ta lënë babanë e nënën, për t'u bashkuar me njëri-tjetrin në martesë[51] dhe për t'u shumëzuar e për ta mbushur tokën[52] e bën planin e Tij të mundshëm. Nëpërmjet martesës ne i sjellim fëmijët e Tij shpirtërorë në botë dhe bëhemi bashkëpunëtorë me Të për t'i ndihmuar fëmijët e Tij që të marrin pjesë në planin e Tij.[53]

Plani i Atit na siguron udhën për të trashëguar jetë të përjetshme, jetën që bënë prindërit tanë qiellorë. Sipas planit, "në Zotin as burri s'është pa gruan, as gruaja pa burrin"[54]. Pikërisht thelbi i jetës së përjetshme përfshin martesën e përjetshme të burrit dhe të gruas, e cila është një pjesë thelbësore e bërjes si prindërit tanë qiellorë.[55]

Martesa midis një Burri dhe një Gruaje

Në martesë ne e plotësojmë njëri-tjetrin, sikurse munden vetëm burri dhe gruaja me ndryshimet e tyre të pashoqe dhe thelbësore. Duke ecur përgjatë vdekshmërisë si bashkëshort e bashkëshorte, ne rritemi së bashku, afrohemi më pranë Shpëtimtarit kur bindemi, bëjmë sakrifica për të bërë vullnetin e Perëndisë dhe e ngremë së bashku mbretërinë e Tij. Duke e ditur që martesa e përjetshme është një urdhërim i Perëndisë dhe që Ai përgatit një udhë për fëmijët e Tij për t'i përmbushur të gjitha urdhrat e Tij[56], ne e dimë se martesat tona do të kenë sukses kur bashkohemi në mbajtjen e besëlidhjeve që kemi bërë.

Është nëpërmjet ordinancave të priftërisë dhe zgjedhjes për t'i mbajtur besëlidhjet shoqëruese, që ne marrim fuqinë e perëndishmërisë teksa ndeshemi me sfidat e vdekshmërisë.[57] Ordinancat e tempullit na dhurojnë fuqi nga lart dhe na aftësojnë që të kthehemi në praninë e Atit tonë Qiellor.[58] Ordinanca e vulosjes e aftëson bashkëshortin dhe bashkëshorten që të rriten së bashku nëpërmjet fuqisë së Perëndisë dhe që të jenë një me Zotin.[59] Çfarëdo zëvendësimi për këtë lloj martese nuk do t'i përmbushë qëllimet e Tij të shenjta për ne ose për brezat e fëmijëve të Tij që vijnë më pas.[60]

Tërheqjet dhe Dëshirat

Secili prej nesh vjen në këtë botë të rënë me dobësinë ose sfidën e qenësishme brenda gjendjes njerëzore.[61] Të kuptuarit e planit të Perëndisë na bën të aftë t'i shohim të gjitha pavendosmëritë njerëzore – duke përfshirë tërheqjet dhe dëshirat e papërputhshme me planin e Tij – si të përkohshme.[62] Dituria se jetuam përpara kësaj jete si bij dhe bija të dashur të prindërve qiellorë, na aftëson që ta nxjerrim identitetin tonë vetjak nga zanafilla jonë hyjnore. Është pozita jonë si një bir ose bijë e Perëndisë – jo pavendosmëritë ose prirjet tona – që është burimi i vërtetë i identitetit tonë.[63]

Teksa e vëmë në jetë çdo ditë njohurinë tonë për planin e Atit, në jetën tonë do të zërë vend një kuptueshmëri më e thellë.

Me këtë këndvështrim, ne jemi më të aftë për ta pritur me përulësi e durim Zotin[64], duke mirëbesuar se nëpërmjet besimit, bindjes dhe durimit tonë deri në fund, prirjet dhe dëshirat tona do të pastrohen, trupat tanë do të shenjtërohen dhe ne do të bëhemi me të vërtetë bijtë dhe bijat e Krishtit, të përsosur nëpërmjet Shlyerjes së Tij.

Këndvështrimi i përjetshëm i planit sjell sigurinë që për besnikët, patjetër do të vijë dita që "Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre; . . . as [nuk do të ketë më] mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan"[65]. Ky "ndriçim [i] përkryer [i] shpresës"[66] do t'i bëjë të qëndrueshme mendjen e zemrën tonë dhe do të na aftësojë të presim me durim dhe besnikëri për Zotin.

Premtimet për Ata që Durojnë me Besnikëri

Ata që e pyetin veten nëse rrethana ose gjendja e tyre e tanishme i shkëput ata nga jeta e përjetshme, duhet të mbajnë mend se "askush nuk është i paracaktuar që të marrë më pak sesa gjithçka që Ati ka për fëmijët e Tij"[67].

Asnjë bekim nuk do t'iu mohohet besnikëve. Presidenti Lorenco Snou shpalli: "Asnjë shenjtor i ditëve të mëvonshme, që vdes pasi ka jetuar një jetë besnike, nuk do të humbasë asgjë ngaqë nuk mundi të bëjë disa gjëra ndërkohë që atij apo asaj nuk iu dhanë mundësitë. Me fjalë të tjera, nëse një i ri apo e re nuk ka mundësi të martohet dhe jeton një jetë besnike deri në vdekjen e vet, ai apo ajo do të ketë të gjitha bekimet, ekzaltimin dhe lavdinë që mund të ketë një burrë apo grua që e pati këtë mundësi dhe e përmirësoi. Kjo është e sigurt dhe e vërtetë."[68]

Premtimet për të Gjithë Ata që e Dinë Planin dhe e Zbatojnë Atë Çdo Ditë

Secili prej nesh me gjithë zemër e mbështeti planin e Atit në jetën para lindjes. Ne e dinim se Ai na donte dhe u mahnitëm nga oferta e Tij zemërgjerë për këtë mundësi që

të trashëgonim gjithçka që Ai ka, përfshirë jetën e përjetshme. Kyçi i suksesit tonë në jetën para lindjes ishte mbështetja jonë për planin e Atit. Ai është po ashtu kyçi i suksesit tonë në jetën në vdekshmëri.

Kështu që ftesa ime është që së bashku të ngrihemi sërish në mbështetje të planit të Atit. Këtë ne e bëjmë me dashuri për të gjithë, sepse plani vetë është një shprehje e dashurisë së Perëndisë.

Teksa e vëmë në jetë çdo ditë njohurinë tonë për planin e Atit, jeta jonë do të ndërmarrë kuptim më të thellë. Ne do t'iu bëjmë ballë sfidave tona me besim më të madh. Ne do të ecim përpara me shpresën e sigurt, të shndritshme, të shkëlqyer të jetës së përjetshme. ■

SHËNIME

1. Jakobi [LiM] 6:8; Alma 12:25–26, 30, 32; 17:16; 18:39; 29:2; 39:18; 42:11.
2. Alma 42:8, 16.
3. Jaromi 1:2; Alma 24:14; 42:5; Moisiu 6:62.
4. Shih Alma 12:32; shih edhe Boyd K. Packer, "The Great Plan of Happiness and Personal Revelation" (Sistemi Arsimor i Kishës, transmetim për të rinjtë në moshë madhore, 7 nëntor 1993).
5. Doktrina e Besëlidhje 14:7.
6. Shih Harold B. Lee, *The Teachings of Harold B. Lee,* bot. Clyde J. Williams (1996), f. 72; shih edhe Bruce R. McConkie në Conference Report, prill 1970, f. 26.
7. Alma 12:32; theksimi i shtuar; shih edhe vargun 25.
8. Shih 2 Nefi 2:13–16; Doktrina e Besëlidhje 101:78.
9. Shih George Q. Cannon, *Gospel Truth: Two Volumes in One: Discourses and Writings of President George Q. Cannon* përzgj. Jerreld L. Newquist (1974), f. 296.
10. Shih Richard G. Scott, "How to Live Well amid Increasing Evil", *Liahona,* maj 2004, f. 102; Robert D. Hales, *Return: Four Phases of Our Mortal Journey Home* (2010), f. 33.
11. "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", *Liahona,* nëntor 2010, f. 129; shih edhe Veprat e Apostujve 17:29; Romakëve 8:16–17; Hebrenjve 12:9; Abraham 3:18–25.
12. Shih Alma 12:30; shih edhe Jobit 38:4–7; Abraham 3:22–28.
13. Shih 2 Nefi 2:13; shih edhe Howard W. Hunter, "To Know God", *Ensign,* nëntor 1974, f. 97; *Teachings of Presidents of the Church: Heber J. Grant* (2002), f. 30: "Secili dhe çdonjëri prej urdhërimeve është dhënë për qëllimin e qartë që ne të mund të . . . cilësohemi dhe përgatitemi për t'u kthyer e banuar në praninë e Atit tonë Qiellor. Këto detyra dhe detyrime janë vlerësuar për të na bërë të ngjashëm me Perëndinë në prirjet tona. Ato janë vlerësuar që të bëjnë Perëndi prej nesh dhe të na përshtatin e kualifikojnë që të mund të bëhemi . . . bashkëtrashëgimtarë me Zotin e Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin."
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 136:31; Abraham 3:24–25.
15. Shih Jobit 38:7.
16. Shih Doktrina e Besëlidhje 88:34–36, 39–40.
17. Shih Isaia 53:3–5; 2 Nefi 2:8; 9:10–11; 31:21; Mosia 3:17; Alma 7:11–13.
18. Shih 1 Pjetër 1:20; Moisiu 4:2.
19. Abraham 3:27.
20. Shih Isaia 14:12–16.
21. Shih Moisiu 4:3–4; shih edhe 1:19.
22. Shih Zbulesa 12:7–9.
23. Shih Doktrina e Besëlidhje 10:26–27.
24. Shih Doktrina e Besëlidhje 59:18–19.
25. Shih Abraham 3:24–26.
26. Shih Zanafilla 1:26–28.
27. Shih Alma 42:2–6; Moisiu 4:25, 28–31.
28. Shih 2 Nefi 2:23; Moisiu 5:11; shih edhe Bojd K. Paker, "Plani i Lumturisë", *Liahona,* maj 2015, f. 26–28.
29. Shih Alma 39:3–5; 41:3–4, 10–15.
30. 2 Nefi 2:27.
31. Shih 2 Nefi 2:11.
32. Shih 2 Nefi 2:26–29; Alma 34:32–35.
33. Shih Jakobi [LiM] 4:7; Ethëri 12:27; Doktrina e Besëlidhje 62:1.
34. Shih Alma 12:30–32.
35. Shih Moroni 7:16–19; Doktrina e Besëlidhje 88:7, 11–13.
36. Shih 2 Nefi 31:12–14, 18.
37. Shih 1 Gjon 1:8.
38. Shih Lluka 22:39–42; Doktrina e Besëlidhje 19:16–19.
39. Shih 1 Korintasve 15:20–23; 2 Nefi 9:10–13; Alma 11:42–45.
40. Shih Alma 42:2–15, 22–31; Moroni 10:32–33.
41. Shih 2 Nefi 31:10–21; 3 Nefi 27:13–22.
42. Shih Gjoni 5:22; Romakëve 14:10; Zbulesa 20:12–13; 2 Nefi 9:41; Alma 11:41–44; 3 Nefi 27:14–17, 20, 22.
43. Shih Alma 34:14–17.
44. Shih Mosia 3:21–27; Helamani 14:15–19; Doktrina e Besëlidhje 88:21–24, 29–32.
45. Shih Mormoni 3:20–22.
46. *The Neal A. Maxwell Quote Book,* bot. Cory H. Maxwell (1997), f. 252.
47. Shih Thomas S. Monson, "Be Thou an Example", *Liahona,* maj 2005, f. 113.
48. Shih Joseph Smith – Historia 1:35.
49. Doktrina e Besëlidhje 101:78.
50. Shih D. Tod Kristoferson, "Përse Martesa, Përse Familja", *Liahona,* maj 2015, f. 52.
51. Shih Mateu 19:5.
52. Shih Zanafilla 9:1.
53. Shih Doktrina e Besëlidhje 93:36–40.
54. 1 Korintasve 11:11.
55. Shih Dallin H. Oaks, "Apostasy and Restoration", *Ensign,* maj 1995, f. 87; shih edhe Dallin H. Ouks, "Nuk do të Kesh Perëndi të Tjerë", *Liahona,* nëntor 2013, f. 73.
56. Shih 1 Nefi 3:7.
57. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:19–21.
58. Shih Doktrina e Besëlidhje 109:13–26, 38.
59. Shih Doktrina e Besëlidhje 132:1–21.
60. Shih 1 Pjetër 3:7; Doktrina e Besëlidhje 131:1–4; shih edhe Joseph Fielding Smith, *Answers to Gospel Questions,* 5 vëll. (1957–1966), 4:197: "Ata që martohen në tempull për gjithë kohën dhe përjetësinë, fitojnë bekimin e *jetës së përjetshme.* Unë e vendos theksin te *jeta e përjetshme.* Jeta e përjetshme është jeta e Perëndisë, ajo është, të jemi si Ai. *Jeta e përjetshme* do të thotë rritje e përjetshme – vazhdimësi, sikurse e thotë zbulesa, e farës përgjithmonë. Të martuarit jashtë tempullit është vetëm për kohën. Vdekja i ndan – ajo është një ndarje e përjetshme, në qoftë se ndërkohë ata nuk pendohen dhe nuk janë aq fatlumë sa të shkojnë në tempull dhe të bëjnë pajtimin."
61. Shih Ethëri 12:27.
62. Shih Ethëri 12:37.
63. Shih "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", f. 129; shih edhe *God Loveth His Children* (broshurë, 2007), f. 1.
64. Shih Isaia 40:31.
65. Zbulesa 21:4; shih edhe vargjet 1–3.
66. 2 Nefi 31:20.
67. D. Tod Kristoferson, "Përse Martesa, Përse Familja", f. 52.
68. *Mësime të Presidentëve të Kishës: Lorenco Snou* (2012), f. 133. Shih edhe Gordon B. Hinckley, "Daughters of God", *Ensign,* nëntor 1991, f. 98: "Disa që nuk janë të martuara, jo për fajin e tyre, pyetin nëse atyre gjithmonë do t'iu mohohet shkalla më e lartë e lavdisë në atë mbretëri. Unë kam vetëbesim se në planin e një Ati të dashur dhe një Shëlbuesi hyjnor, asnjë bekim për të cilin përndryshe jeni të denja, nuk do t'ju mohohet përgjithmonë."

Kur më shoqëruan për në dhomën e ndenjjes së oficerit, kapiteni i anijes po bërtiste dhe po tregonte me gisht një oficer të ri.

SA E RËNDËSISHME MUND TË ISHTE KJO?

Gjatë udhëtimit tim në bordin e anijes *USS West Virginia*, erdhi një thirrje për një oficer që fliste portugalisht që të shkonte në një shkëmbim trejavor në Marinën Braziliane. Isha i vetmi nga trupat e nëndetëses që flisja portugalisht.

Ndjenja ime fillestare ishte që të mos shkoja. Sapo e kisha mbaruar një patrullim tremujor dhe mezi po prisja të shihja familjen time, por shkëmbimi nuk më hiqej nga mendja. Iu drejtova Atit Qiellor në lutje, mora një përgjigje të fortë që duhej të shkoja dhe e pranova detyrën.

Rregullimet për detyrën dolën të mbushura me pengesa. Në njëfarë pike ndjeva se po hiqja dorë. Mendova: "Sa e rëndësishme mund të ishte kjo? Megjithatë, Fryma e Shenjtë më shtyu të vazhdoja përpara.

Më në fund, pas disa vonesash, mbërrita në një anije braziliane. Kur më shoqëruan për në dhomën e ndenjjes së oficerit, kapiteni i anijes po bërtiste dhe po tregonte me gisht një oficer të ri. Kapiteni më pa, ndaloi dhe tha me një anglishte të çalë: "A, paska ardhur miku im amerikan. Mirëserdhët. A mund t'ju ofroj diçka për të pirë?"

Iu përgjigja në portugalisht se do të më pëlqente shumë një pije freskuese e famshme braziliane që nuk e kisha shijuar që nga misioni im. Ai më tha se anija i kishte të gjitha llojet e likerit në bord, por i pohova se nuk pija alkool.

Më vonë një trokitje u dëgjua në kabinën time. Kur e hapa derën, aty qëndronte oficeri i ri që kishte qenë te dhoma e ndenjjes.

"Ti je amerikan", tha ai. "Ti nuk pi alkool. Ti flet portugalisht. A mos vallë je mormon?"

"Po, jam", iu përgjigja.

Ai m'i hodhi krahët në qafë dhe qau me dënesë.

Ky oficer, togeri Mendez, qartazi ishte një i sapokthyer në besim dhe një i diplomuar kohët e fundit në Akademinë Braziliane të Marinës. Në bordin e anijes, ai shpejt mësoi se kapiteni priste prej tij që dhe ai të merrte pjesë në stilin e shfrenuar të jetesës së oficerëve kur vizitonin porte.

ILUSTRIMI NGA ALLEN GARNS

Përkundrazi, togeri Mendez dilte vazhdimisht vullnetar për detyrën e qëndrimit brenda portit dhe i shmangte në mënyra të tjera veprimtaritë jashtë portit, gjatë ndalesave të anijes. Kapitenit i erdhi në majë të hundës kjo. Kur unë hyra në sallonin e ndenjjes, ai po i bërtiste togerit Mendez ngaqë nuk bashkohej me ta.

"Do të dalësh me oficerët gjatë ndalesës sonë në portin e radhës", e kishte urdhëruar ai togerin. "Do t'i tregosh oficerit amerikan që po na vjen për vizitë, se si është t'ia kalosh mirë. Ai këtë do të presë prej nesh."

Për muaj, togeri Mendez kishte qenë duke u lutur që kapiteni t'i kuptonte dhe pranonte parimet e tij. Me mbërritjen time, diskutimi për ungjillin u bë qendra e shumicës së bisedave në dhomën e ndenjjes. Ne folëm me oficerët e tjerë rreth Jozef Smithit, Rivendosjes, Fjalës së Urtësisë dhe ligjit të dëlirësisë. Ndjenjat kundrejt togerit Mendez shpejt ndryshuan. Oficerët e hoqën pornografinë e ekspozuar hapur dhe, në portin e radhës, ne të gjithë shijuam një vakt së bashku në një restorant, në vend që të shkonim në një klub.

Afër mbarimit të tri javëve të mia në bord dhe pas shumë diskutimesh me kapitenin dhe oficerët rreth bindjeve tona, burrat i zbutën zemrat e tyre. "Tani e kuptoj", i tha kapiteni togerit Mendez përpara se të ikja, duke shtuar se nuk do t'i kërkonte më atij të dilte kundër parimeve të veta.

Unë kurrë nuk do ta harroj këtë përvojë. Togeri Mendez dhe unë mësuam se Ati ynë në Qiell na njeh përkatësisht, na do dhe është i merakosur për jetën tonë vetjake. ■

Kelli Leing, Uashington, SHBA

MOTRA SPAFORD PO MË FLISTE MUA

Po luaja një lojë restoranti në internet në mbrëmje vonë kur bashkëshorti im më kaloi pranë dhe lajmëroi që do të shkonte në shtrat.

"Do të vij menjëherë", i thashë.

"Do ta besoj këtë kur ta shikoj", tha ai.

Po luaja një lojë në të cilën gatuaja ushqim virtual në një restorant virtual për disa klientë virtualë në internet. Pashë nga ekrani i kompjuterit dhe thashë: "Në fakt, do të më dalë ushqimi për 15 minuta".

Për të kaluar kohën ndërsa prisja, mora librin *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society [Bija në Mbretërinë Time: Historia dhe Puna e Shoqatës së Ndihmës],* të cilin e kisha lënë mbi tryezë që kur e kisha marrë në Shoqatën e Ndihmës. Fillova të lexoja parathënien. Në faqen e tretë gjeta sa vijon nga Motra Bell S. Spaford, presidentja e nëntë e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës.

"Gruaja tipike e sotme, besoj", shkroi ajo, "do të bënte mirë t'i peshonte interesat e saj, t'i vlerësonte veprimtaritë në të cilat është angazhuar dhe më pas të ndërmarrë hapa për ta thjeshtuar jetën e vet, duke i vënë të parat gjërat me rëndësi parësore, duke e vendosur theksin atje ku shpërblimet do të jenë më të mëdha e më të qëndrueshme dhe duke e çliruar veten nga veprimtaritë më pak shpërblyese" (2011, f. xiii).

Përveç shkrimeve të shenjta, asgjë që kam lexuar nuk më ka prekur kaq thellë. Kjo grua që vdiq më shumë se 30 vjet më parë, po më fliste mua. Fjalët e saj me gjasë janë më me vend sot sesa kur ajo i tha ato.

E dija menjëherë se nuk duhet të luaja më kurrë lojëra në internet. E fika kompjuterin, shkova në shtrat dhe i tregova bashkëshortit për vendimin tim. Ditën vijuese as nuk e ndeza kompjuterin. Përkundrazi, kuptova se sa shumë orë kisha çuar dëm me ato lojëra çdo ditë.

I shumëzova tri orë me 365 (ditë në vit) dhe i pjesëtova me 24 (orë në ditë). U shtanga kur mësova se kisha çuar dëm 45,62 ditë në vit. Ato orë dhe ditë të çmuara kanë ikur përgjithmonë. Mund t'i kisha shpenzuar duke lexuar shkrimet e mia të shenjta, duke kaluar kohë me bashkëshortin dhe fëmijët e mi, duke u shërbyer të tjerëve ose duke i lartësuar thirrjet e mia.

Autoritetet e Përgjithshme e trajtojnë shpesh këtë temë gjatë konferencës së përgjithshme. Prapëseprapë nuk kishte pasur efekt tek unë dhe mendoja se nuk gjente zbatim për mua.

Jam mirënjohëse që Fryma e Shenjtë më ndihmoi ta dalloj se Autoritetet e Përgjithshme – dhe Bel S. Spafordi – po më flisnin mua. ■

Sendi Hauzon, Ohajo, SHBA

NUK E DIJA PËRSE ISHA ATY

Nëna ime dhe unë sapo kishim mbaruar lutjen tonë të natës. U përqafuam dhe thamë: "Unë të dua". Pastaj eca për në dhomën time të gjumit. Teksa zgjata dorën për te doreza e derës, një përshtypje e fortë më erdhi në mendje që të nesërmen mami im do të vdiste.

Truri dhe zemra ime u përpoqën ta luftonin mendimin. Nuk kishte asnjë mundësi që diçka t'i ndodhte mamit tim. Çdo gjë do ishte në rregull me të.

Pasi shkova në dhomën time, u gjunjëzova në lutje dhe i thashë Atit Qiellor se përshtypja rreth mamit tim nuk mund të ishte e vërtetë. I kërkova Atij të ma hiqte atë mendim, por ai nuk largohej. U ktheva në dhomën e prindërve dhe i thashë mamit tim se doja edhe një përqafim e puthje tjetër përpara se të shkoja në shtrat. Thamë përsëri: "Të dua" dhe u ktheva në dhomën time. M'u desh ca kohë për të rënë në gjumë atë natë.

Kur u zgjova mëngjesin tjetër, isha në ankth. Fatmirësisht, ja ku ishte mami im, e lumtur dhe mirë. Por brenda mendjes sime, ende e kisha ndjenjën bezdisëse se diçka nuk shkonte. Në mbledhjen e agjërimit dhe të dëshmisë atë ditë, mami u ngrit dhe dha një dëshmi të bukur.

Pas mbledhjes së sakramentit, ajo shkoi t'i jepte mësim klasës së saj të Fillores dhe unë shkova në Shkollën e së Dielës. Pata një përshtypje tjetër të dallueshme, këtë herë që të çohesha e ta lija Shkollën e së Dielës. Nuk doja të tërhiqja vëmendje te vetja, por diçka më ngriti nga karrigia dhe më nxori jashtë derës. Brenda pak minutave, e gjeta veten të ulur në klasën e Fillores të mamit tim duke e dëgjuar atë të jepte mësim. Nuk e dija përse isha aty, por e dija se ai ishte vendi ku më duhej të isha.

Më vonë atë pasdite, në shtëpinë e vëllait tim, mami im më pa drejt e në sy për herë të fundit ndërsa u shemb në tokë dhe ndërroi jetë nga një bllokim i një ene të gjakut në mushkëri. Për arsyet e Tij dhe në mëshirën e Tij, Ati Qiellor e kishte dërguar Frymën e Shenjtë të më përgatiste. Këto nxitje më dhanë më tepër kohë me mamin që nuk do ta kisha gëzuar po ta kisha shpërfillur zërin e qetë e të vogël.

Dashuria e Atit tim Qiellor nuk kishte qenë kurrë kaq e dukshme për mua deri në ngjarjet që ndodhën lidhur me vdekjen e mamit tim. Sa të bekuar jemi që kemi një Atë në Qiell që na do mjaftueshëm për të na dhënë dhuratën e veçantë të Frymës së Shenjtë. ■

Amber Çini, Alabama, SHBA

Ktheva në dhomën e prindërve dhe i thashë mamit tim se doja edhe një përqafim e puthje tjetër përpara se të shkoja në shtrat.

ILUSTRIMI NGA KATHLEEN PETERSEN

Kur e mora në telefon zyrën e barkës dhe iu luta ta shtynin udhëtimin për dy ditë, ata më thanë se nuk mund të prisnin.

DUKE U LUTUR UDHËS SIME PËR NË ROTUMA

"*Westerland-i* u nis dje", më tha kunata ndërsa na përshëndeti në Aeroportin Ndërkombëtar Nadi në Fixhi.

Isha edhe i trishtuar, edhe i zhgënjyer nga lajmi. *MV Westerland-i* ishte barka që supozohej të na çonte të takonim vëllanë tim më të madh në Ishullin e Rotumës. Rotuma është afërsisht 600 km në veriperëndim të Viti Levus, ishullit më të madh të Fixhit. Nëse të ikën barka, me shumë gjasë do të të duhet të presësh ditë ose madje javë për tjetrën.

Një vit më parë kisha shkuar në Rotuma për ta ndihmuar vëllanë tim të restauronte shtëpinë e gjyshes sonë dhe unë e lashë atë për shkak të një mosmarrëveshjeje të lidhur me punën. Tani doja ta shikoja sy më sy e t'i thosha sa keq më vinte.

Një javë përpara se bashkëshortja ime, Akata dhe unë të fluturonim për në Fixhi nga Australia, mbesa ime më tha se *Westerland-i* do të shkonte në Rotuma ditën përpara se ne kishim planifikuar të mbërrinim. E mora menjëherë në telefon zyrën e barkës dhe iu luta ta shtynin udhëtimin për dy ditë.

"Jo, nuk mundemi edhe sikur të dëshironim", erdhi përgjigjja. "Këshilli i Ishullit të Rotumës ka bërë përgatitje për një gosti mirëseardhjeje dhe barka duhet të niset siç është planifikuar."

Më shkrepi një mendim në kokë dhe vendosa të lutesha e të agjëroja.

"I dashur Atë Qiellor", u luta "do të doja shumë ta kapja barkën për në Rotuma. Besoj se ata nuk mund ta shtyjnë udhëtimin një ditë apo dy, por Ti e ke fuqinë për ta bërë atë. A mundesh Ti të lutem të heqësh vetëm një bulon kudo qoftë në barkë në mënyrë që ta pengosh udhëtimin që unë të mund të hipi në barkë? Duhet të shkoj në Rotuma e të pajtohem me tim vëlla."

Pasi e kishim dëgjuar lajmin zhgënjyes, ne vazhduam rrugën për në port në anën tjetër të ishullit. Megjithatë, atje mësuam se barka kishte pasur probleme me motorin dhe nuk ishte nisur ende. Ati Qiellor i ishte përgjigjur lutjes sime! Siç u mor vesh, nuk duhej hequr vetëm një bulon por i tërë motori që të riparohej një rrjedhje e madhe karburanti.

Kur barka më në fund u nis një javë më vonë, unë isha në bord. Kur mbërritëm në Rotuma, e përqafova tim vëlla dhe i kërkova ndjesë dhe kështu e rivendosëm marrëdhënien tonë. Ajo sigurisht që ishte një ditë ngazëllimi.

Unë do të jem përgjithmonë mirënjohës për këtë përvojë të mrekullueshme shpirtërore dhe për ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit. Ajo është një dëshmi që mrekullitë ende ndodhin sot, që Ati Qiellor jeton dhe u përgjigjet lutjeve tona të sinqerta, që lutja dhe agjërimi shkojnë krah për krah dhe që ungjilli është i vërtetë edhe në një fshat të vogël në ishullin e vockël të Rotumës. ■

Xhon K. Muaror, Uellsi i Ri Jugor, Australi
(Autori ka ndërruar jetë.)

ILUSTRIMI NGA ALLEN GARNS

Nga Rendëll L. Rid
Shërbeu si këshilltar i dytë në presidencën e përgjithshme të Të Rinjve nga viti 2013 deri në vitin 2015

TË JETUARIT ME Qëllim të Vërtetë

Emësova rëndësinë e qëllimit të vërtetë kur isha student në moshë të re në seminar. Mësuesi ynë na drejtoi sfidën që ta lexonim Librin e Mormonit. Që ta mbanim shënim përparimin tonë, ai krijoi një tabelë me emrat tanë në njërën anë dhe librat e Librit të Mormonit renditur në krye të saj. Sa herë që e lexonim një libër, ai vendoste një yll pranë emrit tonë.

Fillimisht unë nuk bëra shumë përpjekje për të lexuar dhe nuk kaloi shumë kohë përpara se ta gjeja veten duke mbetur mbrapa gjithnjë e më shumë. I shtyrë nga një ndjenjë turpi dhe shpirti im i brendshëm konkurrues, e fillova leximin. Sa herë që merrja një yll, ndihesha mirë. Dhe sa më shumë yje merrja, aq më shumë nxitesha për të lexuar – midis orëve mësimore, pas shkollës, në çdo minutë të kursyer.

Kjo do të ishte një histori e shkëlqyer po të mund t'ju thoshja se për shkak të përpjekjeve vetjake e mbarova i pari në klasë – por jo. Dhe do të ishte në rregull nëse do mund t'ju thoshja se mora diçka më të mirë sesa vendin e parë – një dëshmi për Librin e Mormonit. Por as kjo nuk ndodhi. Unë nuk mora një dëshmi. Ajo që mora ishin yje. Mora yje, sepse ajo ishte arsyeja përse po lexoja. Për të përdorur fjalët e Moronit, ai ishte "qëllim [i] vërtetë" imi.

Moroni ishte i qartë kur përshkroi se si ta gjesh nëse Libri i Mormonit është i vërtetë: "Dhe kur ju t'i merrni këto gjëra, unë do t'ju këshilloja që të pyesni Perëndinë, Atin e Amshuar, në emrin e Krishtit, në qoftë se këto gjëra nuk janë të vërteta; dhe në qoftë se ju do të kërkoni me një zemër të sinqertë, me *qëllim të vërtetë* duke pasur besim në Krisht, ai do t'ju tregojë të vërtetën, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë" (Moroni 10:4; theksimi i shtuar).

Qëllim i vërtetë është të bëhet gjëja e duhur për arsyet e duhura.

Arsyet e Duhura

Duke e hedhur vështrimin pas, mund të shoh se Zoti ishte tërësisht i drejtë me mua. Përse duhej të kisha pritur që të gjeja diçka tjetër nga ajo që po kërkoja? Qëllimi i vërtetë është të bësh gjënë e duhur për arsyet e duhura; unë po lexoja librin e duhur për arsyet *e gabuara*.

Vetëm shumë vite më vonë unë e lexova përfundimisht Librin e Mormonit me qëllim të vërtetë. Tani unë e di se Libri i Mormonit e përmbush qëllimin

FOTOILUSTRIM NGA SERGEY NIVENS/ISTOCK/THINKSTOCK

e tij hyjnor të dëshmimit për jetën dhe misionin e Jezu Krishtit sepse unë e kam lexuar me qëllim të vërtetë.

Mësimi që mora rreth qëllimit të vërtetë dhe Librit të Mormonit, vlen për të gjithë ne në të gjitha aspektet e jetës sonë. Tepër shpesh ne ndjekim në mënyrë pasive modele dhe zakone që janë krijuar ndër vite – ne thjesht kalojmë nëpër lëvizje pa shqyrtuar me kujdes se ku po na çojnë këto lëvizje. Të jetuarit me qëllim të vërtetë shton fokusin dhe përqendrimin në jetën tonë dhe mund të bëjë gjithë ndryshimin. Të jetuarit me qëllim të vërtetë do të thotë të kuptojmë "përse-në" – shtysat prapa veprimeve tona. Sokrati tha: "Jeta e pakontrolluar nuk vlen të jetohet".[1] Prandaj përsiatni se si e shpenzoni kohën dhe pyeteni veten rregullisht: "Përse?" Kjo do t'ju ndihmojë që të zhvilloni aftësinë për të parë përtej çastit. Është shumë më mirë ta hidhni vështrimin përpara dhe ta pyetni veten: "Përse do ta bëja këtë?" në vend që të shihni mbrapa dhe të thoni: "Përse, o, përse e bëra atë?"

Të jetuarit me qëllim të vërtetë do të thotë të kuptojmë "përse-në" – shtysat prapa veprimeve tona. Sokrati tha: "Jeta e pashqyrtuar nuk ia vlen të jetohet".

Çfarë Dëshiron Zoti që të Bëni Ju?

Kur isha i ri, pata vendosur të mos shkoja në një mision. Pas një viti në kolegj dhe një viti në ushtri, kisha një punë të mirë në një spital vendor si teknik radiografie. Jeta dukej se shkonte mirë dhe misioni nuk dukej i nevojshëm.

Një ditë, Dr. Xhejms Pingri, kirurg në spital, më ftoi të hanim drekë. Gjatë bashkëbisedimit tonë, ai zbuloi se nuk kisha në plan të shërbeja në një mision dhe pyeti përse. I thashë se isha pak më i madh në moshë dhe ndoshta ishte tepër vonë. Ai më tha se ajo nuk ishte një arsye shumë e mirë, duke thënë se ai kishte shkuar në misionin e tij pasi kishte mbaruar fakultetin e mjekësisë. Më pas ai dha dëshmi për rëndësinë e misionit të tij.

Dëshmia e tij pati një ndikim të rëndësishëm mbi mua. Ajo më bëri të lutem siç nuk isha lutur kurrë më parë – me *qëllim të vërtetë.* Mund të mendoja për shumë arsye që të mos shkoja në një mision: isha i turpshëm. Kisha një punë që më pëlqente. Kisha një mundësi burse që nuk do të ishte në dispozicion pas një misioni. Më e rëndësishmja, kisha një të dashur që më priti ndërkohë që isha në ushtri dhe e dija se nuk do të priste për dy vjet të tjerë! U luta që të merrja miratim se arsyet e mia ishin të vlefshme dhe se kisha të drejtë.

Për zhgënjimin tim, nuk mund të gjeja një përgjigje të lehtë po ose jo, për të cilën shpresoja. Atëherë më erdhi mendimi: "Çfarë dëshiron Zoti që të bësh ti?" Duhej të pranoja se Ai dëshironte që unë të shërbeja një mision dhe ky u bë një çast vendimtar në jetën time. A do të bëja atë që dëshiroja të bëja unë apo do të bëja vullnetin e Zotit? Kjo është një pyetje që të gjithë do të bënim mirë t'ia bënim vetes shpesh.

Fatmirësisht, unë zgjodha që të shërbeja një mision dhe u caktova që të punoja në Misionin e Meksikës Veriore.

Pasoja të Përjetshme

Tridhjetë e pesë vjet më vonë, biri im më nxiti të vizitoja Meksikën me të.

FOTOGRAFI NGA JUPITERIMAGES/STOCKBYTE/THINKSTOCK

Ne shpresonim të gjenim dikë nga njerëzit që unë i pata mësuar. Ne morëm pjesë në një mbledhje sakramenti në qytetin e vogël ku e fillova misionin tim, por nuk njoha asnjë person. Pas mbledhjes, folëm me një nga anëtarët dhe e pyetëm nëse njihte ndonjë nga njerëzit në listën time, të cilëve u pata dhënë mësim shumë vite përpara. E kaluam gjithë listën pa sukses derisa arritëm tek emri i fundit: Leonor Lopez de Enrikes.

"Ou, po", tha burri. "Kjo familje është në një lagje tjetër, por ata vijnë në kishë te kjo ndërtesë. Mbledhja e tyre e sakramentit është më pas."

Nuk na u desh të prisnim gjatë para se Leonora të hynte në godinë. Edhe pse tani ishte në mesin e të 70-ave, e njoha menjëherë dhe ajo më njohu mua. Patëm një përqafim të gjatë, të përlotur.

"Ne jemi lutur për 35 vjet që ti të ktheheshe që të mund të të falënderonim për sjelljen e ungjillit në familjen tonë", tha ajo.

Teksa anëtarë të tjerë të familjes u futën në godinë, ne ndamë përqafime dhe lot. Shpejt zbuluam se peshkopi i kësaj lagjeje ishte një nga bijtë e Leonorës, drejtuesja e muzikës një mbesë, pianisti një nip, dhe disa të rinj në Priftërinë Aarone që ishin nipër të saj. Një nga bijat e saj u martua me një kështilltar në presidencën e kunjit. Një bijë tjetër ishte martuar me peshkopin e një lagjeje atje pranë. Shumica e fëmijëve të Leonorës shkuan në misione dhe tani nipërit dhe mbesat e saj kanë shërbyer gjithashtu në misione.

Ne mësuam se Leonora ishte një misionare shumë më e mirë nga sa isha unë. Sot fëmijët e saj kujtojnë me mirënjohje përpjekjet e saj të palodhura për t'ua mësuar ungjillin atyre. Ajo u mësoi atyre se vendime të vogla, me kalimin e kohës, çojnë në një jetë të plotë, të drejtë e të lumtur dhe ata ua mësuan ato gjëra të tjerëve. Gjithsej, më shumë se 500 vetë u bënë anëtarë të Kishës për shkak të kësaj familjeje të mrekullueshme.

Dhe gjithçka nisi nga një bisedë gjatë një dreke. Shpesh mendoj se, nëse Dr. Pingri do të ishte përqendruar më shumë te karriera e tij apo në interesa të tjera të botës, ai mund të mos më kishte pyetur kurrë përse nuk po shërbeja në një mision. Por përqendrimi tij ishte te të tjerët dhe te çuarja më tej e punës së Zotit. Ai mbolli një farë që është rritur, ka dhënë fryt dhe vijon të shumëfishohet fuqishëm (shih Marku 4:20). Misioni im më mësoi pasojat e përjetshme të një vendimi të vetëm për të bërë vullnetin e Zotit.

Kujtoni Qëllimin Tuaj të Përjetshëm

Shpesh herë kam vështruar pas në jetën time dhe kam pyetur veten përse ishte kaq e vështirë për mua që ta merrja vendimin për të shkuar në një mision. Ishte e vështirë ngaqë u shpërqendrova; humba nga shikimi qëllimin tim të përjetshëm – qëllimin e vërtetë të arsyes përse jemi këtu.

Dëshirat e mia dhe vullneti im nuk përputheshin me vullnetin e Zotit; ndryshe, vendimi do të kishte qenë më i lehtë. Dhe përse nuk përputheshin ato? Unë shkoja në kishë dhe merrja sakramentin të dielave, por nuk u përqendrova te kuptimi i tij. Lutesha, por kryesisht po shkoja përmes veprimeve. I lexoja shkrimet e shenjta, por vetëm në mënyrë rastësore dhe pa qëllim të vërtetë.

Unë ju nxit që të jetoni një jetë të vetëdijshme dhe të përqendruar – edhe nëse nuk keni vepruar vazhdimisht kështu në të shkuarën. Mos u shkurajoni nga mendime mbi atë që keni bërë apo që nuk keni bërë tashmë. Lëreni Shpëtimtarin t'i pastrojë ato tërësisht. Kujtoni atë që Ai ka thënë: "Kurdoherë që pendoheshin dhe kërkonin ndjesë me *dëshirë të sinqertë,* ata faleshin" (Moroni 6:8; theksimi i shtuar).

Filloni tani. Jetoni një jetë të qëllimshme, duke kuptuar përse e bëni atë që bëni dhe ku do t'ju çojë ajo. Kur i bëni këto gjëra, ju do të zbuloni se "përse-ja" më e rëndësishme prapa gjithçkaje që bëni, është që ju e doni Zotin dhe e dalloni dashurinë e Tij të përsosur për ju. Gjetshi gëzim të madh në kërkimin tuaj për përsosurinë dhe në kuptueshmërinë dhe bërjen e vullnetit të Tij. ■

Nga një takim shpirtëror mbarëbotëror për të rinjtë në moshë madhore, "Të Jetuarit me Qëllim: Rëndësia e Qëllimit të Vërtetë", dhënë në Universitetin "Brigam Jang" – Ajdaho më 11 janar 2015. Për bisedën e plotë, shkoni te devotionals.lds.org.

SHËNIM

1. Socrates in Plato, *Apology* (2001), f. 55.

Besim, Shërbim dhe një Çyrek Bukë

Nga Nisanka (Nish) Muthi Mudalig

Unë shkova në Armeni nga Sri-Lanka për të ndjekur shkollën në vitin 2007, takova misionarët dhe u pagëzova vitin tjetër. Pas pagëzimit tim, isha i etur që të shërbeja një mision kohëplotë. Unë nuk mundesha pasi isha mbi 25 vjeç; sidoqoftë, presidenti i misionit më thirri të shërbeja një mision të shkurtër. Përgjegjësitë e mia përfshinin punën me pleq të tjerë dhe predikimin e ungjillit. Kjo më pëlqente.

Një Provë Guximi

Ndërkohë, me paratë isha ngushtë. Atëherë biznesi i babait falimentoi dhe ai nuk mund të më dërgonte më para. Unë pata para vetëm për ushqime për disa ditë. Universiteti im ishte pranë vendbanimit tim, por zyra e misionit ishte 30 minuta me autobus. Udhëtimi për atje dhe kthimi më kushtonte 200 drams (rreth 0.5 dollarë).

Por përsëri unë doja ta lartësoja shërbimin tim misionar. Kur një plak më telefonoi që të vizitoja disa anëtarë me të dhe kërkoi që të takoheshim në ndërtesën e Degës Qendrore – mbi 40 minuta larg meje me autobus – unë thashë po, edhe pse kisha para vetëm sa për një çyrek buke. Unë eca më këmbë për te ndërtesa e Degës Qendrore. Ishte një ditë e nxehtë vere, kështu që duhej të pushoja dhe të pija ujë gjatë rrugës. U deshën dy orë përpara se të arrija më në fund. Gjatë ecjes për dy orë për t'u kthyer në shtëpi, unë e shpenzova monedhën e fundit për bukë.

Një Provë më e Madhe

Shpejt pas arritjes në shtëpi, mora një thirrje telefonike nga po ai plak. Ai tha: "Nish, më fal që po të telefonoj përsëri, por një nga anëtarët është sëmurë. A mund të vish dhe të jesh shoqëruesi im ndërsa unë i jap asaj një bekim?" Unë doja t'i thoshja se isha tepër i lodhur pas ecjes për katër orë nëpër vapë, por zemra nuk më la. Besimi im më dha forcë dhe guxim, kështu që thashë se do të shkoja.

Pikërisht atëherë shoku im i dhomës hyri. Unë e pyeta nëse mund t'i merrja borxh para aq sa për të shkuar te zyra e misionit. Ai tha se kishte para vetëm për të blerë ushqime deri në fund të muajit, kështu që nuk mund të më huante gjë.

Ndërsa ecja për në shtëpi, nuk ndihesha i lodhur. E vetmja gjë që mund të mendoja ishte buzëqeshja e gruas së moshuar.

Befas, syri im u fokusua te buka që sapo pata blerë që ishte në tavolinë, e freskët – i vetmi ushqim që kisha. Unë e mora dhe thashë: "Unë sapo e bleva këtë bukën; a mund ta marrësh dhe të më japësh 100 dram?" Ai buzëqeshi dhe tha se do ta merrte. Unë i mora

ILUSTRIMI NGA DOUG FAKKEL

paratë dhe mora autobusin për te zyra e misionit.

Ne e vizituam atë anëtare Kishe, një grua e moshuar që nuk ngrihej nga shtrati. Ajo i hapte me vështirësi sytë për të parë nga ne, por ajo më buzëqeshi. Ajo foli me mua posaçërisht, duke sjellë ndër mend kujtime të hershme nga jeta e saj. Ajo ishte aq e lumtur që na shihte ne në shtëpinë e saj. Së bashku, plaku dhe unë i dhamë asaj një bekim. Ajo na dha një buzëqeshje tjetër dhe unë mund të shihja dritën në fytyrën e saj. Bija e saj tha se në vizitën tonë ishte e para herë prej shumë muajsh që ajo e pa nënën e vet të buzëqeshte.

Unë përsëri eca një dyorësh tjetër për në shtëpi, por këtë herë nuk u ndjeva i lodhur. E vetmja gjë që mund të mendoja ishte buzëqeshja e gruas së moshuar dhe biseda jonë. Ndjeva se Ati Qiellor donte që unë ta vizitoja atë; ndoshta ishte kjo çka asaj i duhej për të pasur lumturi më të madhe gjatë ditëve të saj të fundit. Unë u ndjeva shumë mirënjohës për mundësinë time për të marrë pjesë në atë vizitë. Unë i kërkova Atit Qiellor që ta bekonte atë grua. Unë gjithashtu i kërkova Atij që të më bekonte me ushqim të përditshëm gjatë periudhës sime të vështirë financiare.

Bekime nga Lart

Perëndia nuk më la vetëm. Miku im e ndau ushqimin e tij me mua atë muaj. Nuk shkova kurrë i uritur në shtrat, edhe pse nuk kisha asnjë qindarkë në xhep. Unë ecja çdo ditë për te zyra e misionit – dhe kurrë nuk u ndjeva i lodhur. Sakrifica më bëri të lumtur.

Atë muaj mora shumë ftesa për drekë dhe darkë. Një ditë shoku im i dhomës dhe unë ishim të dy të shkundur dhe kishim vetëm një çyrek buke për mëngjes. Atë mbrëmje ishim shumë të uritur. Ecëm poshtë rrugës në përpjekje për të marrë hua nga ndonjë mik, kur një makinë ndaloi me dy armenë vendas brenda. Burrat na pyetën se nga ishim. Pasi u thamë se ishim nga Sri-Lanka, ata na ftuan në shtëpinë e tyre për darkë. Atyre u pëlqente të dëgjonin gjithçka rreth Sri-Lankës dhe ne kaluam një darkë të mrekullueshme.

Unë e dua Atin tim Qiellor dhe të gjitha bekimet që Ai më jep vazhdimisht. Ai është atje që të më ndihmojë dhe unë e ndiej kujdesin e Tij të dashur për mua çdo ditë. ■

Autori jeton në Armeni.



Nga Plaku
Dallin H. Ouks,
I Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

SHPËTIMI NGA KURTHI I PORNOGRAFISË

Të gjithë ne duhet të mësojmë të reagojmë siç duhet ndaj mediave me përmbajtje seksuale.

Një dekadë më parë unë fola në një konferencë të përgjithshme mbi temën e pornografisë. Unë bashkova zërin me udhëheqës të tjerë që kanë paralajmëruar kundër ndikimeve shpirtërore shkatërrimtare të pornografisë. Unë paralajmërova se mjaft burra dhe djem qenë lënduar nga ajo që unë e quaja "literaturë nxitëse për marrëdhënie të palejueshme seksuale"[1]. Përdorimi i çdo lloj pornografie është i lig – është shkatërrimtar për ndjeshmërinë shpirtërore, dobëson aftësinë për të ushtruar fuqi priftërore dhe dëmton marrëdhëniet e çmuara.

Tani, më shumë se 10 vjet më vonë, unë jam mirënjohës që shumë njerëz, duke dëgjuar dhe duke ua vënë veshin paralajmërimeve profetike, i kanë shmangur dhe kanë mbetur të pastër nga njollat e pornografisë. Unë jam gjithashtu mirënjohës që shumë ua kanë vënë veshin ftesave profetike për t'u larguar nga pornografia, për të rregulluar zemrat dhe marrëdhëniet e prishura dhe për të ecur përpara në udhën e të qenit dishepuj. Por unë jam më i shqetësuar se kurrë që të tjerë ndër ne vijojnë të bien pre e pornografisë, veçanërisht të rinjtë tanë dhe madje një numër në rritje të rejash.

Një arsye bazë për problemin në rritje të pornografisë është se në botën e sotme, fjalët dhe pamjet me përmbajtje dhe ndikime seksuale janë kudo: ato mund të gjenden në filma, programe televizive, media shoqërore, mesazhe me tekst, programe telefoni, reklama, libra, muzikë dhe biseda të përditshme. Si rezultat, është e pashmangshme që të gjithë jemi të ekspozuar rregullisht ndaj mesazheve me seks.

ILUSTRIMI NGA DOMBNIC/ISTOCK/THINKSTOCK



Të drejtuarit te Zoti në përulësi e bën njeriun të pranojë disa të vërteta, që, kur kuptohen plotësisht, sigurojnë forcë dhe largojnë turpin.

I. Nivele të Përfshirjes

Për të na ndihmuar ta trajtojmë këtë të keqe në rritje, dëshiroj të përcaktoj nivele të ndryshme përfshirjeje në pornografi dhe të sugjeroj mënyra me të cilat duhet t'i përgjigjemi secilës.

Në kohë dhe rrethana më të hershme, këshilla jonë rreth pornografisë përqendrohej kryesisht për të ndihmuar individët që të shmangin ekspozimin fillestar ose të shpëtojnë nga varësia. Ndërsa ato përpjekje janë ende të rëndësishme, përvoja e kaluar dhe rrethanat e tanishme kanë treguar nevojën për këshillë drejtuar niveleve të përdorimit të pornografisë midis skajeve polare të shmangies dhe varësisë. Është e dobishme të përqendrohemi në katër nivele të ndryshme të përfshirjes në pornografi: 1) ekspozimi padashur, 2) përdorimi rastësor, 3) përdorimi i ngjeshur dhe 4) përdorimi i sëmurë (varësi).

> Nëpërmjet hirit të Jezu Krishtit, të gjithë mund të falen dhe të marrin fuqinë për të ndryshuar.

1. **Ekspozimi Padashur.** Unë besoj se kushdo është ekspozuar padashur ndaj pornografisë. Nuk ka mëkat në këtë kur ne e largojmë dhe nuk e ndjekim. Është si një gabim, që fton për korrigjim më shumë sesa pendesë.[2]
2. **Përdorimi Rastësor.** Ky përdorim i pornografisë mund të jetë i rastit ose madje i shpeshtë, por ai është gjithmonë i qëllimshëm dhe kjo është ligësia e tij.

   Pornografia nxit dhe rrit ndjenja të fuqishme seksuale. Krijuesi na i dha këto ndjenja për qëllimet e Tij të urta, por Ai gjithashtu dha urdhërime që e kufizuan shprehjen e tyre ndaj një burri dhe një gruaje që janë të martuar. Pornografia rrënon shprehjen e përshtatshme seksuale dhe nxit shprehjen e ndjenjave seksuale tej kufijve të martesës. Ata që përdorin pornografi, luajnë me forca aq të fuqishme saqë mund të krijojnë ose të shkatërrojnë jetë. Mos shkoni atje!

   Rreziku me çfarëdo përdorimi të qëllimshëm të pornografisë, pavarësisht sa rastësor apo i rrallë, është se gjithmonë fton për ekspozim, që do ta rritë me doemos interesimin për ndjenja dhe sjellje seksuale. Shkencëtarët kanë zbuluar se pamjet seksuale prodhojnë kimikate në tru që ushqejnë ndjenja seksuale, të cilat mandej nxitin më shumë vëmendje te sjellja seksuale.[3] Sjellja seksuale e pamoralshme e çfarëdo lloji apo shkalle prodhon ndjenja turpi, që, me kohë, mund të nguliten tek individi.
3. **Përdorimi i Ngjeshur.** Përdorimi i përsëritur, i qëllimshëm i pornografisë mund ta bëjë përdorimin e saj një zakon, "një model sjelljeje i ndjekur rregullisht derisa është bërë thuajse i pavullnetshëm"[4]. Me përdorim të zakonshëm, individët përjetojnë një nevojë për më shumë nxitje për të pasur të njëjtin reaksion për t'u ndier të kënaqur.
4. **Përdorimi i Sëmurë (Varësi).** Sjellja e një personi është e fiksuar kur formon "varësi" (një term mjekësor lidhur me përdorimin e drogave, alkoolit, fiksimin te lojërat e fatit etj.) duke arritur kulmin te një "fiksim i pandalshëm" që "merr përparësi ndaj thuajse gjithçkaje tjetër në jetë"[5].

II. Rëndësia e Kuptimit të Këtyre Niveleve

Sapo i njohim këto nivele të ndryshme, ne njohim gjithashtu se jo kushdo që përdor pornografinë është me dashje i varur prej saj. Në fakt, shumë të rinj dhe të reja që luftojnë me pornografinë, nuk janë të varur. Ky është një dallim shumë i rëndësishëm për t'u bërë – jo vetëm për prindërit, bashkëshortët/et dhe udhëheqësit që duan të ndihmojnë, por edhe për ata që luftojnë me këtë problem. Ja përse.

Së pari, sa më i thellë niveli i përfshirjes ku hyn dikush – nga ekspozimi pa dashje, te përdorimi rastësor ose i qëllimshëm i përsëritur deri te përdorimi i ngjeshur, te përdorimi i fiksuar (i varur) – aq më e vështirë është të shërohesh. Nëse sjellja është klasifikuar gabimisht si një varësi,

përdoruesi mund të mendojë se ai ose ajo e ka humbur lirinë e zgjedhjes dhe aftësinë për ta kapërcyer problemin. Kjo mund ta dobësojë vendosmërinë për t'u shëruar dhe penduar. Në anën tjetër, pasja e një kuptimi më të qartë të thellësisë së një problemi – që mund të mos jetë aq i ngulitur apo skajor siç mund të trembemi – mund të japë shpresë dhe një aftësi të rritur që të ushtrojmë lirinë e zgjedhjes për ta ndërprerë dhe për t'u penduar.

Së dyti, si çdo sjellje mëkatare, përdorimi këmbëngulës i pornografisë e largon Frymën e Shenjtë. Disa që e kanë përjetuar këtë, do të ndihen të nxitur të pendohen. Të tjerë, gjithsesi, mund të ndihen në siklet dhe të kërkojnë ta fshehin fajin e tyre duke gënjyer. Ata gjithashtu mund të fillojnë të ndiejnë turp, që mund të çojë në neveri për veten. Nëse ndodh kjo, përdoruesit mund të fillojnë të besojnë një nga gënjeshtrat më të mëdha të Satanit: se ajo që ata kanë bërë ose vijojnë ta bëjnë, i bën njerëz të këqij, të padenjë për hirin e Shpëtimtarit dhe të paaftë për pendim. Kjo thjesht nuk është e vërtetë. Ne nuk jemi kurrë tepër larg për t'u ndihmuar nga Shpëtimtari dhe Shlyerja e Tij.

Së fundi, është e rëndësishme që të mos etiketojmë madje as përdorimin e ngjeshur apo të zakonshëm të pornografisë si një varësi sepse kjo nuk përshkruan saktë rrethanat apo natyrën e plotë të pendimit dhe shërimit të kërkuar. Pasja e një kuptimi më të mirë se ku është në proces një person do të lejojë gjithashtu një kuptim më të mirë se çfarë veprimi nevojitet për t'u shëruar.

III. Shpëtimi nga Pornografia

Tani le të shqyrtojmë se si munden individët t'i shpëtojnë kurthit të pornografisë dhe të shërohen. Kjo do të jetë e dobishme jo vetëm për ata që përpiqen të mposhtin përdorimin e pornografisë, por gjithashtu për prindërit dhe udhëheqësit që përpiqen t'i ndihmojnë. Individët do të jenë më të suksesshëm edhe në shmangien edhe në shërimin nga pornografia kur ata i diskutojnë këto tema me prindërit dhe udhëheqësit.[6]

Pavarësisht nivelit të përfshirjes në shikimin me dashje të pornografisë, rruga e shërimit, pastërtisë dhe pendesës ndjek dhe kërkon të njëjtat parime bazë: përulje, qenie dishepull, zotim ndaj një plani vetjak për ndryshim,

ILUSTRIMI NGA MAJIVECKA/ISTOCK/THINSTOCK

Të vepruarit sipas këtyre të vërtetave kërkon gjithashtu që individët të zotohen përsëri për të jetuar si dishepuj të Zotit Jezu Krisht dhe të bëjnë ato gjëra që i pastrojnë dhe i forcojnë ata për t'u rezistuar tundimeve të ardhshme.



përgjegjshmëri dhe mbështetje dhe durim me besim.

A. Përulësi

Për t'i mposhtur vërtet pornografinë dhe sjelljet e saj përkatëse, individët duhet të zhvillojnë përulësi (shih Ethëri 12:27). Të drejtuarit te Zoti në përulësi e bën njeriun të pranojë disa të vërteta, që, kur kuptohen plotësisht, sigurojnë forcë dhe largojnë turpin. Disa nga këto të vërteta përfshijnë:

- Secili prej nesh është një fëmijë i dashur i një Ati të dashur Qiellor.
- Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, e do dhe e njeh secilin prej nesh personalisht.
- Shlyerja e Shpëtimtarit tonë zbatohet për të gjithë fëmijët e Perëndisë.
- Nëpërmjet hirit të Jezu Krishtit, të gjithë mund të falen dhe të marrin fuqinë për të ndryshuar.
- Secili prej nesh ka dhuratën e paçmueshme të lirisë së zgjedhjes, që na lejon të marrim fuqinë dhe forcën e Shlyerjes.
- Individët që luftojnë me pornografinë mund të marrin shpresë nga fakti që të tjerë kanë arritur sukses në këtë betejë.
- Pornografia është e ligë, por angazhimi në të nuk e bën personin të lig.
- Çdo individ mund t'i shpëtojë kurthit të pornografisë dhe të shërohet plotësisht, por kjo është e mundur vetëm nëpërmjet përdorimit të fuqisë së Shlyerjes.
- Pendimi i vërtetë nga pornografia kërkon më shumë sesa thjesht ta ndalësh përdorimin e saj. Një pendim i tillë kërkon një ndryshim të zemrës nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit.

Pranimi i këtyre të vërtetave e përgatit njeriun shpirtërisht që të veprojë sipas tyre, që hap derën për të marrë ndihmën e Zotit për të bërë ndryshimet e nevojshme për t'u penduar dhe shëruar.

B. Dishepullimi

Të vepruarit sipas këtyre të vërtetave kërkon gjithashtu që individët të zotohen përsëri për të jetuar si dishepuj të Zotit Jezu Krisht dhe të bëjnë ato gjëra që i pastrojnë dhe i forcojnë ata për t'u rezistuar tundimeve të ardhshme. Kjo do të thotë zotim ndaj sjelljeve fetare vetjake: lutje domethënëse dhe studim shkrimesh të shenjta çdo ditë, marrje pjesë në mbledhje të kishës, shërbim, agjërim dhe (kur miratohet nga peshkopi) pjesëmarrje në sakrament dhe adhurim në tempull.

C. Zotimi ndaj një Plani Vetjak

Dishepujt e përulur të Jezu Krishtit do të fitojnë ndjeshmërinë për të njohur ndjenjat e thella, situatat shoqërore dhe rrethanat fizike që shkaktojnë tundimin për ta përdorur pornografinë. Kur analizohen këto shkaqe, ata mund të bëjnë një plan vetjak shpëtimi që t'i ndihmojë:

- Dallojini shkaqet dhe dëshirat kur ato shfaqen.
- Krijoni veprime të posaçme për t'i ndihmuar ata të tërhiqen nga tundimi.
- I riorientoni mendimet dhe energjitë drejt Zotit.
- Përvijoni veprime të posaçme të përditshme për të përforcuar zotimin e tyre vetjak për të jetuar drejtësisht.

Kur bëni një plan vetjak, individët duhet të përdorin burimet e shkëlqyera që siguron Kisha. Për shembull, faqja e internetit e Kishës overcomingpornography.org ka përmbajtje për individët si për anëtarët e familjes dhe udhëheqësit e priftërisë që i mbështesin ata. Përveç kësaj, Programi i Kishës për Shërimin nga Varësia është në dispozicion të të gjithë anëtarëve që luftojnë me çfarëdo sjelljeje varësie dhe do t'i ndihmojë gjithashtu anëtarët e familjes së tyre.

ILUSTRIMI ME FOTO NGA INGRAM PUBLISHING/ISTOCK/THINKSTOCK

D. Përgjegjshmëri dhe Mbështetje

Ndjekësit e përulur të Jezu Krishtit që e pranojnë se kanë nevojë për Shpëtimtarin, do të kërkojnë gjithashtu ndihmën e peshkopit të tyre, i cili është thirrur nga Zoti si udhëheqës i tyre i priftërisë dhe që mban çelësat e nevojshëm për t'i aftësuar të pendohen. Me pëlqimin e individëve të përfshirë dhe nëse peshkopi ndihet i frymëzuar kështu, ai mund të thërresë gjithashtu dikë tjetër për të punuar dhe për t'i ndihmuar ata. Pavarësisht rrethanave, kjo këshillë nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910-2008) gjen zbatim:

"Lutjuni Zotit nga thellësia e shpirtit tuaj që Ai të heqë nga ju varësinë që ju skllavëron. Dhe paçi guxim të kërkoni drejtimin e dashur të peshkopit tuaj dhe, nëse është e nevojshme, këshillën e profesionistëve të dashur"[7].

Në varësi të thellësisë së problemit, individët mund të kërkojnë mbështetjen e një personi të besuar me përvojë ose një këshilltari profesionist tek të cilët mund të drejtohen në çdo orë për t'u forcuar në çaste dobësie dhe që mund t'i mbajnë ata personalisht përgjegjës ndaj planit të tyre.

Secili prej nesh ka dhuratën e paçmueshme të lirisë së zgjedhjes, që na lejon të marrim fuqinë dhe forcën e Shlyerjes.

E. Durim me Besim

Personat që janë penduar dhe janë bekuar për të mposhtur dëshirën për të përdorur pornografi, duhet përsëri të jenë syhapur, sepse kundërshtari përsëri do të përpiqet të shfrytëzojë dobësinë e tyre njerëzore. Ekspozimi pa dashje mund të ndodhë përsëri pavarësisht gjithë përpjekjeve për ta shmangur. Gjatë gjithë jetës së tyre, individët duhet të mësojnë të kontrollojnë ndjenjat e tyre seksuale të dhëna nga Perëndia dhe të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të qenë të pastër.

IV. Dhembshuri për të Gjithë

Tani një fjalë lidhur me mënyrën si i trajtojmë ata që kanë rënë në kurthin e pornografisë. Të gjithë ne kemi nevojë për Shlyerjen e Jezu Krishtit. Ata që luftojnë me pornografinë, kanë nevojë për dhembshurinë dhe dashurinë tonë ndërsa zbatojnë parimet dhe hapat e shërimit. Ju lutemi mos i ndëshkoni ata. Ata nuk janë të ligj apo pa shpresë. Ata janë bij dhe bija të Atit tonë Qiellor. Nëpërmjet pendimit të duhur dhe të plotë, ata mund të bëhen të pastër, të dëlirë dhe të denjë për çdo besëlidhje dhe bekim të tempullit të premtuar nga Perëndia.

Kur vjen koha e martesës, unë i nxit të rejat dhe të rinjtë që të jenë të kujdesshëm të zgjedhin një partner që të jetë shoku apo shoqja e tyre përgjatë përjetësisë që është i/e pastër dhe i/e dëlirë përpara Zotit dhe i/e denjë për të hyrë në tempull. Individët që pendohen plotësisht për pornografinë, janë të denjë për këto bekime.

V. Përfundimi

Gjatë gjithë jetës sonë, të gjithë ne do të ndeshemi me material me përmbajtje seksuale. Me drejtimin e Shpëtimtarit tonë të dashur, përfshirë sigurimin nga besëlidhjet e sakramentit që të mund të kemi gjithmonë Shpirtin e Tij me ne (shih DeB 20:77), ne mund të reagojmë gjithmonë siç duhet. Unë dëshmoj se kjo është ajo që ne duhet të bëjmë për të gëzuar bekimet e Atij të cilin ne e adhurojmë. Kur e bëjmë këtë, ne do të marrim më plotësisht paqen e Shpëtimtarit dhe do të qëndrojmë në udhën për te destinacioni ynë i përjetshëm i ekzaltimit. ■

SHËNIME

1. Shih Dallin H. Oaks, "Pornography", *Liahona,* maj 2005, f. 87–90.
2. Shih Dallin H. Oaks, "Sins and Mistakes", *Ensign,* tetor 1996, f. 62–67.
3. Shih Donald L. Hilton Jr., M.D., "Pornography Addiction—a Supranormal Stimulus Considered in the Context of Neuroplasticity", *Socioaffective Neuroscience and Psychology,* vëll. 3 (2013), socioaffectiveneuroscipsychol.net/index.php/snp/article/view/20767; shih edhe "Porn Changes the Brain", fightthenewdrug.org.
4. *Webster's Encyclopedic Unabridged Dictionary of the English Language* (1989), "habit".
5. *American College of Physicians Complete Home Medical Guide* (1999), f. 564.
6. Përveç kësaj, të rinjtë dhe prindërit e tyre duhet të kenë biseda të sinqerta, por të përshtatshme rreth riprodhimit njerëzor. Të rinjtë që dëgjojnë rreth seksualitetit njerëzor më shumë nga shokët e tyre sesa nga prindërit e tyre kanë më shumë gjasa të kërkojnë informacion rreth tij nëpërmjet pornografisë.
7. Gordon B. Hinckley, "A Tragic Evil among Us", *Liahona,* nëntor 2004, f. 62.

Në VENDIN E DUHUR në KOHËN E DUHUR

MËSIME TË SË DIELËS

Tema e Këtij Muaji:
Të Bërit më Shumë si Krishti

Aju ka thënë ndonjëherë dikush se ajo çka keni bërë ose keni thënë ishte saktësisht ajo që ata kishin nevojë? Ndonjëherë kjo ndodh ngaqë Ati Qiellor ju dërgoi në çastin e duhur për të ndihmuar. Ju qetë në harmoni me Shpirtin, prandaj mund ta dallonit atë nxitje nga Ati Qiellor. Qëndroni i denjë dhe i gatshëm për të ndihmuar – ju kurrë nuk e dini se kur Ai do të ketë nevojë që të jeni engjëlli i dikujt.

Këtu janë dy histori njerëzish që bënë pikërisht atë:

BILETA E PARKINGUT

Nga Fatima Roka Gutierres

Unë shkova në kinema me disa miq të mi nga kisha. Kur u futëm te kompleksi, na u dha një biletë për vendin e parkimit. Pasi mbaroi filmi, pamë se e patëm humbur biletën e parkimit. Fillimisht ne menduam se thjesht mund ta paguanim biletën, por asnjë nga ne nuk i kishte 180 pezos që duheshin për gjobën.

Pasoja e mospagimit të parkimit ishte heqja e makinës me karrotrec nga kompleksi, që do të ishte edhe më kushtueshme. Dëshpërimi i mbuloi miqtë e mi, veçanërisht atë që po e drejtonte makinën, pasi ishte e babait të tij. Unë u mënjanova pak për të bërë një lutje. I kërkova Atit Qiellor me tërë besimin e përulësinë time që të na jepte një mënyrë për zgjidhjen e problemit dhe kthimin e sigurt në shtëpitë tona. Unë nuk do ta harroj kurrë atë që ndodhi vetëm pak sekonda pasi mbarova lutjen.

Ndërsa po kthehesha duke ecur drejt makinës, dikush pas meje filloi të thërriste emrin tim. Ishte Franciskoja, një mik nga shkolla e mesme. Ai më pyeti se çfarë po bëja dhe i tregova se çfarë pati ndodhur. Pa ngurrim, ai nxori portofolin dhe më dha para të mjaftueshme për të paguar biletën e humbur. Ky veprim bujarie ishte një përgjigje e menjëhershme e lutjeve të mia ndaj Atit Qiellor.

Franciskoja mund të mos e dijë kurrë se çfarë ndihme të madhe na dha, por unë di që do të jem thellësisht mirënjohëse gjatë gjithë jetës.

Ndonjëherë mënyrat se si Ati Qiellor u përgjigjet lutjeve tona janë befasuese, por rastësitë nuk ekzistojnë. Ati ynë Qiellor dhe Jezu Krishti na njohin përsosurisht dhe lëvizin fijet e jetës sonë.

Unë e di se kur jetojmë me drejtësi, ne gëzojmë bekime të panumërta



që vetëm Ati Qiellor mund të na i japë, përfshirë premtimin e Tij për ne se "në qoftë se i bë[jmë] këto gjëra, [ne] do të ngrihe[mi] në ditën e fundit" (Alma 37:37). ■

Autorja jeton në Baja Kalifornia, Meksikë.

NJË THIRRJE TELEFONIKE NË KOHË

Nga Çen Çing Çuan

Duke u rritur, unë nuk besoja se kishte Perëndi. Jeta ime ishte plot trazira dhe në ditët e mia më të këqija isha aq i depresuar saqë doja t'i jepja fund jetës. Kjo ishte koha kur misionarët erdhën duke trokitur në derën time. Ungjilli ishte saktësisht ajo çka kisha nevojë; unë u tërhoqa pas tij si magnet.

Sprovat e mia nuk mbaruan pasi u bashkova me Kishën, por unë isha në një pozitë më të mirë për t'i rezistuar ndikimit të kundërshtarit. Për herë të parë, unë e dija se çfarë ndjenjash të jepte lumturia.

Sidoqoftë, depresioni nuk e lironte lehtësisht ngulmin e vet. Në një pikë unë doja të dorëzohesha përsëri. Në atë çast motra Ting, bashkëshortja e peshkopit, telefonoi. Ajo më tha se kishte një ndjesi se kishte nevojë të më telefononte. Ajo pyeti se si po ia kaloja. Unë i hapa zemrën asaj. Për mua ajo ishte një engjëll i dërguar nga Perëndia.

Ajo ndodhi më dha fuqi. Besimi im po forcohej. Unë ndieja se mund ta pushtoja vdekjen. Unë ndihesha i çliruar, siç thuhet tek Alma 36:2–3:

"Ata qenë në robëri dhe askush nuk mund t'i çlironte përveçse . . . Perëndi[së]. . . .

. . . Se kushdo që vë besimin e tij në Perëndi, do të përkrahet në sprovat e tij dhe në vështirësitë e tij dhe në mjerimet e tij dhe do të ngrihet në ditën e fundit."

Unë kam ende sprova, por nuk do mund të mundem lehtë përsëri. Perëndia më ka mbështetur ndër gjithë sprovat dhe telashet e mia. Ai më ka shpëtuar nga burgu dhe robëria shpirtërore, madje nga vdekja. Ai është Shpëtimtari im. ■

Autori jeton në Taiçung, Tajvan.



PERËNDIA KUJDESET PËR NE

"Perëndia njëmend na shikon dhe kujdeset për ne. Por zakonisht është nëpërmjet një personi tjetër që Ai i plotëson nevojat tona. Prandaj, është jetike që ne t'i shërbejmë njëri-tjetrit në mbretëri."

President Spencer W. Kimball (1895–1985), *Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* (2006), f. 82.

ILUSTRIMI NGA BRYAN BEACH

LIBRI JUAJ I JETËS

Çfarë do të vini ju në të?

Çdo ditë sjell një faqe të re për t'u shkruar. Jetoni në mënyrë të tillë që çdo faqe të thotë: "Gëzohem që e bëra" jo "Do të doja ta kisha bërë".

(Shih L. Tom Perri, "How to Fill Your Book of Life", *Liahona*, shkurt 2014, f. 61.)

FOTOILUSTRIMI NGA WELDEN C. ANDERSEN, TRAVIS DEMING DHE CHERYL E. JOHNSON; STOCK PHOTOGRAPHS © HEMERA/THINKSTOCK, PHOTODISC/THINKSTOCK DHE ISTOCK/THINKSTOCK

Zanafilla 1:26–27

Çfarë do të thotë të jesh krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë?

SHËMBËLLTYRA E PERËNDISË

"Njohja e një fuqie më të epërme se vetja nuk ul në asnjë kuptim; përkundrazi, ajo ekzalton. Nëse thjesht do të kuptojmë që kemi qenë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, nuk do na duket e vështirë që t'i afrohemi Atij. . . . Kjo njohuri, e fituar nëpërmjet besimit, do të sjellë qetësi të brendshme dhe paqe të thellë."

President Thomas S. Monson, "The Lighthouse of the Lord", *Ensign,* nëntor 1990, f. 95–96.

LE TË [FILLOJMË]

Ky formulim në shumës bën të tingëllojë sikur Perëndia po flet me dikë tjetër – sepse Ai është duke folur me të tjerë. Jozef Smithi na mësoi: "Në fillim, kreu i Perëndive thirri një këshill të Perëndive; dhe ata u mblodhën dhe hartuan [përgatitën] një plan për të krijuar botën dhe për ta populluar atë" (*History of the Church,* 6:308). Ky këshill përfshiu Zotin Jezu Krisht dhe të tjerë (shih Moisiu 2:26–27; Abraham 4:26–27).

SIPAS PAMJES SONË

"Perëndia Vetë ishte njëherë siç jemi ne tashti, dhe është një njeri i ekzaltuar dhe ulet i kurorëzuar në qiejt atje lart! Ky është sekreti i madh. Nëse veli do të grisej sot, dhe . . . nëse do ta shihnit Atë sot, do ta shihnit Atë me formën e një njeriu – si ju vetë, në gjithë personin, imazhin dhe vetë formën e një njeriu."

***Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 42.**

26 Pastaj Perëndia tha: «Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne, dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe». **27** Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën.

"Njeriu është fëmijë i Perëndisë, i formuar sipas shëmbëlltyrës hyjnore dhe me dhurime cilësish hyjnore, dhe madje si bir i mitur i një ati dhe një nëne tokësore është në gjendje në kohën e duhur të bëhet burrë, në mënyrë që pasardhësi me prindër qiellorë i pazhvilluar është në gjendje, me anë të përvojës ndër epoka e pafundësi, për t'u zhvilluar në Perëndi."

The First Presidency, "The Origin of Man", *Improvement Era,* nëntor 1909, f. 81; *Ensign,* shkurt 2002, f. 30.

ZOTËRIM

"Toka dhe të gjitha gjërat mbi të duhet të përdoren me përgjegjshmëri për të mbështetur familjen njerëzore. Megjithatë, të gjithë janë kujdestarë – jo pronarë – të kësaj toke dhe bujarisë së saj dhe do të jenë përgjegjës përpara Perëndisë për atë që bëjnë me krijimet e Tij."

"Environmental Stewardship and Conservation", mormonnewsroom.org; shih edhe Doktrina e Besëlidhjet 104:13–15.

MASHKULLI DHE FEMRA

"Të gjithë burrat e gratë kanë ngjashmëri me Atin dhe Nënën universale dhe janë me kuptimin e plotë të fjalës bij e bija të Hyjnisë."

The First Presidency, "The Origin of Man", *Improvement Era,* nëntor 1909, f. 78; *Ensign,* shkurt 2002, f. 29.

"Gjinia është një karakteristikë thelbësore e identitetit dhe qëllimit individual të jetës para lindjes, të jetës së vdekshme dhe asaj të përjetshme."

"Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", *Liahona,* nëntor 2010, f. 129.

Shënim i redaktorëve: Kjo faqe nuk synon të jetë një shpjegim tërësor i vargjeve të përzgjedhura për zotërimin e shkrimeve të shenjta në seminar, por vetëm një pikënisje për studimin tuaj vetjak.

KËRKIMI IM PËR TË VËRTETËN

Mua gjithmonë më kishin mësuar se nuk kishte gjë të tillë si Perëndia, por vendosa ta gjej vetë.

Nga Peng Hua

Duke pas qenë rritur në një vend aziatik me konkurrencë dhe jo fetar, unë kam pasur gjithmonë një dëshirë të madhe për t'u bërë një person i suksesshëm, por nuk kisha ndonjë parim apo të vërtetë të përhershme që të më udhëhiqte. Në vendin tim, "i suksesshëm" nënkupton të qenit i pasur dhe i fuqishëm.

Prindërit e mi gjithmonë më kishin mësuar se nuk kishte gjë të tillë si Perëndia. Për ta, feja apo Perëndia ishte një dëng dokrrash dhe vetëm për njerëzit e dobët. Për një kohë të gjatë unë e konsideroja veten ateist. Ata më mësuan se nuk duhej t'i besoja askujt përveç vetes. Kështu, që në moshë të re, unë i kam përdorur ambiciet e mia si shtysë për të studiuar dhe punuar fort në mënyrë të skajshme.

Prindërit e mi kishin pritshmëri të larta për mua. Ata donin që unë të kisha nota të larta gjithë kohën. Unë dëshpërohesha kur shihja fytyrat e tyre të zhgënjyera ose i dëgjoja të grindeshin me njëri-tjetrin kur merrja notë të keqe. Bashkë me punën time të zakonshme të shkollës, unë duhej gjithashtu të bëja detyra shtëpie shtesë në fundjavë që të mund ta mbaja 10 mesataren.

Edhe pas përmbushjes së objektivave që kisha vendosur, përsëri ndieja se kishte diçka tjetër për t'u përmbushur në jetën time. Thellë në zemrën time, e dija se sigurisht duhej të kishte më shumë.

Një ditë vendosa se do të më duhej ta gjeja vetë nëse kishte vërtet një Perëndi. Nëse Ai ekzistonte vërtet, unë doja ta dija se çfarë Ai donte për mua ose nëse feja ishte thjesht një dëng dokrrash të krijuara nga fantazia e qenieve njerëzore. Unë nuk kisha frikë të merrja cilëndo nga këto dy përgjigje. Unë thjesht doja të vërtetën.

Rreth po asaj kohe, unë u bëra mik i ngushtë me një nga shokët e mi të skuadrës së basketbollit që quhej Tejlor. Një mëngjes i kërkova atij për një rrugëtim për në shkollë. Ai tha po, por do më të duhej të ngrihesha një orë më herët për të shkuar në seminar me të. Unë thashë pa qejf po, duke mos ditur se çfarë ishte. Mua më pëlqeu seminari, edhe pse më shumë nga ajo që ndjeva sesa nga ajo që mësova.

Shpejt pas asaj, Tejlori më ftoi që të shkoja në kishë me të. Në fillim mendova se kisha ishte pak e mërzitshme dhe e çuditshme, por përfundimisht u preka nga ndjesia e ngrohtë dhe paqësore që ndjeva gjatë shërbimit.

Sidoqoftë, unë ende nuk isha i bindur se ndjesia e mirë kishte ndonjë lidhje me Perëndinë. Si e mësova se ajo nuk erdhi nga vetja? Si e mësova se nuk isha unë që bëra të ndihesha ashtu?

Pas shumë debatesh me veten, unë shkova te nëna e Tejlorit në kërkim të përgjigjeve. Ajo më tregoi se unë mund t'i merrja përgjigjet duke lexuar shkrimet e shenjta dhe duke u lutur rreth përgjigjeve për të cilat po kërkoja. Unë u luta pa marrë ndonjë përgjigje dhe u përpoqa t'i respektoja rregullat dhe urdhërimet rreth të cilave po mësoja. Unë u bëra shumë herë i pashpresë. Unë prisja një shfaqje të mrekullueshme dhe dramatike të Perëndisë ose një lloj mrekullie që të provonte se Perëndia ishte i vërtetë. Në thelb, unë doja një dëshmi të patundur njëherësh. E vërteta është, sa më shumë lutesha, aq më shumë qartësi ndieja në jetën time. Sa më shumë i ndiqja urdhërimet, aq më i lumtur bëhesha. Sa më shumë i lexoja shkrimet e shenjta, aq më shumë zbulesë merrja. Gradualisht, dëshmia ime rritej, si ngritja e diellit në mëngjes.

M'u deshën dy vjet që të vendosja të pagëzohem anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të

ILUSTRIMI NGA DAN BURR

NE MUND TË ZGJEDHIM TË BESOJMË

"Bindja dhe dëshmia dhe besimi nuk janë parime pasive. Nuk është se ato thjesht na ndodhin. Besimi është diçka që ne e zgjedhim – ne shpresojmë për të, punojmë për të dhe sakrifikojmë për të. Ne nuk do të arrijmë të besojmë rastësisht te Shpëtimtari dhe ungjilli i Tij sikurse nuk do të lutemi apo paguajmë të dhjetën rastësisht. Ne në mënyrë aktive zgjedhim të besojmë, njësoj siç zgjedhim t'i mbajmë urdhërimet e tjera."

Plaku L. Uitni Klejton, i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, "Zgjidhni të Besoni", *Liahona*, maj 2015, f. 38.

Mëvonshme. Edhe pse jetoja shumë standarde dhe parime të mira morale më parë, unë mund të them tani se kam gjetur të vërtetën e përjetshme dhe themelore: Perëndia jeton. Jezusi është Krishti, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Qiejt janë hapur. Një profet i Perëndisë ecën në tokë sot. Shlyerja e Jezu Krishtit është e vërtetë. Perëndia vërtet i fal të gjithë mëkatarët e penduar. Unë mund të mos jem aq i zgjuar ose me aq dhunti sa njerëz të tjerë, por njohuria që kam është e paçmueshme. ■

Autori jeton në Kaliforni, SHBA.

TË RINJ *Mahnitës* *DHE* TË REJA MAHNITËSE NË SHKRIMET E SHENJTA

Ju mund t'i mësoni mësoni dhe t'i ndiqni shembujt e shumë të rinjve të drejtë, historitë e të cilëve janë ruajtur në shkrimet e shenjta.

Nga Zhizela Gutier

Zoti e do rininë e Kishës. Ai ka një besim të madh te ju. Në çdo epokë, Zoti ka frymëzuar të rinj dhe të reja të guximshme për të udhëhequr dhe bekuar popullin e Tij. Ai ka nevojë për fuqinë e tyre krijuese, guximin dhe origjinalitetin. Ai gjithmonë ka qenë kështu dhe do të vazhdojë të jetë kështu.

Shembujt e shumtë të heronjve të rinj përshkojnë si fill i artë gjithë shkrimet e shenjta. Edhe pse ata jetuan shumë kohë përpara, ju mund t'i ndiqni shembujt e tyre dhe të lidheni me jetën e tyre. Ata patën probleme familjare; ata jetuan midis njerëzve të padrejtë; ata përballuan "Goliathë", por guximi, bindja dhe besimi i tyre në Jezu Krisht i çoi përpara përmes sfidave të tyre – ashtu siç mund të bëjnë këto cilësi për ju gjithashtu.

Abrahami

Vendosmëria, guximi dhe gatishmëria e Abrahamit për të ngritur zërin e vet kundër ligësisë ishin mahnitëse – madje më mahnitëse po të kihet parasysh se babai i tij adhuronte idhuj. Kur qe i ri, ai qëndroi aq fort për drejtësinë saqë gati e vranë si sakrificë. (Shih Abraham 1:2–7.)

Jozefi i Egjiptit

Ai ishte 17 vjeç kur vëllezërit e tij më të rritur e shitën si skllav, megjithatë, me bekimet e Zotit, Jozefi qe në gjendje të bënte diçka të mirë në këtë situatë të vështirë. Ai nuk u mund, sepse ai nuk u dorëzua kurrë. Besimi i tij në Zot ishte i vazhdueshëm. Madhështia e brendshme e Jozefit u shfaq në mënyrën fisnike me të cilën ai i fali padrejtësitë që i ishin bërë. (Shih Zanafilla 37; 45.)

Davidi

Kur ishte adoleshent, Davidi ishte bari dhe luftoi kundër një ariu dhe një luani për të mbrojtur delet e babait të tij. Vetëbesimi i tij nuk erdhi nga aftësitë e tij si bari; ai erdhi nga besimi i tij tek Ati Qiellor, siç shfaqet në luftën e tij kundër Goliathit. (Shih 1 Samuelit 17:32–54.)

Esteri

Ajo pati vendosmërinë ta vendoste jetën e vet në rrezik për të shpëtuar njerëzit e saj. Nuk ishte bukuria e Esterit, por karakteristikat e saj shpirtërore që e bënë atë një njeri të madh. (Shih Esterit 4–5.)

Danieli

Ai iu bind ligjit të Zotit për shëndetin edhe pse të tjerët përreth tij nuk vepronin kështu. Ai lutej, edhe pse lutja ndaj Atit Qiellor ishte kundër

ILUSTRIMI NGA ANDREW BOSLEY



urdhrave të mbretit. Në saje të drejtësisë së tij dhe hapjes ndaj frymëzimit nga Shpirti, Danieli u bekua nga Zoti me dhuratën e interpretimit të ëndrrave dhe vegimeve. Ai mori fuqi dhe urtësi nga Ati Qiellor deri atje saqë në kohë rreziku, fuqitë e qiellit qenë në dispozicion të tij. (Shih Daniel 1; 6.)

Nefi

Nefi ishte një shembull i pabesueshëm kur tha: "Unë do të shkoj dhe do të bëj gjërat që Zoti ka urdhëruar" (1 Nefi 3:7). Ai pati guximin të bënte atë që iu kërkua të bënte. A jetoi ai në një shtëpi të rehatshme? Jo, ai jetoi në shkretëtirë për shumë vite. A shkonin mirë gjërat për të? Jo, vëllezërit e tij shpesh inatoseshin me të dhe disa herë u përpoqën ta vrisnin. Nëpër gjithë këtë, ai gjithmonë iu bind urdhrave të Zotit.

Dy Mijë Luftëtarë të Rinj Amonitë

Këta të rinj qenë rritur nga prindër besnikë dhe besimi i tyre te fjalët e nënave të tyre i bekoi ata. Ata mësuan të dëgjonin me vëmendje dhe të bindeshin me saktësi, dhe në betejat e tyre ata nuk dyshuan që Ati i tyre në Qiell do t'i mbronte. (Shih Alma 56:45–48.)

Mormoni

Kur ishte 15 vjeç, Zoti e vizitoi atë ngaqë ishte i përulur, i pastër dhe i dëlirë, me gjithë ndyrësinë e njerëzve përreth tij. Gjithashtu, në moshën 15 vjeçare, Mormoni u bë udhëheqës i ushtrisë. Më vonë atij iu besua mbajtja e shkrimeve të shenjta. (Shih Mormoni 1–2.)

Jozef Smithi

Në moshën 14-vjeçare ai kërkoi në shkrimet e shenjta dhe u lut që të dinte me cilën kishë të bashkohej. Zoti e thirri atë që të rivendoste ungjillin dhe Kishën e Jezu Krishtit. Jozefi ia kushtoi gjithë jetën e vet përmbushjes së asaj detyre, me gjithë pengesat dhe vështirësitë e shumta. Në moshën 17-vjeçare, ai u vizitua nga engjëlli Moroni, i cili i tregoi atij fletët e arta. Edhe pse në moshë të re, Jozef Smithi ishte një mësues i fuqishëm dhe një shembull i madh për ata përreth tij. (Shih Joseph Smith – Historia 1.)

Dita Juaj

A kanë kaluar ditët e të rinjve mahnitës dhe të rejave mahnitëse? Jo! Engjëlli Moroni e vuri në dijeni Jozef Smithin se parashikimi i Joelit do të përmbushej:

"Unë [Zoti] do të përhap Frymën tim mbi çdo mish; bijtë tuaj dhe bijat tuaja do të profetizojnë, pleqtë tuaj do të shohin ëndrra, të rinjtë tuaj do të kenë vegime.

Në ato ditë do të përhap Frymën time edhe mbi shërbëtorët dhe shërbëtoret" (Joel 2:28–29; shih Joseph Smith – Historia 1:41). ■

Autorja, që ishte një mësuese seminari, jetoi në Gjermani dhe vdiq në vitin 2012.

"Kur nëna ime u sëmur, ne agjëruam dhe u lutëm për të, por megjithatë ajo vdiq. Si mund të ndihem në paqe me këtë?"

Kjo është një kohë trishtimi në jetën tënde. Është normale të duash siguri dhe përgjigje për pyetjet e tua të shumta: "Përse nuk jetoi ajo? A do ta shoh përsëri? Si mund të vazhdoj pa të?"

Ungjilli i Jezu Krishtit i ofron të dyja edhe siguri edhe përgjigjet. Zoti premtoi: "Të bekuar janë të gjithë ata që vajtojnë, pasi ata do të ngushëllohen" (3 Nefi 12:4). Kërkoni Frymën e Shenjtë, sepse Ai është Ngushëlluesi.

Pyeteni veten nëse lutjet tuaja janë dëgjuar. Jini të sigurt: Ati Qiellor gjithmonë i dëgjon lutjet tona. Shkrimet e shenjta dhe profetët e gjallë na premtojnë se kjo është e vërtetë. Ajo që Zoti i tha Jozef Smithit, zbatohet edhe për ju: "Lutjet e tua dhe lutjet e vëllezërve të tu kanë ardhur në veshët e mi" (DeB 90:1). Por ne duhet të kujtojmë se Ati Qiellor u përgjigjet lutjeve tona me një këndvështrim të përjetshëm në mendje (shih Isaia 55:8–9). Kjo është arsyeja përse ne e ndjekim shembullin e Shpëtimtarit për të kërkuar bekime, por mandej duke kërkuar sinqerisht që vullneti i Atit të bëhet (shih Lluka 22:42).

Edhe pse e vështirë, kjo sprovë mund të jetë një kohë rritjeje për ju. Ju mund të mësoni të keni besim në vullnetin e Perëndisë, madje edhe nëse kjo parakupton që nëna juaj nuk shërohet. Sigurisht që ju donit që ajo të jetonte. Por prova e kësaj jete të vdekshme është që të besosh në Perëndi në të gjitha kohët – sidomos kur është e vështirë. Nëse besoni tek Ai, "gjithë gjërat do të punojnë së bashku për të mirën tuaj" (DeB 90:24).

Vdekja Është Pjesë e Planit

Sipas planit të lumturisë të Atit tonë Qiellor për ne, kthimi ynë në praninë e Tij bazohet te vdekja dhe ringjallja, që do të na ndihmojnë të kalojmë nga kjo gjendje e vdekshme në një gjendje të pavdekshme. Ju duhet vetëm të pranoni faktin se vdekja është pjesë e planit dhe të besoni se një ditë do të jeni në gjendje që përsëri të jeni me nënën tuaj të vdekur. Dijeni që nëna juaj është në botën e shpirtrave dhe se ajo po pret për ju.

Dejvid M., 18 vjeç, Kasai Perëndimor, Republika Demokratike e Kongos

Ajo është në Botën e Shpirtrave

Nëna ime u diagnostikua dy vjet më parë me kancer. Unë nuk doja ta shihja në dhembje dhe uroja që të mund të bëja diçka. Dhe edhe pse nëna ime u bë më mirë, ajo ishte një përvojë e vështirë. Nëna juaj është në një vend ku nuk do të ndiejë dhembje apo vuajtje. Është e vështirë të mos e shohësh më, por ju nuk jeni kurrë vetëm. Ajo do t'ju dojë gjithmonë dhe Ati ynë Qiellor do të jetë atje gjithmonë për t'ju ngritur kur jeni poshtë. Ju nuk do të jeni kurrë i braktisur. Jezu Krishti vuajti dhembjet e botës; Ai e di se si ndiheni dhe në çfarë gjendje po kaloni. Bëni siç bëra unë në kohën time të sprovës: shkoni tek Ai dhe Ai do t'i bëjë barrët tuaja të lehta.

Shiloh W., 18 vjeç, Çiuaua, Meksikë

Përgjigjet synojnë të japin ndihmë dhe këndvështrim, jo si deklarime zyrtare të doktrinës së Kishës.

Familja Juaj Do Të Ribashkohet

Nëna ime vdiq kur isha vetëm 12 vjeçe. Në atë kohë unë nuk isha anëtar e Kishës. Kur ishte e sëmurë, unë lutesha shumë që ajo të bëhej mirë. Unë kisha shumë besim dhe besoja te Perëndia me shpresën që shëndeti i saj do të rikthehej. Mjerisht ajo nuk u shërua. Unë pyesja përse ajo duhej të vdiste në një moshë të tillë të re dhe të më linte ndërsa isha ende adoleshente. Isha e zemëruar dhe arrita në një pikë që dyshoja se ekzistonte Perëndia. Tani që jam anëtare e Kishës, e kuptoj planin e shpëtimit. Unë e di se ajo po më pret dhe se familja jonë do të ribashkohet.

Ina L., 19 vjeçe, Minas Gerais, Brazil

Sprovat Na Japin Mësim

Nëna ime vdiq tre vjet më parë. Marrëdhënia juaj me Atin tuaj Qiellor dhe me Shpëtimtarin do të rritet nëse vështroni nga Ata kur keni nevojë. Ju do të shihni se kjo sprovë, shkatërruese siç mund të jetë, mund të jetë gjithashtu një bekim. Lutiuni Ati tuaj në Qiell për paqe dhe siguri. Besoni në planin e Zotit për ju. Pranojeni që Ati Qiellor e di se ku po shkojmë dhe çfarë duhet të bëjmë që të arrijmë atje. Zoti ju do dhe do që ju të keni gëzim. Sprovat tona janë për të na mësuar dhe për të na bërë më të fortë.

Megan B., 18 vjeç, Ontario, Kanada

Ju Do Ta Shihni Atë Përsëri

Nëna e nënës sime vdiq kur nëna ime ishte 17 vjeçe. Familja agjëroi dhe u lut për të gjatë disa javëve përpara se ajo të vdiste. Asaj iu dha gjithashtu një bekim priftërie. Gjëja kryesore që i dha paqe nënës sime, ishte dijenia se ajo do të mund ta shihte nënën e saj përsëri në jetën tjetër. Qëllimi i nënës sime është që ta jetojë jetën e saj në mënyrë të tillë që të jetë e denjë për atë bekim. Jam e dëshpëruar që nuk do të jem kurrë në gjendje ta takoj atë në këtë jetë, por mezi e pres kohën kur përfundimisht do të takohemi.

Keri R., 15 vjeç, Juta, SHBA

JU BËTË GJITHÇKA QË MUNDESHIT

"Sa për shërimin e të sëmurëve, [Zoti] qartësisht tha: 'Dhe përsëri, do të ndodhë që ai që ka besim në mua për t'u shëruar, *dhe nuk caktohet për vdekjen*, do të shërohet' (DeB 42:48; kursivet shtuar). Shumë shpesh ne të gjithë e kalojmë pa e vënë re frazën kualifikuese 'dhe nuk caktohet për vdekjen'.... Mos u dëshpëroni kur janë ofruar lutje të zjarrta dhe janë dhënë bekime priftërie dhe i dashuri juaj nuk përmirësohet ose madje largohet nga vdekshmëria. Ngushëllohuni në faktin që bëtë gjithë sa mundët.... Përvojat e lutjes, agjërimit dhe besimit mund të kenë qenë fare mirë më tepër për të mirën *tonë*."

Plaku Lance B. Wickman, anëtar i Të Shtatëdhjetëve nga viti 1994 deri në 2010, "But If Not", *Liahona*, nëntor 2002, f. 30–31.

PYETJA PASUESE

"Disa njerëz më thonë se duhet të kem miq që nuk kanë standarde të njëjta me mua, me qëllim që të forcoj të miat. A është e vërtetë kjo?"

Dërgoni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë deri më 15 nëntor 2015 te liahona.lds.org, nëpërmjet postës elektronike te liahona@ldschurch.org ose nëpërmjet postës (shih adresën në faqen 3).

Informacioni dhe leja e mëposhtme duhet të përfshihen në postimin elektronik apo letrën tuaj: 1) emri i plotë, 2) data e lindjes, 3) lagjja ose dega, 4) kunji ose distrikti, 5) leja juaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18 vjeç, leja me shkrim e prindit tuaj (postimi elektronik pranohet) për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë suaj.

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.

Një Vendim Fitimtar

Kjo ishte mundësia e saj për të luajtur në ekipin fitues, si mund të thoshte jo?

Nga Marisa Uidison
Revistat e Kishës
Bazuar në një ndodhi të vërtetë

"Mbaj mend ditën e shabatit, që ta mbash të shenjtë" (Mosia 13:16).

Miranda u ngut për në derën kryesore, mirënjohëse se shtëpia e saj ishte më e freskët se moti i nxehtë veror jashtë. Ajo ishte e djersitur nga loja në ndeshjen e saj të fundit të futbollit për atë sezon dhe e acaruar sepse ekipi Teal Turbos kishte humbur. Përsëri.

Mami erdhi në dhomë duke mbajtur një shishe me ujë dhe një qese me feta portokalli të mbetura nga ndeshja. "Ju bëtë një lojë të shkëlqyer. Të qenit portiere është një punë e rëndë."

Miranda *kishte* luajtur mirë, ajo kishte bllokuar shumë goditje dhe kishte shkelmuar më fort se zakonisht. Por shumica e vajzave të tjera në ekipin e saj nuk kishin luajtur kurrë futboll më parë dhe sot e bënë zyrtare: ato kishin humbur çdo ndeshje këtë sezon.

"Unë thjesht dëshiroj të jem në një ekip që fiton një herë në kaq kohë, e di?" Ca lot rrodhën nga cepat e syrit të Mirandës dhe ranë në fanellën e saj blu me të gjelbër. Ndërsa i mbyllte sytë duke i shtrënguar, ra telefoni.

Mami e ngriti telefonin dhe pas një çasti tha: "Është për ty".

"Përshëndetje! Miranda? Jam Tomi, trajneri i ekipit Chili Kickers. Po e shikoja ndeshjen tënde sot. Dukeshe shkëlqyeshëm atje."

Zemra e Mirandës filloi të rrihte më shpejt. Chili Kickers ishte ekipi më i mirë i futbollit në ligë!

"Ekipi ynë do të shkojë në ndeshjet e kampionatit rajonal muajin tjetër. Ti luajte aq mirë sot sa që dua të vish me ne si portiere rezervë."

Zemra e Mirandës thuajse i kërceu nga kraharori. Kjo ishte mundësia e saj që të luante në një ekip fitues!

"Do të doja shumë të vija!" tha Miranda. Ata folën për disa minuta rreth hollësive përpara se ajo ta mbyllte telefonin dhe të vraponte në dhomën tjetër për t'i treguar mamit. Së bashku ato filluan të shkruanin datat e stërvitjeve dhe ndeshjeve në kalendarin e familjes.

Papritur mami ndaloi së shkruari, me stilolapsin që rrinte pezull mbi një nga katrorët e kalendarit.

"Obobo. Miranda, këto ndeshje janë të dielave. Ja, shikoje." Ajo tregoi me gisht te plani i ndeshjeve dhe u kthye nga Miranda

ILUSTRIMI NGA BRAD TEARE

me një vrenjtje të shqetësuar në fytyrë. "Ç'mendon se duhet të bësh?"

Mirandës i pikoi në zemër dhe kafshoi buzën ndërsa mendonte për alternativat e saj. Mami mund ta linte të luante nëse ajo ia kërkonte por, kur mendoi rreth lojës të dielën dhe veçanërisht rreth mungesës në Kishë, pati një ndjesi boshllëku në stomak. Ajo e dinte se e diela ishte për të shkuar në kishë dhe për të adhuruar Atin Qiellor dhe ajo nuk mundej realisht t'i bënte ato gjëra ndërsa luante futboll.

"Mendoj se duhet t'i telefonoj përsëri dhe t'i them se nuk mund të luaj", tha Miranda. Ajo u përpoq fort që të mos qante. Edhe pse ajo e dinte se ishte zgjedhja e duhur, ishte e vështirë të hiqte dorë nga diçka që e dëshironte kaq tmerrësisht.

"Dhe a e di se çfarë mendoj unë?" tha mami duke i dhënë një përqafim të madh. "Unë mendoj se ti je një fëmijë i shkëlqyer."

Atë të diel, ndërsa Miranda qe ulur në Fillore, mendoi rreth vendimit të mirë që kishte marrë. Trajneri u befasua kur Miranda i kishte telefonuar dhe kishte thënë se nuk mund të luante futboll të dielave. Ai ishte përpjekur të arrinte t'ia ndryshonte mendjen, por ajo ishte e patundur në vendimin e saj. Tani, teksa dëgjonte këngët dhe mësimet e Fillores, Miranda buzëqeshte. Ndjenja paqësore në zemrën e saj i tha se ishte në vendin e duhur. Ajo kishte marrë një vendim fitimtar në fund të fundit. ■

NJË DITË KËNAQËSIE

Shkrimet e shenjta na mësojnë se Shabati duhet të jetë një ditë kënaqësie (shih Isaia 58:13). Çfarë gjërash të gëzueshme mund të bëni ju të dielave? Cilat janë disa mënyra të bukura e krijuese në të cilat mund ta adhuroni Atin Qiellor?

KËNDI I PYETJES

Çfarë ju pëlqen më shumë rreth të qenit një anëtar i Kishës?

Më pëlqen që gjatë sakramentit neve na jepet mundësia të marrim bukën dhe ujin në kujtim të Jezu Krishtit. Buka na kujton trupin e Tij dhe uji na kujton gjakun e Tij. Kur jemi duke e marrë sakramentin, ne mund t'i mbyllim sytë e të mendojmë për të gjitha gjërat që Jezusi bëri për ne.

Eva J., 9 vjeçe, Karolina e Veriut, SHBA

Më pëlqen të mësoj se familjet mund të jenë së bashku përgjithmonë. (Reneeja) Unë mund të kem miq, mund të lexoj shkrimet e shenjta çdo ditë dhe mund të mësoj ungjillin. (Ralfi)

Renee dhe Ralf E., 9 dhe 10 vjeç, Metro Manila, Filipinet



Më pëlqen shumë kur e ndiej Frymën e Shenjtë. Mund ta ndiej Frymën e Shenjtë shumë ndërkohë që dëgjoj biseda dhe mësime. E ndiej atë edhe kur i ndihmoj të tjerët.

Kejli C., 7 vjeçe, Virxhinia, SHBA

Gjëja ime e parapëlqyer është që ne mund të mësojmë e të luajmë njëkohësisht dhe ne mund të mësojmë më shumë rreth Jezu Krishtit. Më pëlqen të mësoj rreth Tij sepse Ai është Shpëtimtari im. (Liza) Më pëlqen të mësoj rreth Jezusit dhe e di se Jezusi na do. (Lalo)

Liza dhe Lalo S., 8 dhe 6 vjeç, Kaliforni, SHBA

Më pëlqen shumë të shkoj në Fillore e të këndoj këngë.

Hejden H., 5 vjeç, Juta, SHBA

Më pëlqen të mësoj rreth Jezu Krishtit dhe më pëlqen të shkoj në Fillore e të zë shokë.

Katerina W., 7 vjeçe, Karolina e Veriut, SHBA



Më pëlqen shumë që arrij të zë shumë shokë të rinj dhe mund t'iu jap mësim rreth ungjillit, shokëve të mi që nuk janë anëtarë. Më jepet mundësia të dëgjoj konferencën e përgjithshme e të dëgjoj profetin dhe Apostujt tek flasin. Mbrëmja familjare është gjithashtu argëtuese sepse ndonjëherë ne dalim për akullore. E shijshme!

Savana H., 12 vjeçe, Uashington, SHBA

PYETJA E RADHËS

"Kur mami dhe babi im grinden, ndihem shumë e shqetësuar dhe e trishtuar. Çfarë mund të bëj?"

A keni ndonjë këshillë rreth kësaj? Na e dërgoni përgjigjen dhe fotografinë tuaj deri më 31 tetor 2015. Gjejeni adresën tonë në faqen 3 ose na dërgoni mesazh elektronik në liahona@ldschurch.org. (Vini "Question Corner" ["Këndi i Pyetjes"] në rreshtin e titullit.) Kujtohuni të përfshini një leje nga prindërit!

Përgjigjet jepen me synimin që të ndihmojnë dhe të japin perspektivë, jo si deklarime të doktrinës së Kishës.

FAQJA JONË



Motrat misionare, nga Abril S., 9 vjeçe, Meksikë

Katër djem nga e njëjta lagje në Argjentinë u pagëzuan në të njëjtën ditë. Peshkopi i tyre (në qendër) qëndron me ta.

TË FALËNDEROJ TY, PERËNDI

Të falënderoj Ty, Perëndi për dritën,
se ajo ndriçon ditë e natë.
Të falënderoj Ty, Perëndi për pemët,
se ato duket se e lehtësojnë atë puhi të fortë.
Të falënderoj Ty, Perëndi për shumë më tepër
nga sa mundem të përcaktoj,
por e di nga zemra se Ti e ke krijuar jetën që po jetoj.
Edhe pse mund të mos jetë aq e mirë kjo jeta ime.
për sa kohë jam gjallë, unë kam gëzime.

Nisha J., 10 vjeçe, Republika e Palaut

Vëllai im dhe një mik i familjes morën thirrjet e tyre për mision. Ne udhëtuam me makinë për tetë orë për në tempullin e Frajbergut në Gjermani, që ata të mund të merrnin dhurimet [indaumentet] e tyre në tempull.

Ne qëndruam për pesë ditë që familja ime të mund të bënte shumë punë në tempull. Ka një bujtinë për familjet në rrethinat e tempullit. Disa fëmijë të tjerë dhe unë e ndihmuam kopshtarin dhe ai na dha akullore. U zbavitëm shumë.

Mezi e pres vitin tjetër kur të jem 12 vjeçe dhe të jem në gjendje të bëj pagëzime në tempull.

Alicka S., 11 vjeçe, Sllovaki

Mësoni së bashku rreth Dhiatës së Re këtë vit!

Pjetri, Korneli dhe Engjëlli

Nga Erin Sanderson

Pasi Jezusi u ringjall dhe u kthye në qiell, Pjetri dhe Apostujt e tjerë predikuan në shumë vende, por vetëm te judenjtë.

Korneli ishte një oficer në ushtrinë romake. Ai besonte në Perëndi, por nuk ishte jude. Një engjëll iu shfaq atij dhe i tha të dërgonte njerëz që të thërrisnin Pjetrin. Korneli i dërgoi burrat e tij për të gjetur Pjetrin dhe Fryma e Shenjtë i tha Pjetrit të shkonte me ta.

Në shtëpinë e Kornelit, Pjetri u dha mësim shumë njerëzve që qenë mbledhur atje. Ai u tregoi rreth ungjillit të Jezu Krishtit dhe ata e ndien Frymën e Shenjtë dhe e dinin se ishte i vërtetë. Kur miqtë e Pjetrit zbuluan se ai kishte predikuar te njerëz që nuk qenë judenj, ata u tronditën. Por Pjetri u tha se ai kishte mësuar se ungjilli i Jezu Krishtit është për këdo. (Shih Veprat e Apostujve 10:1–48; 11:1–18.) ■

Autorja jeton në Juta, SHBA.

MAJTAS: ILUSTRIM NGA CRAIG STAPLEY; DJATHTAS: DETAJ NGA *PAMJA E KRISHTIT,* NGA HEINRICH HOFMANN, ME MIRËSINË E C. HARRISON CONROY CO.

PËRGATITU PËR TË NDARË ME TË TJERËT!

Një mënyrë për t'u bërë një misionar i mirë është të përpiqemi të bëhemi më shumë si Jezusi. Priti etiketat dhe plotëso një veçori të cilën do të dëshiroje ta ushtrosh. Ndoshta mund të punosh me të qenit "Plaku [Elder] i Sjellshëm" ose "Motra Mirënjohëse". Vendose etiketën atje ku mund të të kujtojë për synimin tënd.

Plaku

Motra

Motra

Plaku

BISEDA FAMILJARE

Lexo Mateu 28:19–20. Flisni rreth mënyrës se si mund ta ndani ungjillin me këdo. Mendoni për pyetjet që miqtë apo fqinjët tuaj mund të kenë rreth ungjillit. Ti mund të ushtrohesh për bërjen e pyetjeve dhe dhënien e përgjigjeve për to duke interpretuar me role me familjen tënde.

Kënga: Zgjidhni një këngë rreth punës misionare, të tillë si "We'll Bring the World His Truth" ["Botës t'Vërtetën e Tij do t'i Sjellim"] (*Children's Songbook,* f. 172).

Shkrim i Shenjtë: Mateu 28:19–20

Material filmik: Shkoni te Biblevideos.org për të parë "Peter's Revelation to Take the Gospel to the Gentiles" ["Zbulesa e Pjetrit për ta Çuar Ungjillin te Johebrenjtë"].

KËSHILLË PËR SHKRIMIN E SHENJTË

Ne mund t'i kuptojmë më mirë shkrimet e shenjta kur e ndajmë me të tjerët atë që po mësojmë. Lexo një fragment shkrimi të shenjtë me familjen tënde dhe fol rreth domethënies së fjalëve apo frazave të vështira, të asaj që shkrimi i shenjtë do të thotë për ty dhe të mënyrave për ta vënë në zbatim në jetën tënde.

MËSO MË SHUMË

Përpara se Pjetri të thirrej për të qenë dishepull, ai ishte peshkatar i njohur si Simon. Jezusi i dha atij emrin Pjetër që do të thotë "gur" ose "shkëmb". Pasi Jezusi u largua nga toka, Pjetri ishte Kryeapostulli dhe e udhëhoqi Kishën. Ai mbajti çelësat, apo autoritetin e priftërisë.



Ishte pas mesnate, por Tejti e dinte se ishte koha për të folur.

Të Gjesh Ndihmë

Nga Kimberli Raid
Bazuar në një ndodhi të vërtetë

"Atë Qiellor, tani të lutem, më udhërrëfe e më mbro çdo ditë" (Children's Songbook, *f. 19).*

Tejti rrinte zgjuar në errësirë, duke i kapsallitur sytë që të mos qante. Ai qe lutur për ndihmë, por dukej sikur një re e rëndë dhe e zezë i rrinte përsipër, duke e lënë jashtë Shpirtin.

"Po sikur të mos e harroj kurrë atë program të tmerrshëm televiziv", shqetësohej ai.

Disa ditë më parë, ai i kishte mbaruar herët detyrat e tij dhe kishte ndezur televizorin. Por ai nuk e kishte pritur të shihte diçka si *ajo* në ekran. Tejti qe aq i tronditur, saqë harroi ta fikte televizorin aq shpejt sa duhej ta kishte fikur.

Ishte një aksident. Ai nuk kishte dashur ta shihte një skenë si ajo, por tani nuk mund ta harronte. Ndonjëherë ajo i befte në mendje në mes të shkollës, në tavolinën e darkës madje edhe gjatë Kishës. Në kohë si ato, ai ishte i gëzuar që mami dhe babi nuk mund t'ia lexonin mendjen. Prindërit e Tejtit e kishin mësuar të mos shihte figura të njerëzve pa rroba. Ai e dinte se ata prisnin që ai gjithashtu t'i shmangte programet televizive, filmat dhe videolojërat e dhunshme.

"Tani e di pse", tha mbyturazi Tejti me vete.

Tejti u çua nga shtrati dhe ra në gjunjë përsëri. Çfarë mund të bënte?

"Atë Qiellor", pëshpëriti Tejti. "Të lutem më ndihmo të ndaloj së menduari për atë që pashë." Ai i fshiu lotët që i ishin krijuar në sy dhe mbajti vesh. Zemra e tij rrahu më shpejt. Ai mendoi se e ndjeu Frymën e Shenjtë ta nxiste, por nuk ishte përgjigjja që dëshironte.

Ai duhej t'u tregonte prindërve.

"Përse?" pyeti veten Tejti. Ai do të ndihej si vogëlush po të shkonte në dhomën e prindërve të tij në mes të natës. Dhe për t'iu *treguar*? Ai prapë u ndje i turpëruar dhe i neveritur.

Pastaj i erdhi një mendim i qartë në mendje: Ati Qiellor donte që ai të ishte i lumtur. Ati Qiellor donte që ai të ndiente Shpirtin përsëri, të mendonte për gjëra të mira dhe të ishte i sinqertë me familjen e tij. Ai veçanërisht donte që Tejti të bëhej një mbajtës i denjë i priftërisë Aarone kur të mbushte 12 vjeç për pak muaj. Tejti e kuptoi se po të kapej pas asaj që kishte parë dhe ta mbante sekret, ai do të mbetej i palumtur rreth saj.

Tejti e dinte se kishte nevojë për ndihmë dhe Fryma e Shenjtë sapo i kishte thënë se ku ta gjente.

Tejti pa numrat e orës dixhitale që shkëlqenin në anë të shtratit të tij. Ishte afërsisht ora 1:00 e mëngjesit. Ai u ngrit në këmbë dhe u drejtua nga korridori i errët drejt dhomës së prindërve të tij. Duke u përtypur me siklet, ai trokiti lehtë në derën e tyre.

"Mami? Babi?"

"Tejt, ti je?" erdhi zëri i përgjumur i mamit.

"Ka ndonjë gjë që nuk shkon?" pyeti babi.

"Po", tha Tejti. "A mund të flasim? Dhe a mundem ndoshta të marr një bekim?"

Babi e ndezi llambën në anën e tij te shtrati dhe e ftoi Tejtin brenda. Për herë të parë pas ditësh të tëra, Tejti ndjeu ngrohtësi, shpresë dhe dritë. ■

Autorja jeton në Juta, SHBA.

ILUSTRIMI NGA MARK ROBISON

O, Jo! Po Tani?

Ajo mund të ndodhë kudo në shtëpi, në shkollë ose në shtëpinë e një shoku. Papritmas ti shikon diçka që *e di* se nuk është e mirë në një telefon, televizor, kompjuter apo aparat lojërash ose në një libër apo revistë. *Tani* çfarë mund të bësh për t'u ndier më mirë?

Largohu prej saj. Fike. Hiqe nga duart. Trajtoje sikur është helm për trurin tënd sepse e tillë është.

Tregoji mamit ose babit. Prindërit të njohin më së miri dhe dëshirojnë të të ndihmojnë që të jesh i sigurt dhe i lumtur. Mos u turpëro. Ajo që të ndodhi ty, i ndodh ndonjëherë thuajse kujtdo.

Mos rri ulur duarkryq. Shiko ose lexo diçka të mirë. Bëj diçka gjallëruese. Bëj një vepër të mirë. Shko të rrish pranë familjes apo shokëve.

Vazhdo të flasësh. Mund të të ndihmojë t'i thuash mamit ose babit sa herë që ndonjë gjë që e pe gjatë ditës të bëri të ndiheshe në siklet. Prindërit mund të të ndihmojnë të bësh një plan për ta mbrojtur veten nga të parit e gjëra-ve të papërshtatshme. Në ndihesh i zënë në kurth, i shqetësuar apo sikur do të shohësh prapë diçka të papërshtatshme, sigurohu që t'u tregosh atyre edhe për këtë.

Kujtohu se cili je. Ti nuk je i keq për shkak të asaj që pe. Ti je një fëmijë i Perëndisë dhe Ai të do e dëshiron të të ndihmojë që të jesh i sigurt dhe i lumtur.

Lëre të shkojë. Përfytyroje veten sikur po lëshon një tullumbace dhe po e shikon të pluskojë teksa largohet. Përpiqu të qetësohesh e ta heqësh nga mendja atë që pe të pluskojë jashtë. Tani përfytyro tempullin, familjen tënde ose diçka tjetër që do fort ta shohësh.



ILUSTRIMET NGA SHAWNA J. C. TENNEY

Kungujt e Polit

Nga Rei Goldrup

Bazuar në një ndodhi të vërtetë

ILUSTRIMET NGA AMY WUMMER

Poli po ndihmonte babin për të mbjellë në kopsht. Ai dëshironte që vëllai i tij, Eriku, të ishte këtu për t'i ndihmuar. Por Eriku ishte larg në një mision.

"Nuk do të jem kurrë i madh si Eriku", tha Poli. "Si mund të shkoj në një mision si ai?"

"Mos u shqetëso", tha babi. "Ti do të rritesh."

Babi i dha Polit disa fara kungulli. Ai e ndihmoi Polin që t'i mbillte.

"Këto fara të vogla do të rriten [e të bëhen] kunguj të mëdhenj?" pyeti Poli.

"Nëse kujdesesh mirë për to", tha babi.

Poli shkoi çdo ditë që të kujdesej për kopshtin. Ai e ujiti dhe shpejt mbinë filiza të rinj. Gjethet u bënë më të mëdha. Poli i shkuli me kujdes barërat e këqija.

Në vjeshtë, bimët e tij të kungujve ishin rritur. Dhe kishte kunguj të mëdhenj portokalli!

Poli e mori babin që t'ia tregonte. "Ti u kujdese shumë për bimët e tua të kungujve", tha babi.

"Po! Dhe do të kujdesem shumë për veten, që edhe unë të mund të rritem." Poli buzëqeshi. "Dhe kur të rritem, mund të shkoj në një mision pikërisht si Eriku!" ■

Autori jeton në Juta, SHBA.

Ngastra e Kungujve

Sa kunguj kultivoi Poli?

A mund t'i gjeni objektet e tjera të fshehura? ■

Një në një Milion

Fjalët nga Jan Pinborough
Muzika nga Michael F. Moody

Lehtë dhe me energji ♩ = 96–104

mf

1. Je - mi plot një mi - lion f'mij' Sot
më - soj t'jem i mir', I

n'bo - tën rreth e qark. Se - ci - li f'mij' i Per'n - dis', I pa -
bin - dur, i vër - tet'. Tre - goj se e du - a Zo - tin Në

më ngadalë *a tempo*

shem-bullt nga çdo an'. Ne një në një mi - lion, Rri - te - mi n'forc', n'be-sim! Ne
gjith - çka them e bëj. Jam një në një mi - lion, Rri-tem n'forc' e be - sim! Jam

një në një mi - lion, N'drit'n e Tij e - cim! Je - mi t've-tëm në llo - jin ton' —
një në një mi - lion, N'drit'n e Tij e - ci! Jam i ve - tëm në llo - jin tim —

1.

(duartrokit) As - kujt s'i ngjajm' — Do je - mi çka A - ti Qie - llor sy - non. 2. Po
As - kujt s'i ngjaj — Do

2.

jem çka A - ti Qie-llor sy-non për mu - a! Un' do jem çka A - ti Qie-llor sy - non.

më ngadalë *rit.*

© 2010 nga Jan Pinborough dhe Michael F. Moody. I rezervohen të gjitha të drejtat.
Kjo këngë mund të kopjohet për t'u përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti.
Ky shënim duhet të përfshihet në secilën kopje të bërë.

Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë
në Presidencën
e Parë

RRUGA DREJT SIGURISË

Një nga mënyrat se si mund ta dimë se paralajmërimi është nga Zoti, është se është thirrur ligji i dëshmitarëve, dëshmitarëve të autorizuar.

Duket se nuk ka fund dëshira e Shpëtimtarit për të na udhëhequr drejt sigurisë. Dhe ka qëndrueshmëri në mënyrën se si Ai na e tregon shtegun. Ai na thërret me më shumë se një mënyrë që ajo të mund të mbërrijë tek ata që janë të gatshëm ta pranojnë. Dhe ato mënyra gjithmonë përfshijnë dërgimin e mesazhit me anë të gojës së profetëve të Tij, kurdoherë që njerëzit janë të përgatitur për të pasur profetë të Perëndisë midis tyre. Ata shërbëtorë të autorizuar kanë gjithmonë përgjegjësinë të paralajmërojnë njerëzit, duke u treguar rrugën drejt sigurisë.

Kur tensionet u rritën së tepërmi në veri të Misurit në SHBA, në vjeshtën e 1838-ës, Profeti Jozef Smith bëri thirrje që gjithë shenjtorët të mblidheshin në Far-Uest për t'u mbrojtur. Shumë ishin në ferma të veçuara ose në koloni të shpërndara. Ai e këshilloi veçanërisht Jakob Haunin, themeluesin e një kolonie të vogël që quhej Hauns-Mill. Një raport i asaj kohe përfshin këtë: "Vëllai Jozef dërgoi fjalë me anë të

Haunit, që ishte pronar i mullirit, për të njoftuar vëllezërit që jetonin atje, që të largoheshin e të vinin në Far-Uest, por Z. Haun nuk e përcolli mesazhin" (Philo Dibble, në "Early Scenes në Church History", në *Four Faith Promoting Classics* [1968], f. 90). Më vonë, Profeti Jozef shënoi në historinë e tij: "Deri më sot, Perëndia më ka dhënë urtësi që të shpëtoj njerëzit që e dëgjuan këshillën. Nuk është vrarë asnjë që [ka vepruar] sipas këshillës sime." (*History of the Church,* 5:137). Pastaj Profeti shënoi të vërtetën e trishtuar se do të mund të ishin shpëtuar jetë të pafajshme në Hauns-Mill, po të ishte marrë dhe zbatuar këshilla e tij.

Në kohën tonë ne jemi paralajmëruar me këshillë se ku ta gjejmë sigurinë nga mëkati dhe hidhërimi. Një nga çelësat se si t'i dallojmë këto paralajmërime është se ato përsëriten. Për shembull, më shumë se një herë në këto konferenca të përgjithshme, ju keni dëgjuar profetin tonë të thotë se ai do të citojë një profet të mëparshëm dhe si rrjedhim, do të jetë një dëshmitar i dytë dhe nganjëherë madje i tretë. . . . Apostulli Pal shkroi: "Çdo gjë do të qëndrojë me gojën e dy a tre dëshmitarëve" (2 Korintasve 13:1). Një nga mënyrat se si mund ta dimë se paralajmërimi është nga Zoti, është se është thirrur ligji i dëshmitarëve, dëshmitarëve të autorizuar. Kur fjalët e profetëve duket se përsëriten, kjo duhet të tërheqë vëmendjen tonë dhe t'i mbushë zemrat tona me mirënjohje që jetojmë në kohë të tilla të bekuara. . . .

Ati ynë Qiellor na do. Ai dërgoi Birin e Tij të Vetëmlindur që të bëhej Shpëtimtari ynë. Ai e dinte se gjatë jetës së vdekshme ne do të ishim në rrezik të rëndë, më të keqin e rreziqeve nga tundimet e një kundërshtari të tmerrshëm. Kjo është një nga arsyet pse Shpëtimtari ka siguruar çelësat e priftërisë, që ata që kanë veshë për të dëgjuar dhe besim për t'u bindur, të mund të shkojnë në vendet e sigurisë. ■

Nga "Finding Safety in Counsel", Liahona, *korrik 1997, f. 23–25.*

IDETË

Sa shpesh i themi ne fjalë mirëdashëse njëri-tjetrit?

"Ne mund ta vëmë veten në provë duke bërë disa pyetje. . . . 1. Kur ishte hera e fundit që unë e lavdërova me sinqeritet shokun/shoqen tim/e, qoftë veçan ose në prani të fëmijëve tanë? 2. Kur ishte hera e fundit që e falënderova, i shpreha dashuri ose kërkova zellshëm me besim për të në lutje? 3. Kur ishte hera e fundit që e ndalova veten nga të thënit e diçkaje që e dija se mund të ishte lënduese? 4. Kur ishte hera e fundit që u shfajësova dhe kërkova falje me përulësi – pa shtuar fjalët 'por vetëm sikur të kishe' ose 'por vetëm sikur të mos kishe'? 5. Kur ishte hera e fundit që zgjodha të jem e lumtur në vend që të kërkoja të kisha 'të drejtë'?"

Linda K. Barton, presidentja e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, "Ne do të Lartësohemi së Bashku", *Liahona,* maj 2015, f. 29.

Gjithashtu në Këtë Botim

PËR TË RINJTË NË MOSHË MADHORE

TË JETUARIT ME **Qëllim të Vërtetë**

Të kuptuarit e "arsyes" së vendimeve tuaja do t'ju ndihmojë të bëni gjërat e drejta për arsyet e drejta. Mësoni të jetoni një jetë të qëllimtë!

f. 44

PËR RININË



f. 62

Rini e Mahnitshme
NË SHKRIMET E SHENJTA

Betejat që të rinjve në shkrimet e shenjta iu desh të përballnin, qenë të ndryshme nga tuajat, por ju prapëseprapë mundeni t'i ndiqni shembujt e tyre të guximit, besimit dhe bindjes për kapërcimin e sfidave tuaja vetjake.

PËR FËMIJËT

Të Gjesh Ndihmë

Tejti nuk mundej të ndalonte së menduari rreth asaj që kishte parë në televizor, ndaj ai iu lut Atit Qiellor për të ditur se ç'të bënte.

f. 72

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

ALBANIAN
4 021257 01013